



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
"Shkenca Kompjuterike"
"Universiteti i New York-ut në Tiranë"**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Thoma Korini

Prof. Dr. Elson Agastra

Dhjetor / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike"**

1	IAL aplikues:	Universiteti i New York-ut në Tiranë"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Kompjuterike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM nr. 939, datë 03.09.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Shkresë të MASH Nr. 6858/2 Prot, datë 06.05.2011
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MASH Nr. 184, dt. 16.05.2013
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr.87, datë 07.12.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike / 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 7 (shattë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	6 PAE / 4 PAK
18	Numri i studentëve:	2021-2022 7 studentë; 2022-2023 5 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti “New York Tirana” (UNYT), është një Institucion privat i arsimit të lartë, i themeluar në vitin 2002 me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 397, datë 15.08.2002 “Për hapjen e Universitetit “New York”, Tiranë”.

UNYT është akredituar në nivel institucional, për herë të parë me vendimin Nr. 385, datë 10.10.2006, riakredituar me Urdhër MASH Nr. 405, datë 28.10.2015, Vendimi i Bordit të Akreditimit Nr. 102, datë 10.11.2017 dhe riakredituar institucionalisht me kohë zgjatje 6 vite me vendimin e Bordit të Akreditimit nr. 61, datë 18.12.2020 për periudhën 18.12.2020 – 17.12.2026. Aktualisht UNYT është pjesë e Fondacioni Turk MAARIF.

Universitetit “New York”, Tiranë, përbëhet nga katër njësi kryesore, fakultete/institute:


- Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore;
- Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit;
- Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës;
- Instituti për Kërkime Europiane dhe Ballkanike;

Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, njësi kryesore ku ky program studimi ofrohet, është i përbërë nga tre njësi bazë, përkatësisht:

- Departamenti i Shkencave Kompjuterike;
- Departamenti i Sistemeve të Informacionit dhe Inteligjente;
- Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit;

Statuti i UNYT, në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” është miratuar në vitin 2020. Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” përfshihet në ciklin e dytë të studimeve universitare të ofruara prej Departamentit të Shkencave Kompjuterike, Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, Universiteti “New York Tirana”.

Ky program studimi ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje 2 vite akademike dhe 120 kredite ECTS, ku në përfundim të tij përfitohet Diplomë Universitare Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike”. Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” është i hartuar dhe zbatohet nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike, duke harmonizuar të gjithë komponentët e tij në lidhje me legjislacionin në fuqi dhe me qëllimet, misionin dhe zhvillimin e Institucionit dhe njësisë bazë. Programi i studimit ofrohet në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UNYT. Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” është hapur me VKM nr. 939, datë 03.09.2009. Akreditimi i parë është kryer për një periudhë 6 vjeçare nga MASH me Urdhër Nr.170, datë 20.04.2012, bazuar në VKA Nr. 323, datë 16.03.2012. Akreditimi i dytë, është kryer me Vendim të BA nr.87, datë 07.12.2018 për një periudhë 5 vjeçare (deri 30.09.2023). UNYT ka aplikuar në ASCAL për akreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” më datë 27.05.2022. Në këtë mënyrë, kemi të bëjmë me akreditimin periodik (akreditimin e tretë) të këtij programi studimi.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Mbështetur në VKM nr.109/2017, ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike”. Bazuar në Urdhër nr. Nr.69, datë 02.06.2023 të ASCAL, *“Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit, aplikuar nga Universiteti i New York-ut në Tiranë”*, grupi i vlerësimit të jashtëm për këtë program studimi përbëhet nga, Prof. Dr. Thoma Korini dhe Prof. Dr. Elson Agastra.

Gjatë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatorët Teknike të ASCAL, Znj. Majlinda Demirmeli dhe Znj. Aviola Bardhi. Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i hartuar në Maj 2023 nga vetë institucioni. Raporti siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Universiteti “New York Tirana” (UNYT), për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Universiteti “New York Tirana”, po ashtu, vuri në dispozicion të GVJ një numër dokumentesh shtesë në plotësim e përditësim të elementëve të paraqitur të RVB, dokumentacioni i paraqitur edhe në sistemin AMS të ASCAL. Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 *“Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”*, VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 *“Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”*, VKM Nr.824, datë 24.12.2021 *“Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”*, VKM Nr.41 datë 24.01.2018 e ndryshuar *“Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”*, në Udhëzimin Nr. 31 datë 29.12.2017 *“Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë”*, Udhëzimin e MASR Nr. 1, datë 14.1.2020, për *“Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë”*, Udhëzimin e MASR Nr. 22, datë 3.9.2020, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020, “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë””* si dhe gjithë aktet e tjera nënligjore që kanë të bëjnë me organizimin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë. Gjatë vizitës së kryer në institucion, në datat 10 dhe 11 Korrik 2023, u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Universiteti “New York Tirana”. Takime ndër të cilat mund të përmendim atë me Rektorin e UNYT, Dekanin e Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës, Përgjegjësin e Departamentit të Shkencave Kompjuterike, Grupin e Vlerësimit të brendshëm, stafin akademik, studentët, përfaqësues të NjsBC, përfaqësues të Degës së Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Zyrës së Karrierës, Zyrës së Çështjeve Studentore, Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare, si dhe përfaqësues të Sekretarisë Mësimore. Gjithashtu u zhvillua edhe një vizitë e auditorëve, laboratorëve si dhe bibliotekës, shoqëruar me diskutime për elementë lidhur me këtë infrastrukturë. Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e syllabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit

të dijeve, përcaktimin e krediteve, kualifikimin e stafit akademik, etj. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet shitesë që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave të paraqitura. Në përfundim të analizës së materialeve të sipër cituara, GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të vlerësimit të jashtëm mbi këtë program studimi duke paraqitur edhe disa rekomandime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.87, datë 7.12.2018 janë:

1. Institucioni, të shtojë numrin e stafit akademik efektiv me grada dhe tituj të angazhuar në këtë program studimi për të garantuar qëndrueshmërinë e tij në funksion të cilësisë së mësimdhënies;
2. Institucioni, të parashikojë e zbatojë instrumente për vlerësimin afatgjatë të efektivitetit dhe të punësimit të të diplomuarve në tregun e punës;
3. Institucioni, të rinovojë marrëveshjen me Universitetin e Greenwich-it, Britani e Madhe, si parakusht për ruajtjen e statusit të Diplomës së Dyfishtë me këtë universitet, për vitin akademik 2019-2020 e në vijim;

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. Për rekomandimin e parë, GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe takimeve në institucion konstatoi se stafi akademik efektiv i Departamentit të Shkencave Kompjuterike për tre vitet e fundit paraqitet si vijon:

Stafi akademik efektiv i Departamentit të Shkencave Kompjuterike	2020-2021	2021-2022	2022-2023
Prof. Dr	1	-	1
Prof. Asoc.	1	1	1
Dr/Phd	1	3	2
Msc.	4	4	3
Gjithsej	7	8	7

ndërsa stafi akademik efektiv i angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" studimi paraqitet si vijon:

Stafi akademik efektiv i Departamentit i angazhuar në programin e studimit	2020-2021	2021-2022	2022-2023
Prof. Dr	-	1	1

Prof. Asoc.	1	-	1
Dr/Phd	4	4	3
Msc.	1	1	1
Gjithsej	6	6	6

Referuar sa më sipër, është mundësuar garantimi i personelit akademik minimal përsa i përket Departamentit të Shkencave Kompjuterike. Përsa u përket gradave e titujve akademikë synohet në vijim rritja e shkallës së kualifikimit. Përsa i përket mbulimit të programit të studimit nga personeli akademik efektiv, GVJ konstaton një qëndrueshmëri të stafit. Megjithatë, GVJ është i mendimit (frymë të cilën e gjeti edhe gjatë takimeve në institucion) se është e nevojshme rritja e mëtejshme e shkallës së kualifikimit të personelit akademik si dhe reduktimi i mëtejshëm i ngarkesës mesimore të përballuar nga personeli akademik me kontratë. Eventualisht kontribut pozitiv do të përbënte edhe rritja e efektivitetit të personelit akademik efektiv për të mos qëndruar në minimumin e kufijve ligjorë. **Rekomandimi konsiderohet i plotësuar.**

2. **Për rekomandimin e dytë**, GVJ konstaton se megjithëse nuk ka një tregues të mirëfilltë tregu, fakti që nga 35 të diplomuarit vitet e fundit në këtë program studimi të gjithë janë të punësuar dhe punësimi është në përputhje me diplomën, është një tregues i rëndësishëm i cili dëshmon jo vetëm për nivelin e përgatitjes së të diplomuarve, por edhe për kërkesat e larta të tregut për këtë diplomë. GVJ u informua se një pjesë e mirë e të diplomuarve në këtë program studimi janë punësuar në kompani të rëndësishme, kryesisht jashtë vendit. Megjithatë, duke patur parasysh numrin relativisht të vogël të studentëve që kanë ndjekur këtë program studimi 3 vitet e fundit, GVJ është i mendimit se qëndrueshmëria dhe vazhdueshmëria e programit do të varet nga kapaciteti i institucionit në përgjithësi dhe Departamentit të Shkencave Kompjuterike në veçanti për të rritur numrin e të regjistruarve në këtë program. **Rekomandimi konsiderohet i plotësuar.**
3. **Për rekomandimin e tretë**, GVJ konstaton se Marrëveshja me Universitetin e Greenwich (UoG), Londër ishte e vlefshme deri më 31 tetor 2019 dhe ka qenë aktive për këtë periudhë. GVJ u informua se që nga viti 2019, UNYT ofron programin Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike pa bashkëpunimin e UoG, marrëveshja me të cilin përfundoi në Tetor 2019, dhe nuk u rinovua përsëri për shkak të kërkesës së UoG për numër studentësh më të lartë. Në këto kushte nuk ruhet statusi i Diplomës së Dyfishtë, por diploma lëshohet vetëm nga UNYT. Megjithëse kjo shënon një hap prapa në krahasim me statusin e mëparshëm, kjo nuk pengon plotësimin e standardeve dhe vazhdimin e diplomimit në këtë program studimi ofruar nga UNYT. **Ky rekomandim nuk është plotësuar**, por kjo nuk pengon formimin në këtë program studimi dhe diplomimin si diplomë e UNYT.

Universiteti i New York-ut Tiranë, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 07.12.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 118/72 Prot, datë 07.12.2023. Universiteti i NewYork-ut Tiranë njofton me anë të shkresës me Nr.92/2 Prot, datë 12.12.2023 “ *Përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit*”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës, Universiteti New York-ut, Tiranë (UNYT), si Institucion i Arsimit të Lartë, në përputhje me përcaktimet e Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” GVJ vëren se programet e studimit të ofruan nga kjo IAL nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Në qëllimet dhe objektivat dhe misionin e këtij institucioni vërejmë:</p> <p>Krijimi, zhvillimi, përcjellja dhe mbrojtja e dijeve, si dhe përgatitja e qytetarëve paraprirës të së ardhmes, profesionistëve dhe akademikëve të ardhshëm me anë të mësimdhënies, të të nxëniet dhe hulumtimit duke i kushtuar rëndësi të veçantë zhvillimit personal dhe integritetit në komunitet, si dhe duke siguruar njohuritë, aftësitë, karakterin dhe besimin e nevojshëm për të patur sukses në një mjedis heterogjen ndërkombëtar.</p> <p><i>1.1 UNYT Statuti 2020</i> <i>2.17 UNYT Research Pillars 2019-2022</i> <i>3.16 Studimi i Tregut</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Program i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike", është një program që zhvillohet prej këtij institucioni që prej viti 2009 bazuar në VKM 939, datë 03.09.2009, duke qenë një nga qëllimet dhe misionet e këtij institucioni. Qëllime dhe misione të institucionit të cilat janë të shfaqur qartë në statutin e tij si dhe në aktet rregullatore të hartuara nga ministria përgjegjëse për arsimin që në hapjen e tij, ashtu edhe në hapjen e këtij programi të studimi.</p> <p><i>1.1 UNYT Statuti 2020</i></p>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se programi studimit Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” është</p>

<p>ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me politikat e zhvillimit të Institucionit, në lidhje me përgatitjen e profesionistëve në këtë fushë.</p> <p>Ky program studimi i hapur prej UNYT në vitin 2009, është riparë në vitin 2014 në kuadër të bashkëpunimit me Universitetin e Greenwinch-it (UoG) në Britaninë e Madhe, me marrëveshje bashkëpunimi deri më tetor 2019.</p> <p><i>1.1 UNYT Statuti 2020</i> <i>1.2 Strategic Plan</i> <i>1.14 UNYT Rules and Regulation</i> <i>1.12 Rregullore e Fakultetit</i> <i>1.11 Rregullore e Departamentit të Shkencave Kompjuterike</i> <i>1.13 Rregullore e programit - MSc në Shkenca Kompjuterik</i></p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në UNYT, GVI konstaton se Universiteti New York në Tiranë, ka përvojën mbi 20 vjeçare në fushën akademike, kapacitetet në infrastrukturë dhe struktura ndihmëse, si dhe burimet e duhura në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Personeli akademik në programin e studimit është i kualifikuar, me një përvojë shumëvjeçare në fushat studimore dhe aplikative të programit të studimit, në vend dhe jashtë tij, gjë që mundëson rritjen e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Program i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" ofrohet në Fakultetin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës në një nga drejtimet me prioritet ndërkombëtar në zhvillimet teknologjike.</p> <p><i>1.1 UNYT Statuti 2020</i> <i>1.2 Strategic Plan</i> <i>1.14 UNYT Rules and Regulation</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit, Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" ofrohet nga Universiteti "New York, në Tiranë", në përputhje të plotë me misionin, qëllimin dhe aktivitetin e tij.</i></p> <p><i>Programi i studimit bazohet ofrohet nga njësi bazë dhe kryesore që kanë të njëjtën fushë akademike me atë të këtij programi studimi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

17.

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.

Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në UNYT, GVJ konstaton se Universiteti New York në Tiranë, ka përvojën mbi 20 vjeçare në fushën akademike, kapacitetet në infrastrukturë dhe struktura ndihmëse, si dhe burimet e duhura në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Personeli akademik në programin e studimit është i kualifikuar, me një përvojë shumëvjeçare në fushat studimore dhe aplikative të programit të studimit, në vend dhe jashtë tij, gjë që mundëson rritjen e cilësisë së mësimdhënies.

Programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" ofrohet në fakultetin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës me tre njësitë e tij bazë:

- Departamenti i Shkencave Kompjuterike;
- Departamenti i Sistemeve të Informacionit dhe Inteligjente;
- Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit;

Burimet njerëzore: Stafit akademik bazuar në CV-të rezultoi me përvojë dhe i përshtatshëm në disiplinat specifike të Shkencave Kompjuterike.

Nga të dhënat që jepen në DVV, rezultoi numri i duhur i anëtarëve të stafit akademik me përvojë dhe të përshtatshëm në disiplinat specifike të këtij programi studimi. Personeli Akademik Efektiv (PAE) dhe ai me kontratë (PAK) i angazhuar në këtë program studimi, në vitin akademik 2022-2023 kanë kualifikimet si më poshtë:

Kualifikimi	PAE	PAK
Prof. Dr.	1	1
Prof. Asoc.	1	0
Dr./PhD	3	3
Dr. në proces	1	0
Msc.	0	0
Total	6	4

Në Departamentin e Shkencave Kompjuterike, i cili është përgjegjës për programin e studimit, janë të angazhuar staf

	<p>akademik efektiv dhe staf akademik me kontratë, të cilët zotërojnë kualifikimin si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="592 320 1362 725"> <thead> <tr> <th>Kualifikimi</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr.</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>1</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Dr./PhD</td> <td>2</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td>Dr. në proces</td> <td>0</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>3</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td>7</td> <td>8</td> </tr> </tbody> </table> <p>Stafi akademik ka kualifikimin e duhur për formimin e njësisë bazë si dhe angazhimi i tyre akademik është në përputhje me fushën e tyre të ekspertizës.</p> <p><i>1.12 Rregullore e Fakultetit</i> <i>1.11 Rregullore e Departamentit të Shkencave Kompjuterike</i> <i>1.13 Rregullore e programit - MSc në Shkenca Kompjuterik</i> <i>2.5 Academic Staff CV 2018-2023</i> <i>2.13 MSc Cs Tabelat permbledhese per Aneks RVB</i></p>	Kualifikimi	PAE	PAK	Prof. Dr.	1	1	Prof. Asoc.	1	0	Dr./PhD	2	6	Dr. në proces	0	0	Msc	3	1	Total	7	8
Kualifikimi	PAE	PAK																				
Prof. Dr.	1	1																				
Prof. Asoc.	1	0																				
Dr./PhD	2	6																				
Dr. në proces	0	0																				
Msc	3	1																				
Total	7	8																				
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës, GVJ konstaton se njësia kryesore, Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës ku zhvillohet ky program studimi, ka dy njësi bazë që kanë në fokus fushën dhe zhvillimin e këtij program studimi, Në veçanti, janë njësitë bazë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Departamenti i Shkencave Kompjuterike; – Departamenti i Sistemeve të Informacionit dhe Inteligjente; <p>Dhe njësia e tretë, në fushën e arkitekturës, më konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit; <p>Departamenti i Shkencave Kompjuterike, përgjegjës për këtë program studimi ka si fusha të përgjithshme dhe specifike fushat e shkencave informatike dhe të komunikimit. GVJ konstaton se aktiviteti mësimor-kërkimor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike është në përputhje me një nga fushat akademike e kërkimore të Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës. GVJ konstaton që nga IAL është realizuar kodifikimi i programeve dhe lëndëve të studimit në përputhje me nenin 86 të ligjit të ligjit nr. (80/2015) “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe direktivat evropiane.</p>																					
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën</p>																						

një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	1.11 Rregullore e Departamentit të Shkencave Kompjuterike			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	Nuk aplikohet			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	<p>Institucioni ka nënshkruar disa marrëveshje me aktor të rëndësishëm të tregut të punës por edhe akademik/profesional në fushën specifike të këtij programi studimi sikurse është anëtarësimi në akademinë “Red Hat”, një nga më prestigjiozet për sistemet GNU/Linux, dhe atë “Oracle” për sistemet e bazave të të dhënave. Gjithashtu, institucioni ka nënshkruar edhe marrëveshje me dy insitucione për zhvillimin e kurseve specifike për ERP dhe ato të rrjetave të telekomunikacionit. Këto marrëveshje kanë në bazë edhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta trajnuese, drejtuar jo vetëm studentëve të këtij programi studimi, por më në përgjithësi, edhe palëve të tjera të interesuara si ish student për edukimin në vijim.</p> <p><i>1.8 MoU UNYT-S-SYSTEMS SHA</i> <i>1.8.1 MoU UNYT-IERA</i> <i>1.9 Anëtarësim në Oracle</i> <i>1.9.1 Anëtarësim në Red_Hat Academy</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Programi i studimit, Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” ofrohet nga njësia bazë, Departamenti i Shkencave Kompjuterike.</i></p> <p><i>Profili i këtij programi përputhet plotësisht me fushën akademike të kësaj njësie bazë.</i></p> <p><i>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka formimin specifik dhe përvojën profesionale, në përputhje me argumentet e trajtuara në lëndët që mbulojnë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në UNYT, GVJ konstaton se në funksion të hartimit, monitorimit dhe mbarëvajtjes së programit të studimit është realizuar ndarja e detyrave mes njësive bazë dhe kryesore të IAL, të paraqitura dhe në organigramën e përditësuar të vitit 2022 të organizimit të UNYT, që përcaktohet nga institucioni në aktet rregullore dhe udhëzuese të tij. Nga vlerësimi rezulton se Departamenti i Shkencave Kompjuterike menaxhon dhe drejton me efektivitet programin e ciklit të dytë Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" me kohëzgjatje 2 vite akademike me kohë të plotë, me 120 kredite ECTS.</p> <p>Vërehet një bashkëpunim i ngushtë me të gjitha strukturat e institucionit (Njësia e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, Sekretaria mësimore, Arkiva dhe protokolli, Zyra e burimeve njerëzore, Zyra e zhvillimit të kurrikulave, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, Zyra e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë etj.) si dhe njësive të tjera bazë të këtij institucioni në tërësi. Kjo duket edhe në mësimdhënie, ku disa prej lëndëve të këtij programi studimi mbulohen nga staf akademik i njësive të tjera bazë të këtij fakulteti dhe në përgjithësi të këtij universiteti, sipas fushës së tyre të ekspertizës.</p> <p><i>1.2 Strategic Plan</i> <i>1.14 UNYT Rules and Regulation</i> <i>1.12 Rregullore e Fakultetit</i> <i>1.11 Rregullore e Departamentit të Shkencave Kompjuterike</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>GVJ bazuar në informacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit, si dhe në takimin me përfaqësuesin e zyrës së marrëdhënieve me jashtë dhe të projekteve, vlerëson se UNYT ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi si me institucione të tjera të arsimit të lartë ashtu edhe me subjekte ekonomike private dhe institucione të tjera shtetërore.</p> <p>Në veçanti, institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë jashtë vendit me të cilët ka patur apo ka marrëveshje për zhvillimin e programeve të studimit apo lëshimit të diplomave të përbashkëta. Nga takimi me studentët, me personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, me zyrën përgjegjëse për marrëdhëniet më jashtë, u</p>

	<p>konstatua se institucioni ka bashkëpunime me IAL-të vendase dhe të huaja dhe me kompani biznesi. Gjithashtu vihet re edhe rritja e kërkesës dhe angazhimit në aktivitete ndërkombëtare si Erasmus+. Gjithashtu, institucioni ka angazhuar edhe një ekspert të jashtëm për vlerësimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p><i>5.1 UNYT Lista e MoU</i> <i>5.2 UNYT Erasmus and Mevlana Mobility Quota</i> <i>5.2.1 UNYT Lista e MoU, Mevlana and Erasmus+Inter-Institutional Agreements</i> <i>6.5 Vendim Rektorati nr. 99 Ekspert i Jashtëm</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se UNYT ka bashkëpunime ndërinstytucionale me një numër të konsiderueshëm institucionesh shtetërore dhe IAL brenda dhe jashtë vendit, si dhe me kompani dhe komunitet biznesi.</p> <p>UNYT ka nënshkruar marrëveshje dhe bashkëpunon me numër të konsiderueshëm institucionesh, organizatash dhe biznesesh për kryerjen e praktikave profesionale, Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi/esh studimi për Praktikave profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë. Studentëve u ofrohet mundësia për të shprehur kërkesat e tyre për realizimin e praktikës. Institucioni nëse nuk ka marrëveshje ekzistuese me punëdhënësit ku studenti kërkon zhvillimin e praktikës, paraprakisht realizohet një marrëveshje institucionale e më pas bëhet e mundur realizimi i praktikës.</p> <p>Studentët e këtij program studimi, nuk e kanë të ndarë lëndën e “Praktikës profesionale” nga ajo e zhvillimi të punimit të diplomës. Ku të dy këto aktivitete zënë 30 kredite ECTS.</p> <p>Megjithëse, në tabelën 9 në aneks RVB, institucioni ka përcaktuar lëndën “Praktike Profesionale për Projektin Përfundimtar të Disertacionit” me 12 kredite ECTS, në kategorinë “D” të VKM 41 e ndryshuar. Praktika vlerësohet së bashku me punimin e diplomës, si pjesë e tij. Kjo vërehet edhe në planin mësimor, tabela 10, por edhe në syllabuset, ku në total diploma vlerësohet me 30 kredite ECTS (12 kredite praktika dhe 18 kredite diploma).</p> <p><i>2.13 MSc Cs Tabelat permbledhese per Aneks RVB</i> <i>1.8.1 MoU UNYT-IERA</i> <i>5.1 UNYT Lista e MoU</i> <i>5.2 UNYT Erasmus and Mevlana Mobility Quota</i></p>

	<p>5.2.1 UNYT Lista e MoU, Mevlana and Erasmus+Inter-Institutional Agreements</p> <p>5.12 UNYT Aktivitete Zyra e Karrierës</p> <p>5.14.1 UNYT Panairi i Karrierës online 2020</p>			
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni përdor disa forma komplementare të vlerësimit të përfitimeve të marrëveshjeve, duke i parë ato në këndvështrim të rritjes së cilësisë së bashkëpunimit. Vlerësohet periodikisht cilësia e intershipeve dhe mundësive të ofruara nga kompanitë, por edhe përfitimet dhe njohuritë e përvetësuar nga studentët që realizojnë intershipet/praktikat pranë këtyre institucioneve.</p> <p>Këtu realizohen edhe raporte për vlerësimin e studentëve për praktikën që ta zhvillojnë dhe aftësinë dhe njohuritë e tyre për të qenë të vlefshëm në tregun e punës.</p> <p>Të gjitha këto të dhëna, bëhen pjesë e materialeve raportuese që analizohen periodikisht nga institucioni në nivel njësie bazë, njësie kryesore dhe institucioni në tërësi.</p> <p>2.18 Annual Monitoring Report MSc CS 2021-2022</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>UNYT nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me institucione partnere si dhe aktor të tregut të punës dhe i analizon ato në mënyrë periodike.</p> <p>Praktika profesionale, nuk është e ndarë nga punimi i diplomës, dhe si i tillë vlerësohen së bashku.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

<p>Standardi II.1</p> <p>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ai ofrohet në 2 vite akademike, 4 semestra, dhe me kohë të plotë. Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” përmban 120 kredite ECTS.

Aktiviteti didaktik për këtë program studimi shtrihet në:

- Leksione;
- Ushtrime/Seminare, punë në grup;
- Projekte/Detyra kursi;
- Laboratorë;
- Studim Individual;

Megjithatë vërehet se ndarja e ngarkesës në auditor, e shprehur si kredite ECTS, nuk është e balancuar mes semestrave, më konkretisht vërehet se viti i parë kërkon një angazhim prej 67.5 kredite ECTS, ndërsa viti i dytë prej 52.5 kredite ECTS.

	Semestri I		Semestri II		Total	
	ECTS	Orë	ECTS	Orë	ECTS	Orë
Viti I	37.5	253	30	172	67.5	425
Viti II	22.5	129	30	25	52.5	154

Kujtojmë se një kredit ECTS korrespondon me një angazhim prej 25 orë studimi (pjesërisht në auditor e pjesërisht studim individual), dhe në total për një vit akademik, parashikohen 60 kredite ECTS që përkojnë me 1500 orë studimi në tërësi.

Nga sa më sipër, studentët e këtij programi studimi, në vitin e parë kanë një ngarkesë prej 67.5 kredite dhe ekuivalenti në 1688 orësh studimore, duke tejkaluar atë prej 1500 orësh të pranueshme për një vit akademik.

Kjo ngarkesë zvogëlohet në vitin e dytë me 1312 orë në total.

Megjithatë, raporti i orëve në auditor kundrejt atyre totale të krediteve përkatëse të parashikuara për vitin e parë është:

- **425 orë në auditor / 1688 orë totale**
- **25 % / 75 %**

Për vitin e dytë, nëse vlerësojmë vetëm orët në auditor të semestrit të parë, që janë lëndë mësimore të zhvilluara në

institucion, kemi: 22.5 ECTS për një total prej 563 orë studimi, nga të cilat vetëm 129 zhvillohen në auditor, pra:

- 129 orë në auditor / 563 orë totale
- 23 % / 77 %

Mesatarisht, programi i studimit kërkon një angazhim të studentit dhe institucionit sipas tabelës në vijim:

Viti	Orë në auditor	Orë studim individual	Raporti
Viti i parë	425	1263	25% / 75 %
Viti i dytë	129 (+25 orë praktika dhe diploma)	434 (+725 orë praktika dhe diploma)	23% / 77 % (12% / 88% përfshirë praktikë dhe diplomë)
Totali lëndë mësimore	554	1697	25% / 75%
Totali përfshirë praktikë dhe diplomë	579	2422	19% / 81%

Ky raport është në përputhje me VKM 41 e ndryshuar e cila parashikon që orët në auditor të mos jenë më shumë se 50% e atyre totale, por është në një vlerë të ulët referuar edhe programeve të ngjashme studimi të ofruara nga IAL të tjera kombëtare apo ndërkombëtare.

Më konkretisht, në institucione të tjera, për programe të ngjashme, ky raport, është në diapazonin 35% - 45% të orëve në auditor dhe 65% deri në 55% të orëve për studim individual.

Ne si GVJ, gjuojmë se numri i orëve në auditor është i ulët për të garantuar një mësimdhënie efektive për argumentet e trajtuar në lëndët e këtij programi studimi.

Sugjerojmë institucionin të rrisë numrin e orëve në auditor të paktën me 10%.

Bazuar në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve, vërehet si institucioni nuk ka përcaktuar ndarjen në kredite ECTS

brenda lëndëve për aktivitetet e nevojshme didaktike si Leksione, Seminare apo laborator dhe projekte/detyra kursi. Ka përcaktuar vetëm orët mësimore në auditor për secilin aktivitet.

Sugjerojmë që institucioni të përcaktojë edhe ndarjen e krediteve ECTS për secilin aktivitet formues si Leksione, Seminare, Laboratore Detyra/Projekte kursi, etj.. Bazuar në ndarjen orë në auditor/ECTS, dhe nëse gjykon se studenti duhet të ketë një ngarkesë më të madhe apo më të ulët në auditor, të ndryshojnë numrin e krediteve përkatëse apo ndarjen e tyre brenda lëndës.

Në këtë mënyrë bëhet e mundur vlerësimi cilësor dhe sasior i ngarkesës si për stafin akademik, por edhe për studentët për përfitim të njohurive përkatëse.

Gjithashtu, ndarje e kësaj ngarkese mundëson vlerësimin sasior të mjaftueshmërisë së aktiviteteve dhe ambienteve, sidomos atyre laboratorike, të parashikuara për secilin aktivitet. Nga analiza e planit mësimor, lëndëve dhe përmbajtës (Tabela 10 në aneks RVB), vërejmë se Lënda "Projekti Përfundimtar dhe Disertacioni", shprehet me 30 kredite ECTS, duke zenë 25% të krediteve të këtij programi (30ECTS / 120 ECTS).

Referuar VKM 41, datë 24.1.2018, e modifikuar me VKM 879, datë 18.12.2019 dhe VKM 185, datë 25.3.2021, detyrimet përmbyllëse duhet të zenë 10-15% të krediteve, pra jo më shumë se 18 kredite ECTS.

Institucioni paraqet në tabelën 9 në aneks RVB detyrimet përmbyllëse me 18 kredite ECTS si punim diplome dhe 12 kredite ECTS i parashikon si "Praktike Profesionale për Projektin Përfundimtar të Disertacionit". Pra institucioni ka ndarë logjikisht punimin e diplomës në 12 kredite ECTS në kategorinë "D" si pjesë e praktikës, dhe 18 kredite ECTS në kategorinë "E" (Detyrime përmbyllëse). Por vlerësimi i këtyre dy aktiviteteve realizohet si një i vetëm, në atë të punimit të diplomës.

Sugjerojmë institucionin, që lënda e praktikës, sikurse është paraqitur në tabelën 9 në aneks RVB, të paraqitet e veçantë edhe në planin mësimor me kreditet përkatëse. Gjithashtu, për të të hartohet edhe një syllabus, i cili të jetë një përmbledhje e shkurtër e objektivave dhe qëllimeve të parashikuara edhe në rregulloret e zhvillimit të praktikës.

	<p>1.11 Rregullore e Departamentit të Shkencave Kompjuterike 2.4 MSc në CS Syllabi 2.13 MSc Cs Tabelat permbledhese per Aneks RVB</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca kompjuterike" është përgatitur për të pajisur studentët me aftësitë dhe kompetencat e nevojshme që do t'i mundësojnë ata të jenë konkurrues në një treg kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe të formojnë baza për studime të mëtejshme akademike në ciklin e tretë. Në mënyrë të veçantë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Formimin e specialistëve dhe kërkuesve me njohuri në fushën e teknologjisë së informacionit si lider të ardhshëm në këtë fushë; – Eksplorimi i tendencave aktuale në të cilat industria e IT dhe Shkenca Kompjuterike në tërësi po zhvillohen si dhe të pajis studentët me arsimin e nevojshëm për të zotëruar dhe përdorur këto kompetenca; – Plotësimi i boshllëqeve aktuale në industrinë e IT në Shqipëri për specialistë në fushat më të kërkuara, si Rrjetet, Inxhinieria Softuerike, Siguria dhe Menaxhimi i Bazave të të Dhënave; <p><i>1.3 Strategjia e Zhvillimit te Programit 2.4 MSc në CS Syllabi 2.17 UNYT Research Pillars 2019-2022 1.5 Market Study</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi mësimor i ciklit të dytë, Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" përmban shpërndarjen e krediteve midis lëndëve, kategorizimin e lëndëve, elementët e mësimdhënies etj. Programi i studimit, Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike", me 120 kredite ECTS, <i>nuk ka të përcaktuar praktikën profesionale në planin mësimor.</i></p> <p>Gjatë takimit në institucion, por edhe në tabelat përmbledhëse në aneks RVB, vërehet Lënda "Projekti Përfundimtar dhe Disertacioni", me 30 kredite ECTS, i parashikuar në planin mësimor. Kjo lëndë, në kategorizimin e lëndëve, është i ndarë logjikisht nga institucioni si 12 kredite ECTS në kategorinë "D" si pjesë e praktikës profesionale, dhe 18 kredite ECTS në kategorinë "E" (Detyrime përmbyllëse).</p> <p>Megjithatë, në planin mësimor, por edhe syllabuset, nuk ka një evidencë të praktikës profesionale si aktivitet të përcaktuar qartazi. Ajo është pjesë integrale e zhvillimit të</p>

15.

	<p>punimit të diplomës, si aktivitet përmbyllës i këtij cikli studimi.</p> <p><i>Sugjerohet që institucioni, të ndajë praktikën mësimore nga punimi i diplomës, duke i përcaktuar qartë kreditet në planin mësimor. Për sa më sipër, të hartojë edhe një syllabuse përkatës për praktikën dhe mënyrë e vlerësimit të saj.</i></p> <p>2.13 MSc Cs Tabelat permbledhese per Aneks RVB 2.4 MSc në CS Syllabi</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Nuk aplikohet</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Nuk aplikohet</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në</p>	<p>Nuk aplikohet</p>

<p>përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>									
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Përmbajta e planit mësimor, përfshirë lëndët, organizimin e tyre në vite akademike dhe semestra si dhe peshën në kredite ECTS, është në ngjashmëri së paku 70% me programet e studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave, të ofruara nga IAL të tjera kombëtare.</p> <p>Diferenca kryesore, është në mungesën në mënyrë eksplicite të praktikës profesionale, që në këtë program studimi është e integruar me punimin e diplomës. Megjithatë, kjo diferencë, përbën 10% të totalit të krediteve, duke mbajtur kështu ngjashmërinë minimale prej 70% të kërkuar.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” i ofruar nga UNYT parashikon procesin e mësimnxënies dhe mësimdhënies të ndarë në aktivitete në auditor dhe jashtë tij. Studentët e këtij programi studimi, në vitin e parë kanë një ngarkesë prej 67.5 kredite dhe ekuivalenti në 1688 orësh studimore, duke tejkalluar atë prej 1500 orësh të pranueshme për një vit akademik.</p> <p>Kjo ngarkesë zvogëlohet në vitin e dytë me 1312 orë në total. Megjithatë, raporti i orëve në auditor kundrejt atyre totale të krediteve përkatëse të parashikuara për vitin e parë është:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 425 orë në auditor / 1688 orë totale - 25 % / 75 % <p>Për vitin e dytë, nëse vlerësojmë vetëm orët në auditor të semestrit të parë, që janë lëndë mësimore të zhvilluara në institucion, kemi: 22.5 ECTS për një total prej 563 orë studimi, nga të cilat vetëm 129 zhvillohen në auditor, pra:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 129 orë në auditor / 563 orë totale - 23 % / 77 % <p>Mesatarisht, programi i studimit kërkon një angazhim të studentit dhe institucionit sipas tabelës në vijim:</p> <table border="1" data-bbox="603 1865 1356 2016"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Orë në auditor</th> <th>Orë studim individual</th> <th>Raporti</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Viti i parë</td> <td>425</td> <td>1263</td> <td>25% / 75 %</td> </tr> </tbody> </table>	Viti	Orë në auditor	Orë studim individual	Raporti	Viti i parë	425	1263	25% / 75 %
Viti	Orë në auditor	Orë studim individual	Raporti						
Viti i parë	425	1263	25% / 75 %						

Viti i dytë	129 (+25 orë praktika dhe diploma)	434 (+725 orë praktika dhe diploma)	23% / 77 % (12% / 88% përfshirë praktikë dhe diplomë)
Totali lëndë mësimore	554	1697	25% / 75%
Totali përfshirë praktikë dhe diplomë	579	2422	19% / 81%

Në institucione të tjera, për programe të ngjashme, ky raport, është në diapazonin 35% - 45% të orëve në auditor dhe 65% deri në 55% të orëve për studim individual.

Ne si GVJ, gjuojmë se numri i orëve në auditor është i ulët për të garantuar një mësimdhënie efektive për argumentet e trajtuar në lëndët e këtij programi studimi, dhe më i ulët se ai i ofruar nga institucione të tjera.

Sugjerojmë institucionin të rrisë numrin e orëve në auditor të paktën me 10%

Bazuar në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve, vërehet si institucioni nuk ka përcaktuar ndarjen në kredite ECTS brenda lëndëve për aktivitetet e nevojshme didaktike si Leksione, Seminare apo laborator dhe projekte/detyra kursi. Ka përcaktuar vetëm orët mësimore në auditor për secilin aktivitet.

2.4 MSc në CS Syllabi

2.13 MSc Cs Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB

Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.

Për sa i përket kodifikimit të programeve/ klasifikimit, referuar raportit të vlerësimit të brendshëm, dokumentacionit shoqërues si dhe VKM nr. 310, datë 11.05.2022 për "Specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", kodifikimi i këtij programi studimi është përcaktuar nga UNYT me kodin: 72MS0611A.

<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Nuk aplikohet</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Lëndët në tërësi, plani mësimor dhe organizimi i tij, janë në përputhje me objektivat formuese të studentëve për këtë cikël studimesh.</i></p> <p><i>Numri i orëve në auditor i parashikuar për aktivitetet didaktike, është konform VKM 41 e ndryshuar, por më i ulët se në programe të tjera të ngjashme.</i></p> <p><i>Praktika profesionale nuk është e përcaktuar qartë në planin mësimor dhe zhvillohet e integruar me punimin e diplomës.</i></p> <p><i><u>Sugjerohet</u> institucioni që të ndajë në mënyrë eksplicite praktikën profesionale nga punimi i diplomës, pavarësisht se rezultatet e praktikës mund të përdoren për realizimin e punimit të diplomës.</i></p> <p><i><u>Sugjerohet</u> institucioni të rrisë numrin e orëve në auditor me së paku 10%.</i></p> <p><i>Institucioni të balancojë ngarkesën e krediteve në vite akademike.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi II.2</p>	
<p>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën</p>	<p>Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, ka në përbërje 3 njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Shkencave Kompjuterike; 2. Departamenti i Sistemeve të Informacionit dhe Inteligjente;

akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

3. Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajn

Duke përmbushur kështu edhe kriteret ligjore për qëndrueshmërinë e njësisë kryesore.

Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, për vitin akademik 2022-2023, ka gjithsej 38 pedagogë, nga të cilët 22 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 16 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm:

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës	
	PAE	PAK
Prof.Dr	2	1
Prof.Asoc	1	-
Dr/PhD	12	7
Msc	7	8
Gjithsej	22	16

Departamenti i Shkencave Kompjuterike, përgjegjës për programin e studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike", përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas tre viteve akademike që paraqiten si më poshtë:

Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	-	-	1	1	1
Prof. Asoc.	1	1	1	1	1	-
Dr./PhD.	1	4	3	8	2	6
Msc.	4	5	4	2	3	1
Totali	7	10	8	12	7	8

Secila njësi bazë, përfshirë edhe Departamentin Shkencave Kompjuterike, përmbush kriteret minimale të parashikuar në ligjin 80/2015 për numrin dhe kualifikimin minimal të stafit efektiv për krijimin dhe ekzistencën e njësisë bazë.

1.1 UNYT Statuti 2020


	<p>1.1.1 Organogram 2.5 Academic Staff CV 2018-2023 1.6 Full-Time Academic Staff 2.13 MSc Cs Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB</p>			
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>UNYT angazhon në zhvillimin e procesit mësimor, staf ndihmës akademik për mbarëvajtjen e aktiviteteve laboratorike dhe atyre praktike në tërësi. Gjithashtu, në ndihmë të studentëve janë edhe një sërë zyrash, biblioteka dhe personel administrativ si për orientimin e studentëve, informacione të ndryshme.</p> <p>2.13 MSc Cs Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Kompjuterike, përgjegjës për këtë program studimi, për vitin akademik 2022-2023 është përgjegjës në tërësi për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dy programe studimi bachelor; - një master i shkencave; - një program doktoral; <p>Përgjegjës për programin e studimit është drejtuesi i njësisë bazë, e cili është edhe pikë referuese e studentëve në tërësi, mbas pedagogëve të lëndëve respektive. Drejtuesi i njësisë bazë, së bashku me atë të njësisë kryesore, janë pikat e kontaktit për studentët në lidhje me këtë program studimi.</p> <p>3.1 UNYT Manuali i Instruktoeve</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Njësia kryesore, Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës në UNYT në tërësi, dhe Departamenti i Shkencave Kompjuterike në veçanti, përmbushin kriteret organizative në përputhje me ligjin 80/2015 për arsimin e lartë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																				
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se njësia bazë përgjegjëse për programin e ciklit të dytë, Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike”, Departamenti i Shkencave Kompjuterike, disponon dhe ka vënë në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si rregulloren dhe programin mësimor. Të dhëna që janë edhe në nivel të njësisë kryesore, ku mund të përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të dhëna të përgjithshme programin, objektivat formuese, synimet, kriteret përzgjedhëse, regjistrimet, transferimet, tarifat, metodat e mësimdhënies etj. - rregullorja e programit; - plani mësimor; - syllabuset e lëndëve si dhe ndarjen e lëndëve sipas veprimtarive formuese shqip dhe anglisht, - CV e personelit akademik; <p>Dokumentacioni i sipërcituar ruhet, arkivohet dhe menaxhohet sipas rregullave të brendshme institucionale.</p> <p><i>2.4 MSc në CS Syllabi</i> <i>2.13 MSc Cs Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB</i></p>																				
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit për programin e studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike, rezulton se ky program studimi ka një ndarje të lëndëve sipas kategorive dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite duke e respektuar totalin vjetor prej 60 kreditesh, në 2 vjet në total 120 kredite. Përqindja sipas propozimit të përmirësuar të vitit akademik 2022-2023 për secilin tip të komponentit mësimor është:</p> <table border="1" data-bbox="592 1541 1361 1998"> <thead> <tr> <th>Tipi i veprimtarisë (A-E)</th> <th>Kredite ECTS</th> <th>Përqindje</th> <th>Standardi</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A – Lëndë Bazë</td> <td>7.5</td> <td>6.25%</td> <td>5-10%</td> </tr> <tr> <td>B – Lëndë Karakterizuese</td> <td>60</td> <td>50 %</td> <td>50-60%</td> </tr> <tr> <td>C- Lëndë ndërdisiplinore / Integruese</td> <td>22.5</td> <td>18.75 %</td> <td>12-20%</td> </tr> <tr> <td>D – Lëndë plotësuese</td> <td>12</td> <td>10 %</td> <td>10%</td> </tr> </tbody> </table>	Tipi i veprimtarisë (A-E)	Kredite ECTS	Përqindje	Standardi	A – Lëndë Bazë	7.5	6.25%	5-10%	B – Lëndë Karakterizuese	60	50 %	50-60%	C- Lëndë ndërdisiplinore / Integruese	22.5	18.75 %	12-20%	D – Lëndë plotësuese	12	10 %	10%
Tipi i veprimtarisë (A-E)	Kredite ECTS	Përqindje	Standardi																		
A – Lëndë Bazë	7.5	6.25%	5-10%																		
B – Lëndë Karakterizuese	60	50 %	50-60%																		
C- Lëndë ndërdisiplinore / Integruese	22.5	18.75 %	12-20%																		
D – Lëndë plotësuese	12	10 %	10%																		

	E – Detyrime përmbyllëse	18	15 %	10-15%
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>ku nuk plotësohet kushti i shumës mbi 60% të krediteve për komponentët mësimorë A dhe B, e përcaktuar kjo në VKM 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar me VKM 185, datë 25.03.2021.</p> <p>Megjithatë, kjo mos përputhje, nuk prek cilësinë e programit të studimit, pasi disa lëndë të përcaktuara në kategorinë “C”, mund të jenë njëkohësisht edhe në kategorinë “B”. Kjo bën që mos përputhja e më sipërme, të jetë formale.</p> <p>Gjithashtu, në planin mësimor, punimi i diplomës “Projekti Përfundimtar dhe Disertacioni”, me 30 kredite ECTS, i parashikuar në planin mësimor. Kjo lëndë, në kategorizimin e lëndëve, është i ndarë logjikisht nga institucioni si 12 kredite ECTS në kategorinë “D” si pjesë e praktikës profesionale, dhe 18 kredite ECTS në kategorinë “E” (Detyrime përmbyllëse).</p> <p>Megjithatë, në planin mësimor, por edhe syllabuset, nuk ka një evidencë të praktikës profesionale si aktivitet të përcaktuar qartazi. Ajo është pjesë integruese e zhvillimit të punimit të diplomës, si aktivitet përmbyllës i këtij cikli studimi.</p> <p><i>Sugjerohet që institucioni, të ndajë praktikën mësimore nga punimi i diplomës, duke i përcaktuar qartë kreditet në planin mësimor. Për sa më sipër, të hartojë edhe një syllabuse përkatës për praktikën dhe mënyrë e vlerësimit të saj.</i></p> <p><i>Ne si GVJ, sugjerohet institucionin, që pavarësisht gjetjes formale të më sipërme, të hartojë ndarjen e lëndëve në tipologjitë formuese, në përputhje të plotë me aktet ligjore në fuqi.</i></p> <p>2.4 MSc në CS Syllabi 2.13 MSc Cs Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB</p> <p>Studentët, në fillim të secilit semestër, informohen gjerësisht dhe pajisen me programin e lëndëve, ku jepen në detaje temat e lëndës, literatura kryesore, forma e kontrollit të dijeve, literatura e rekomanduar, etj. Pedagogët e lëndëve, në orën e parë që zhvillojnë me studentët, u paraqesin atyre syllabusin e lëndës. Ky informacion tashmë është edhe elektronikisht, ku çdo student shih gjithë materialet e lëndës që pedagogët vendosin në portal, krahas syllabusit. Në rregulloren e programit të studimit përshkruhen edhe kriteret dhe procedura e ndjekur në rast të transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p>2.4 MSc në CS Syllabi</p>			



	<i>2.13 MSc Cs Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB</i>			
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	<p>Për programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike", janë paraqitur programet e lëndëve të cilat janë të klasifikuara në kategori A, B, C, D dhe E. Programi i lëndës jep informacion mbi pedagogun që do të zhvillojnë modulit/lëndën dhe semestrin kur zhvillohet, tipologjinë e modulit/lëndës kohëzgjatjen e modulit; kreditet ECTS; objektivat e modulit/lëndës; elementët e mësimdhënies; detyrimet e studentit; format e kontrollit të dijeve dhe vlerësimin e tyre, si dhe literaturën.</p> <p>Syllabuset, për secilën lëndë, ofrojnë informacionet e nevojshme lidhur me ngarkesën totale për studentin, si për orët që do të zhvillojë në auditor ashtu edhe për ngarkesën e kërkuar për studim individual. Paraqitet gjithashtu përshkrimi i lëndës, objektivat e lëndës, temat për secilën javë, literaturë kryesore dhe mbështetëse, rezultatet e të nxënit të lëndës, kontributi i lëndës në kompetencat e programit të studimit dhe metodat e vlerësimit të njohurive.</p> <p><i>2.4 MSc në CS Syllabi</i> <i>2.13 MSc Cs Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB</i></p>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	<p>Institucioni, bazuar edhe në kërkesat dhe studimet e tregut të punës, vlerëson në mënyrë periodike ndryshimet e nevojshme në planin mësimor dhe përmbajtjen e lëndëve. Kjo është saktësuar edhe në planin strategjik të zhvillimit të institucionit në tërësi, dhe të këtij programi studimi në veçanti.</p> <p><i>2.4 MSc në CS Syllabi</i> <i>2.13 MSc Cs Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB</i> <i>1.3 Strategjia e Zhvillimit të Programit</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Programi i studimit dhe dokumentacioni përbërës si plani mësimor, syllabuset e lëndëve, rregullorja e programit të studimit dhe ajo e praktikës mësimore, janë të detajuara dhe përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët si gjatë kohës së studimeve pranë institucionit, ashtu edhe në rast kërkesë për transferime. Institucioni të hartojë planin mësimor me ndarjen e lëndëve në kategori formuese konform VKM 41 e modifikuar.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.

Emërtimi dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit, janë në fushën informatike/kompjuterike, sistemeve të përpunimit të informacionit, sigurisë së informacionit duke ju mundësuar studentëve përcimin e njohurive në përputhje me objektivat e programit të studimit. Shpërndarja e lëndëve në semestra dhe vite akademik ndjek një rrjedhë logjike të trajtimit të argumenteve dhe përcimit të njohurive tek studentët. Njohuri që aftësojnë studentin për punësimin e tij të ardhshëm por edhe për ndjekjen e një programi studimi të ciklit të tretë në këtë fushë.

2.4 MSc në CS Syllabi

2.13 MSc Cs Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB

Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.

GVJ konstaton se lëndët e programit të studimit, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si dhe vlerësimi në kredite mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe të aftësimin profesional. Bazuar në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve, vërehet si institucioni nuk ka përcaktuar ndarjen në kredite ECTS brenda lëndëve për aktivitetet e nevojshme didaktike si Leksione, Seminare apo laborator dhe projekte/detyra kursi. Ka përcaktuar vetëm orët mësimore në auditor për secilin aktivitet.

Sugjerohet që institucioni të përcaktojë edhe ndarjen e krediteve ECTS për secilin aktivitet formues si Leksione, Seminare, Laboratore Detyra/Projekte kursi, etj, bazuar në ndarjen orë në auditor/ECTS, dhe nëse gjykon se studenti duhet të ketë një ngarkesë më të madhe apo më të ulët në auditor, të ndryshojnë numrin e krediteve përkatëse apo ndarjen e tyre brenda lëndës.

Në këtë mënyrë bëhet e mundur vlerësimi cilësor dhe sasior i ngarkesës si për stafin akademik, por edhe për studentët për përfitimin e njohurive përkatëse. Gjithashtu, ndarje e kësaj ngarkese mundëson vlerësimin sasior të mjaftueshmërisë së aktiviteteve dhe ambienteve, sidomos atyre laboratorike, të parashikuara për secilin aktivitet.

	<p>2.4 MSc në CS Syllabi 2.13 MSc Cs Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Emërtimi, përmbajtja dhe shpërndarja e lëndëve dhe praktikave sigurojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të nevojshme për punësimin e studentëve. Lëndët që përdorin punën laboratorike ndihmojnë studentët të zhvillojnë aftësitë e tyre teknike dhe i bëjnë ata kandidatë shumë të mirë për në tregun e punës. Referuar programeve të studimit të ngjashëm, të ofruar nga institucione të tjera të arsimit të lartë brenda vendit, kanë një përafërsi në organizimin e planit mësimor.</p> <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa e shprehur në kredite, si dhe raporti i teorisë dhe praktikës janë në përputhje me profilin e programit Master i Shkencave dhe të përafruara me programe të ngjashme kombëtare dhe ndërkombëtare. Megjithatë, numri total i orëve në auditor është i ulët, referuar programe studimi të ngjashë, në konkretisht , nga plani mësimor rezulton se 579 orë zhvillohen në auditor të ndara në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 320 orë janë leksione në auditor - 25 orë janë seminare në auditor - 200 orë janë orë ushtrime/laborator në auditor - 34 orë forma të kontrollit të vazhdueshëm në auditor - 579 orë mësimore në total në auditor <p>Kësaj ngarkese i shtohet edhe zhvillimi i praktikës me 300 orë, duke e çuar maksimumin e orëve në auditor + praktikë në 579 + 300 = 879 orë mësimore kundrejt një totali prej 3000 orë mësimore për 120 kredite ECTS, pra në një raport 29% / 71%.</p> <p>Nëse bëjmë analizën e raporti të studimit teorik me atë praktik kemi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 379 orë leksione + seminare + kontroll i vazhdueshëm - 500 orë praktikë + laborator <p>Duke rezultuar në një raport teori/praktik 43% / 57%.</p> <p>2.4 MSc në CS Syllabi 2.13 MSc Cs Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues,</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis pjesës teorike dhe praktikës mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin e studentëve në përfundim të programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike”. Disa</p>

<p>transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>prej studentëve të këtij programi studimi, kanë përfunduar programet e mobilitetit në Universitete në Evropë me një përputhje të programeve të studimit të IAL universitetin e huaj.</p> <p><i>2.4 MSc në CS Syllabi</i> <i>2.13 MSc Cs Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, si dhe nga diskutimet me stafin akademik dhe drejtuesit e Departamentit të Shkencave Kompjuterike, GVJ evidentoi praktikën e punës në IAL, ku në fund të çdo viti akademik bëhet rishikimi i përmbajtjes së syllabuseve dhe programit të studimit, diskutohen nevojat për ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme brenda normës së lejuar në një vit akademik.</p> <p>Kërkesa për ndryshimet në kurrikulën e programit të studimit parashtrohet nga titullari i lëndës në bashkëpunim me drejtuesin e njësisë bazë, dhe pasi miratohet në departament ndjek procedurat institucionale të miratimit në senatin akademik dhe më pas në ministrinë përgjegjëse për arsimin. Kjo është saktësuar edhe në planin strategjik të zhvillimit të institucionit në tërësi, dhe të këtij programi studimi në veçanti.</p> <p><i>2.4 MSc në CS Syllabi</i> <i>2.13 MSc Cs Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB</i> <i>1.5 Market Study</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” ka përmbajtje didaktike dhe profesionale formuese dhe garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave që synon program në nivel e studimeve Master i Shkencave.</p> <p><i>2.4 MSc në CS Syllabi</i> <i>2.13 MSc Cs Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB</i> <i>1.5 Market Study</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” u jep mundësi të diplomuarve të vijnë studimet e mëtejshme në programet e ciklit të tretë dhe të pozicionohen në karrierën e tyre të ardhshme profesionale në fushat e teknologjive të informacionit. Programi i studimit duke ndërthurur teorinë me praktikën ka siguruar që aftësitë dhe kompetencat e kërkuara të jenë në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. Kjo tregohet nga një shkallë e lartë e punësimit të të diplomuarve të studentëve në fushat e teknologjisë së informacionit në kompani si në</p>

	<p>Shqipëri ashtu edhe jashtë saj. Edhe nga studimi që ka bërë institucioni, rezulton një pritshmëria e lartë e punësimit të studentëve të këtij programi studimi.</p> <p>2.4 MSc në CS Syllabi 2.13 MSc Cs Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB 5.6 UNYT Alumni reunion 5.6 UNYT Komunikim Alumni</p>			
Konkluzione	<p>Programi i studimit është i ngjashëm me atë të ofruar nga institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit për këtë profil.</p> <p>Ndarja e aktiviteteve formuese brenda lëndës mundëson përvetësimin e njohurive si teorike ashtu edhe praktike në përputhje me kërkesat e këtij programi.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, ka një marrëdhënie të konsoliduar bashkëpunimi me aktor të tregut të punës, në bashkëpunim me të cilët organizon edhe praktikantët mësimorë të parashikuara në programin e studimit. Ndër veçoritë e vlerësimit të bashkëpunimit me aktorët e tregut, institucioni vlerëson edhe nevojat e tij për të mundësuar përshtatjen e programeve të studimit. Gjithashtu, institucioni mban kontakte të vazhdueshme me ish studentët e diplomuar, jo vetëm në këtë program studimi. Në këtë kontekst është edhe roli i zyrës së Karrierës dhe Alumni, ku informacionet e mbledhura prej saj, bëhen pjesë e analizave periodike të studimit të tregut dhe nevojave për përshtatjen e programeve të studimit.</p> <p>Edhe në analizën vjetore, institucioni vlerëson edhe nevojat e tregut të punës, të evidentuara nga pyetësorët, takimet e drejtpërdrejta por edhe nga bashkëpunimet institucionale si me partnerët e biznesit ashtu edhe me ata akademik.</p> <p>2.18 Annual Monitoring Report MSc CS 2021-2022 1.3 Strategjia e Zhvillimit të Programit</p>

	<p>1.5 Market Study 5.6 UNYT Alumni reunion 5.6 UNYT Komunikim Alumni</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në menaxhim dhe në vendimmarrje (detyrime këto që rrjedhin tek Kodi i Cilësisë si dhe statuti i institucionit).</p> <p>Studentët përfaqësohen në organet kolegjiale si Senati akademik, Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Këshillin e Etikës si dhe akreditimin e programeve të studimit (GVB). Gjithashtu, institucioni mban kontakte të vazhdueshme me ish studentët e diplomuar, jo vetëm në këtë program studimi. Në këtë kontekst është edhe roli i zyrës së Karrierës dhe Alumni, ku informacionet e mbledhura prej saj, bëhen pjesë e analizave periodike të studimit të tregut dhe nevojave për përshtatjen e programeve të studimit.</p> <p>5.6 UNYT Komunikim Alumni</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Njësia bazë, përgjegjëse për këtë program studimi, realizon në mënyrë të përvitshme një analizë në tërësi të aktivitetit të saj, përfshirë edhe atë të nevojave për përmirësim të vazhduar të ofertës së saj didaktike.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës në tërësi dhe Departamenti i Shkencave Kompjuterike në veçanti, analizojnë dhe marrin opinionet e bashkëpunëtorëve si nga tregu i punës ashtu edhe nga ai akademik i institucioneve partnere për përmirësimin e vazhdueshëm të ofertës didaktike</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike”, e ka të përcaktuar qartë fushën e studimeve dhe kërkimin shkencor përkatës, e paraqitur kjo në analizën që institucioni ka realizuar. Fusha kërkimore shkencore e këtij programi studimi, është një nga shtyllat e hartuara që në hapjen e këtij universiteti, duke parë edhe vitin e parë të hapjes së këtij programi.</p> <p><i>1.2 Strategic Plan</i> <i>1.3 Strategjia e Zhvillimit të Programit</i> <i>1.4 Market Research Strategy</i> <i>1.5 Market Study</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Universiteti New York Tirana, dhe në veçanti njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, respekton fushën e ekspertizës dhe kualifikimin e stafit akademik. Në veçanti, stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, zhvillon lëndë apo module në përputhje me fushën e tyre të ekspertizës. Vlerësojmë se në tërësi, institucioni respekton lirinë dhe etikën akademike, duke u bazuar edhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.531, datë 11.09.2018, “Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë” dhe Ligjin Nr.9887 datë 10.03.20008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.</p> <p><i>1.12 Rregullore e Fakultetit</i> <i>1.13 Rregullore e programit - MSc në Shkenca Kompjuterike</i> <i>1.14 UNYT Rules and Regulation</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Programi i studimit, Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike”, formon studentët me njohuri të thelluara në fushën e teknologjisë së Informacionit, bazuar kjo edhe në klasifikimin e këtij programi në fushën e gjerë 06 “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi (TIK)” me kodin: 72MS0611A. Kodifikim në përputhje me VKM nr. 310, datë 11.05.2022 për “Specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Rezultatet e të nxënit, studentët e këtij programi studimi i kanë shfaqur edhe në pjesëmarrje në konferenca apo publikime shkencore në bashkë autorësi me stafin akademik të institucionit. Për vetë specifikën e programit dhe karakterin e tij në fushën e teknologjisë së informacionit, mundëson pjesëmarrje në një sërë projektsh kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këtë kuadër, rol të rëndësishëm është fakti</p>

	<p>i pjesëmarrjes në disa projekte me universitete të huaja në të cilat janë angazhuar edhe studentë të programeve të studimit që mbulon njësi bazë, Departamenti i Shkencave Kompjuterike.</p> <p><i>3.10 Aktivitete në Departament</i> <i>3.10.1 UNYT MKT Aktivitete + Seminare</i> <i>3.11 Konferenca</i> <i>3.8 Papers Published from MSc CS Students</i></p>			
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësi bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>UNYT në tërësi, mbështet financiarisht zhvillimin e këtij programi studimi. Nga analiza e raporteve financiare 2020 dhe 2021, GVJ konstaton se qëndrueshmëria financiare e UNYT bazuar në të ardhurat nga tarifat e shkollimit është e pa stabilizuar. Megjithatë, GVJ është i mendimit se fakti që prej vitit 2018, UNYT është pjesë Fondacionit Shtetëror Turk Maarif, nën emrin e grupit të edukimit “<i>International Maarif Schools</i>” i cili operon në 67 vende në botë dhe investimi i këtij grupi në drejtim të mbështetjes së institucionit përbëjnë një garanci për vazhdimësinë e programit të studimit dhe përmirësimin e situatës financiare në vijim. Për realizimin e këtij programi studimi, institucioni ka mbështetur financiarisht ngritjen e infrastrukturës laboratorike të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve didaktike si dhe atyre të kërkimit shkencor në fushën e këtij programi studimi.</p> <p><i>4.31 UNYT Plan Buxhet</i> <i>4.32 Mbështetje për aktivitete shkencore</i> <i>4.33 UNYT Pasqyrat Financiare 2020</i> <i>4.33.1 UNYT Pasqyrat Financiare 2021</i> <i>4.35 UNYT Kosto-efektivitet</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Formimi i studentëve në këtë program studimi mundëson zbatimin e njohurive në fusha kërkimore shkencore.</i></p> <p><i>Disa prej rezultateve të kërkimit shkencor janë publikuar në bashkautorësi të studentëve të këtij programi së bashku me stafin akademik të institucionit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Njësia bazë, përgjegjëse për këtë program studimi, nuk është e ndarë në grupe kërkimore shkencore. Megjithatë, vërehet se brenda njësisë bazë, por edhe brenda institucionit në tërësi, është një frymë bashkëpunimi e sanksionuar edhe në aktet rregullatore. Ku çdo njësi administrative bashkërendon punën me ato akademike brenda fushës së kompetencës për realizimin me sa më shumë efikasitet të objektivave akademike dhe kërkimore shkencore.</p> <p><i>6.18 UNYT Strategjia e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të Vlerësimit</i> <i>1.3 Strategjia e Zhvillimit të Programit</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Njësitë institucionale përgjegjëse për marrëdhëniet me jashtë dhe projektet, është aktive në përfshirjen e personelit akademik dhe studentët në realizimin e studimeve dhe analizave të ndryshme. Projekte ku angazhohen si stafi akademik, ashtu edhe studentët e këtij programi studimit. Kontributi i studentëve në projekte, shihet edhe si mundësi për zhvillimin e punimit të diplomës, e cila së bashku me praktikën, ka një peshë pre 30 kredite ECTS.</p> <p><i>1.3 Strategjia e Zhvillimit të Programit</i> <i>3.8 Papers Published from MSc CS Students</i> <i>3.9 MSc CS Students Awards</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Institucioni është aktiv në organizimin e aktiviteteve promovuese, konferencave shkencore të organizuara në institucion ose jashtë tij, ku pjesëmarrja e studentëve ka qenë e kënaqshme në raport edhe me numrin e studentëve të këtij programi. Bazuar në Raportin e aktivitetit kërkimor shkencor të UNYT si dhe në dokumentacionin që shoqëron raportin e vlerësimit të brendshëm, rezultojnë një seri aktivitete me karakter informues, prezantues të programit të studimit dhe institucionit, por edhe prezantues të arritjeve kërkimore shkencore.</p> <p><i>3.8 Papers Published from MSc CS Students</i> <i>3.9 MSc CS Students Awards</i> <i>3.10 Aktivitete në Departament</i> <i>3.10.1 UNYT-MKT-Aktivitete + Seminare</i> <i>3.11 Konferenca</i> <i>3.11.1 2nd Conference in Business Research & Management (BRM)</i> <i>3.11.2 1st International Student e-Congress 2020 - Agenda</i> <i>3.11.3 International Conference on Social and Applied Sciences 2021 – Agenda</i> <i>4.31 UNYT Plan Buxhet</i></p>



	4.32 Mbështetje për aktivitete shkencore
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	<p>Programi i studimit, ka objektiva të qartë në formimin e studentëve, objektiva të përcaktuara edhe nga studimi i tregut të zhvilluar nga institucioni për këtë program. Më konkretisht, ky program studimi, synon aftësimin e studentëve me njohuri të mirëfillta dhe të thelluara në fushën e teknologjisë së informacionit. Njohuri që janë konkurruese për një treg mbarë kombëtar. Zhvillimi i këtij programi tërësisht në gjuhën angleze, përforcon akoma më shumë aftësinë e studentëve për të qenë të aftë në një treg pune global, siç është ai relativ për këtë program studimi.</p> <p><i>1.3 Strategjia e Zhvillimit të Programit</i> <i>1.4 Market Research Strategy</i> <i>1.5 Market Study</i></p>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	<p>Studentët e diplomuar në këtë program studimi, mund të ushtrojnë profesionin e tyre pa patur nevojë për regjistrim apo anëtarësim në urdhëra profesionale. Në veçanti, për formim në fushën e teknologjisë së informacionit, aktualisht nuk ka shoqata profesionale apo urdhër që të rregullojnë fushën e zbatimit të këtij profesioni.</p> <p>Studentët e këtij programi studimi, pajisen me diplomë të nivelit të dytë, Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike”, i kategorizuar në fushën e gjerë 06, me kod 72MS0611A, konform VKM 310, datë 11.05.2022 për “Specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Megjithatë, institucioni bashkëpunon me institucione private apo shtetërore, nga të cilat vlerëson edhe rekomandime apo nevoja në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit që ofron. Kjo vërehet edhe në studimin e tregut të punës si dhe në strategjinë e zhvillimit të këtij programi.</p> <p><i>1.3 Strategjia e Zhvillimit të Programit</i> <i>1.4 Market Research Strategy</i> <i>1.5 Market Study</i></p>
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të	Nuk aplikohet

Bashkimit Evropian (p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU).				
Konkluzione	<i>Programi i studimi bazohet në një studim tregu, dhe organizimi i tij, formon student të aftë dhe konkurrues për një treg pune ndërkombëtar, e përforcuar kjo edhe me zhvillimin e tij në gjuhën angleze.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	GVJ konstatoi se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve janë një kombinim i metodave tradicionale me ato bashkëkohore të vlerësimit përfundimtar të studentit. Vlerësimi nga pikëpamja akademike e mësimin, projekteve, detyrave, praktikave, seminarave dhe punëve të ngjashme bëhet në bazë të njësisë matëse të orës së performuar në auditor. Vlera e krediteve të një lënde përbëhet nga numri total i orëve javore të parashikuara për lëndë. Gjatë një viti akademik plotësohen të paktën 60 Kredite ECTS. Studentët vlerësohen mbi bazën e provimeve të ndërmjetme; provimeve finale; detyrave; prezantimeve dhe projekteve. Metodatat e vlerësimit janë të shprehura qartë në syllabusin e çdo lënde dhe çdo lektor organizon përqindjen e vlerësimit për secilën pjesë. Llojet e vlerësimit janë: detyrat, koleqiumet, kuizet, projektet, projektet semestrale,

	<p>pjesëmarrja në mësim, provimet e ndërmjetme dhe provimet finale.</p> <p><i>1.12 Rregullore e Fakultetit</i> <i>1.11 Rregullore e Departamentit të Shkencave Kompjuterike</i> <i>1.13 Rregullore e programit - MSc në Shkenca Kompjuterik</i> <i>2.4 MSc në CS Syllabi</i> <i>2.13 MSc Cs Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik monitoron me kujdes rastet specifike dhe gjithmonë përpiqet të identifikojë kërkesat e studentëve që mund të kenë nevojë. I gjithë personeli akademik dhe ndihmës akademik i njësisë bazë është i disponueshëm për të ndihmuar studentët si në aktivitetet e tyre didaktike, ashtu edhe në zhvillimin e projekteve individuale. Për këtë qëllim, vendosin në dispozicion edhe laboratorët dhe ambientet e institucionit.</p> <p>Për të vlerësuar edhe nevoja të ndryshme apo specifike për secilin student, institucioni ka të ngritur dhe funksionale Zyrën e Mbështetjes Akademike për çështjet studentore, e cila ndihmon dhe orienton studentët gjatë jetës së tyre universitare. Gjithashtu, për të paraqitur në një këndvështrim plotësues për studentët, njësia bazë dhe ajo kryesore marrin pjesë edhe në aktivitete shkencore si konferenca apo orë të hapura ku studentët ftohen të marrin pjesë.</p> <p><i>2.4 MSc në CS Syllabi</i> <i>1.9.1 Anëtarësim në Red_Hat Academy</i> <i>1.9 Anëtarësim në Oracle</i> <i>1.8.1 MoU UNYT-IERA</i> <i>4.19 UNYT Adresa elektronike për secilin student</i> <i>4.20 UNYT Platforma Gnomon</i> <i>6.18 UNYT Strategjia e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të Vlerësimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet.</p>	<p>Institucioni demonstroi se mbështet personelin akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike. Për këtë qëllim mbështet organizimin e aktiviteteve shkencore si konferenca të organizuara nga institucioni apo në bashkëpunim me institucione të tjera. Gjithashtu stafi akademik këshillohet të marrin pjesë në aktivitete të tjera shkencore apo shkëmbime stafi në kuadër të projekteve si Erasmus+, Mevlana etj.</p> <p>Në kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe përafrimit të njohurive me nevojat e tregut të punës, institucioni ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh me institucione ndërkombëtare në fushën e teknologjisë së</p>

	<p>informacionit si “Red Hat Academy” apo anëtarësimi në “Oracle”, anëtarësimet të cilat shërbejnë jo vetëm për studentët por edhe për rritjen e njohurive të stafit akademik.</p> <p>Institucioni zbaton edhe një politikë të promovimit akademik dhe kërkimit shkencor të përcaktuar në shtyllat e kërkimit shkencor për periudha afat mesëm. Në këto dokumente paraqiten edhe rezultate të kërkimit shkencor të realizuar nga stafi i këtij institucioni për periudhën 2019-2022.</p> <p><i>2.17 UNYT Research Pillars 2019-2022</i> <i>1.9.1 Anëtarësim në Red Hat Academy</i> <i>1.9 Anëtarësim në Oracle</i> <i>1.8.1 MoU UNYT-IERA</i> <i>3.11 Konferenca</i> <i>6.18 UNYT Strategjia e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të Vlerësimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Programi i studimit mbulohet në masën më të madhe nga personeli akademik i institucionit në tërësi (PAE). Në përgjithësi personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në lëndët që mbulojnë dhe me një përvojë relativisht të gjatë në mësimdhënie. Edhe personeli akademik i jashtëm me kohë të pjesshme i angazhuar në këtë program studimi, ka formimin specifik në fushën e lëndës që mbulon. Stafi akademik, bazuar edhe në syllabuset e lëndëve, i përshtat ato me programe të ngjashme të institucioneve homologe si brenda ashtu edhe jashtë vendit.</p> <p>Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstaton se personeli akademik përdor metoda interaktive duke i bërë tërheqëse orët e mësimi. Këto metoda përfshijnë simulime, video, detyrë kursi, diskutime, prezantime etj. Përdorimi i infrastrukturës laboratorike në mësimdhënie të venë në dispozicion nga njësi kryesore, si dhe aktivitetet praktike/laboratorike e kanë rritur efektivitetin e metodave dhe interaktivitetin në mësimdhënie.</p> <p><i>2.13 MSc Cs Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB</i> <i>2.5 Academic Staff CV 2018-2023</i> <i>3.1 UNYT Manuali i Instruktorëve</i> <i>2.6 Final Project and Dissertation MSc-UNYT-UoG (deri në 2019)</i> <i>2.7 UNYT Final Project and Dissertation Guidelines (2019-onwards)</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit,</p>	<p>GVJ konstaton se një nga objektivat strategjik të UNYT, është “Cilësia dhe performanca Akademike”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se strukturat përgjegjëse kanë</p>

<p>vlërëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>zhvilluar mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p> <p>Bazuar në DVV dhe informacioni përgjatë vizitës në Fakultetin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës, konstatohet se njësia përgjegjëse për monitorimin në mënyrë periodike të aftësive të mësimdhënies së personelit akademik dhe ndihmës akademik është njësia bazë. Në të tërësi, institucioni përdor disa procese për vlerësimin e brendshëm bazuar në pyetësor, ku përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i stafit akademik nga studentët; - Vlerësimi i stafit nga kolegët; - Vlerësimi i stafit nga eprorët; <p>Drejtuuesi i njësisë bazë analizon në fund të vitit akademik performancën e çdo anëtari të departamentit dhe më pas kontakton çdo anëtar për të shprehur gjetjet dhe mundësitë për përmirësim të mëtejshëm. Nga ana tjetër UNYT ka zhvilluar të gjitha mekanizmat për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë, kështu janë rregulluar me rregulloret përkatëse zyrtar për monitorimin e brendshëm të cilësisë dhe raportimi përkatës pranë njësive kryesore dhe bazë.</p> <p>UNYT përfshin studentët në vlerësimin periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies duke ju dhënë mundësi atyre të plotësojnë pyetësorë periodikë për vlerësimin e të gjithë aspekteve akademike dhe administrative të jetës studentore.</p> <p><i>1.1 UNYT Statuti 2020</i> <i>1.14 UNYT Rules and Regulation</i> <i>1.12 Rregulloret e Fakultetit</i> <i>2.18 Annual Monitoring Report MSc CS 2021-2022</i> <i>3.8 Papers Published from MSc CS Students</i> <i>5.6 UNYT Komunikim Alumni</i> <i>6.1 UNYT Manual i Sigurimit të Cilësisë</i> <i>6.2 UNYT Raporti Vjetor NjSBC 2020-2021</i> <i>6.2.1 UNYT Raporti Vjetor NjSBC 2021-2022</i> <i>6.19 UNYT Përfshirja e studentëve në Sigurimin e Cilësisë</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë</p>	<p>Në bazë të dokumenteve të vëna në dispozicion nga institucioni konstatohet se rezultatet e vlerësimit të cilësisë përpunohen dhe përmbledhen në një raport periodik. Këto rezultate raportohen me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> <p>UNYT ka të ngritur Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Njësinë e Sigurimit</p>


<p>aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC). Këto dy organizma brenda institucionit koordinojnë punën për hartimin dhe ndjekjen e procedurave të brendshme për sigurimin e cilësisë. Procedurat e hartuara nga NjSBC ndiqen në të gjitha hallkat akademike dhe administrative të institucionit për të realizuar vlerësime periodike të kritereve të matshme dhe rritjen e treguesve përkatës.</p> <p>Të dhënat e mbledhura nga njësitë bazë, në kuadër të raporteve periodike të sigurimit të brendshëm të cilësisë, përpunohen nga NjSBC e cila përgatit raportin e vlerësimeve periodike dhe i vë në dispozicion të strukturave drejtuese, pedagogëve dhe palëve të tjera të interesuar. Rezultatet e vlerësimit shërbejnë për përmirësimin e mësimdhënies në auditor të personelit akademik, nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme ku promovohen shembuj të praktikave të mira. UNYT është angazhuar në disa projekte ndërkombëtare dhe ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me universitete ndërkombëtare me të cilat inkurajon dhe stimulon stafin të marre pjese në programe shkëmbimi siç janë Erasmus+, KA1 dhe KA2, ku një nga përfitimet kryesore është përmirësimi i aftësive të personelit akademik në mësimdhënie.</p> <p>6.1 UNYT Manual i Sigurimit të Cilësisë 6.2 UNYT Raporti Vjetor NjSBC 2020-2021 6.2.1 UNYT Raporti Vjetor NjSBC 2021-2022 6.8 UNYT Internal Audit Procedure 6.9 UNYT Formular Vlerësimi nga Studentet 6.10 UNYT Individual Performance Assessment Form 6.16 UNYT Plan Vjetor NjSBC 6.17 UNYT Trajnim NjSBC 6.18 UNYT Strategjia e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të Vlerësimit 6.19 UNYT Përfshirja e studentëve në Sigurimin e Cilësisë 6.20 UNYT Vendim Rektorati për Auditin e Brendshëm</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UNYT ka të ngritur mekanizma për monitorimin e brendshëm të cilësisë, mekanizma të cilët përfshijnë edhe studentët si një hallkë e rëndësishme e procesit të monitorimit dhe përmirësimit të cilësisë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e njësisë bazë, në veçanti neni 22: Kriteret e Pjesëmarrjes; neni 23: Provimet; neni 24: Provimi përfundimtar; neni 25: Provimi për Mungesë të Justifikuar; neni 26: Provimi për Make-up; neni 27: E drejta për të apeluar rezultatet e provimit; dhe neni 28: Kalimi i një lëndë.</p> <p>Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve të cilat së bashku me rregulloren u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik.</p> <p>Studenti ka të drejtë të marri pjesë në provim për vlerësimin e njohurive nëse ka frekuentuar jo më pak se 75% të orëve në auditor të lëndës. Nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të vlerësimeve si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none">- 10% pjesëmarrja aktive;- 20% komponentë të tjerë të specifikuar në syllabus;- 30% Provim i ndërmjetëm;- 40% Provimi përfundimtar; <p><i>1.14 UNYT Rules and Regulation</i> <i>1.12 Rregullore e Fakultetit</i> <i>1.11 Rregullore e Departamentit të Shkencave Kompjuterike</i> <i>1.13 Rregullore e programit - MSc në Shkenca Kompjuterik</i> <i>2.4 MSc në CS Syllabi</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga takimi me studentët dhe me stafin akademik, GVJ konstaton se në Departamenti i Shkencave Kompjuterike, për programet që mbulon, informon studentët mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe dijeve.</p> <p>Format e kontrollit të dijeve janë të ndryshme, bazuar në specifikat e secilës lëndë. Forma të cilat janë të përcaktuara në plan-programin e lëndës dhe u bëhen të ditur studentëve në javën e parë të procesit mësimor. Studentët informohen rregullisht edhe mbi planet mësimore dhe kurrikulën e programit të studimit, këtu një rol të rëndësishëm luan edhe drejtuesi i njësisë bazë si dhe zyra për këshillimin e</p>

	<p>studentëve, si dhe informacione që studentët marrin nga sistemi elektronik në përdorim nga institucioni.</p> <p>Informacion të hollësishëm studentët përveç informimit nga pedagogu i lëndës gjejnë edhe në syllabuset e lëndëve, ku në varësi të natyrës së lëndës, nga çdo pedagog, në përputhje me rëndësinë që ka aspekti aplikativ përcaktohet pesha e secilit element në vlerësimin përfundimtar të cilat i bëhen të ditura studentit. I gjithë informacioni mbi përmbajtjen e programit të studimit gjendet lehtësisht në ambientet e njësisë bazë, sikurse edhe në sistemin elektronik ku studentët kanë qasje me kredencialet personale të ofruara nga institucioni në momentin e regjistrimit (adresë e postës elektronike në domain UNYT).</p> <p><i>1.14 UNYT Rules and Regulation</i> <i>1.12 Rregullore e Fakultetit</i> <i>1.11 Rregullore e Departamentit të Shkencave Kompjuterike</i> <i>1.13 Rregullore e programit - MSc në Shkenca Kompjuterik</i> <i>2.4 MSc në CS Syllabi</i> <i>4.3 UNYT Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse- Politika dhe procedura</i> <i>5.4 UNYT Rregullore e brendshme për veprimtarinë e sekretarisë mësimore</i></p>										
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve të cilat së bashku me rregulloren u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik.</p> <p>Studenti ka të drejtë të marrë pjesë në provim për vlerësimin e njohurive nëse ka frekuentuar jo më pak se 75% të orëve në auditor të lëndës. Nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të vlerësimeve si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Minimumi 10 pikë nga Provimi Përfundimtar ose Provimi për Make-up; - Minimumi 50 pikë në total nga Provimi i Ndërmjetëm, Aktivitetet e tjera dhe Provimi Përfundimtar; 										
	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <thead> <tr> <th style="writing-mode: vertical-rl; transform: rotate(180deg);">Pjesëmarrje (në 100)</th> <th style="writing-mode: vertical-rl; transform: rotate(180deg);">Komponentë të tjerë (në 100)</th> <th style="writing-mode: vertical-rl; transform: rotate(180deg);">Provimi i ndërmjetëm (në 100)</th> <th style="writing-mode: vertical-rl; transform: rotate(180deg);">Provimi përfundimtar (në 100)</th> <th style="writing-mode: vertical-rl; transform: rotate(180deg);">Nota Kaluese (në 100)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>10%</td> <td>20%</td> <td>30%</td> <td>40%</td> <td>100%</td> </tr> </tbody> </table>	Pjesëmarrje (në 100)	Komponentë të tjerë (në 100)	Provimi i ndërmjetëm (në 100)	Provimi përfundimtar (në 100)	Nota Kaluese (në 100)	10%	20%	30%	40%	100%
Pjesëmarrje (në 100)	Komponentë të tjerë (në 100)	Provimi i ndërmjetëm (në 100)	Provimi përfundimtar (në 100)	Nota Kaluese (në 100)							
10%	20%	30%	40%	100%							



	<ul style="list-style-type: none"> • Të paktën 75% pjesëmarrje • Kryerje e provimit të ndërmjetëm • 10 pikë në total 	Minimumi 10 pikë	Minimumi 50 pikë	
	<p>Tek komponentët e tjerë janë vlerësimi i punimeve të projekteve të studentëve apo elementë të tjerë të parashikuar në syllabusin e secilës lëndë.</p> <p><i>1.14 UNYT Rules and Regulation</i> <i>1.12 Rregullore e Fakultetit</i> <i>1.13 Rregullore e programit - MSc në Shkenca Kompjuterik</i> <i>2.4 MSc në CS Syllabi</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Institucioni ka hartuar rregullore të posaçme për të drejtat dhe detyrimet e studentëve për sa i përket vlerësimit të njohurive të përçuar në secilën lëndë.</i></p> <p><i>Ka të përcaktuar qartë të drejtat e studentëve për tu njohur apo ankimuar vlerësimin e marrë.</i></p> <p><i>Gjithashtu janë të përcaktuar dhe zbatohen mënyra për dëgjimin e opinioneve të studentëve rreth të gjithë jetës studentore.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Bazuar në DVV, syllabuset e lëndëve, vlerësimi i dijeve të studentëve bëhet duke u bazuar në pikët e grumbulluara gjatë vitit sipas formës së vlerësimit të vazhduar gjatë semestrit, pjesëmarrjes dhe diskutimeve në seminare dhe laboratorë, detyrave të kursit etj. sipas komponentëve të përcaktuar në syllabusin e lëndës, ku pesha në % dhe mënyrat e vlerësimit janë specifike sipas llojit të lëndës. Kryesisht kontrolllet dhe provimet e ndërmjetme realizoheshin pas mesit të secilit semestër.</p> <p><i>1.14 UNYT Rules and Regulation</i> <i>1.12 Rregullore e Fakultetit</i></p>

	<p>2.4 MSc në CS Syllabi 2.11 UNYT Protokollit i Provimit 2.12 UNYT Procedurat e Provimeve 2020 6.18 UNYT Strategjia e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të Vlerësimit</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive është realizuar kryesisht duke kombinuar metodat tradicionale me mjetet elektronike (hartimi, postimi dhe prezantimi i detyrave të kursit/projekteve). Sipas RVB në disa lëndë është aplikuar testimi online duke përdorur platformën “e-Exam Center”, sidomos gjatë periudhës së diktuar nga përhapja e virusit Sars-Cov2.</p> <p>Për të rritur transparencën dhe shmangur format e plagjiaturës, institucioni ka në përdorim edhe sistemin Turnitin (turnitin.com) me anë të të cilit bëhet analiza antiplagjaturë e punimeve të studentëve përfshirë këtu edhe punimin përfundimtar të diplomës.</p> <p>2.11 UNYT Protokollit i Provimit 2.12 UNYT Procedurat e Provimeve 2020 6.18 UNYT Strategjia e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të Vlerësimit</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Studenti njihet me syllabusin e secilës lëndë nga pedagogu përkatës në fillim të semestrit. Gjithashtu syllabusi mund të konsultohet nga studentët edhe në platformën elektronike “Gnomon”. Në të janë të përcaktuar edhe mënyrat e vlerësimit të njohurive. Studenti ka të drejtë të marrë pjesë në provim për vlerësimin e njohurive nëse ka frekuentuar jo më pak se 75% të orëve në auditor të lëndës. Nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të vlerësimeve si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 10% pjesëmarrja aktive; - 20% komponentë të tjerë të specifikuar në syllabus; - 30% Provim i ndërmjetëm; - 40% Provimi përfundimtar; <p>1.14 UNYT Rules and Regulation 1.12 Rregullore e Fakultetit 2.4 MSc në CS Syllabi 2.11 UNYT Protokollit i Provimit 2.12 UNYT Procedurat e Provimeve 2020 4.20 UNYT Platforma Gnomon 6.18 UNYT Strategjia e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të Vlerësimit</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe</p>	<p>Vlerësimi i njohurive bëhet sipas rregullave të përcaktuara në rregulloret institucionale. GVJ nga dokumentacioni dhe</p>

<p>aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>takimi me studentët konstaton se në kontrollin e dijeve vlerësohen dijet dhe puna individuale e studentit. Nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë, stafi akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente /feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/testimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/prezantimeve të detyrave të kursit/projekteve, duke iu dhënë këshilla/orientime për përmirësimin e performancës në të ardhmen. Studentët kanë mundësinë e rishikimit të vlerësimit dhe të qartësohen nga pedagogu i lëndës si për vlerësimin ashtu edhe për mënyrën e përmirësimit të dijeve në vijim.</p> <p><i>2.11 UNYT Protokollin e Provimit</i> <i>2.12 UNYT Procedurat e Provimeve 2020</i></p>						
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Departamenti dhe personeli akademik bazohen në rregulloren dhe procedurat e provimit dhe kodin e ndershmërisë për të mirë organizuar procesin e vlerësimit të dijeve si dhe kriteret e mbikëqyrjes dhe të masave ndëshkuese në rast plagjiaturë gjatë procesit të provimit. Për sa i përket detyrave të kursit dhe kryesisht të punimeve të diplomave, personeli akademik dhe drejtuesit e departamentit dhe fakultetit, orientojnë/miratojnë tematika kryesisht aplikative ose gjysmë aplikative, ku të dhënat që përdoren (kryesisht të punimet e diplomave) të jenë autentike. Të dhëna që gjithsesi vlerësohen me anë të sistemit “turnitin” për plagjiaturë.</p> <p>Çdo anëtar i stafit akademik dhe jo akademik sipas detyrave të ngarkuara është përgjegjës për garantimin e një niveli të lartë të ndershmërisë në çdo kohë dhe rrethanë, referuar manualit të cilësisë në UNYT si dhe Rregullores së Këshillit të Etikës.</p> <p><i>2.11 UNYT Protokollin e Provimit</i> <i>2.12 UNYT Procedurat e Provimeve 2020</i> <i>6.18 UNYT Strategjia e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të Vlerësimit</i></p>						
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit dhe gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstaton që vlerësimi kryhet me sistem me pikë me bazë 100, pikë të cilat përkthen në nota me germë (F-A) dhe me pikë cilësie me bazë 4 (0-4.00) si në vijim:</p> <table border="1" data-bbox="608 1877 1358 1982"> <thead> <tr> <th>Sistemi pikësh në 100</th> <th>Nota me germë</th> <th>Pikë cilësie (4.0)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>90 – 100</td> <td>A</td> <td>4</td> </tr> </tbody> </table>	Sistemi pikësh në 100	Nota me germë	Pikë cilësie (4.0)	90 – 100	A	4
Sistemi pikësh në 100	Nota me germë	Pikë cilësie (4.0)					
90 – 100	A	4					

85 – 89	A-	3.67
80 – 84	B+	3.33
70 – 79	B	3
65 – 69	B-	2.67
60 – 64	C+	2.33
50 – 59	C	2
45 – 49	C-	1.67
40 – 44	D+	1.33
35 – 39	D	1
0 – 34	F	0

Nota më e ulët kaluese është 50/100 apo e shprehur në germa si “C”.

Megjithatë, institucioni vlerëson në total edhe notat C-, D+ dhe D si kaluese nëse nota mesatare e semestrit të studentit është së paku 50/100 duke i quajtur këto lëndë si të kompensueshme.

Në mënyrë që të kalojë gjithë semestrin, nuk duhet të ketë lëndë të ngelura dhe nota mesatare (GPA) e semestrit duhet të jetë së paku C (d.m.th. 2.00 / 4.00 ose 50/100). Përndryshe:

- Nëse nota mesatare (GPA) e semestrit është më pak se 2,00, studenti duhet të përsërisë një ose më shumë lëndë me nota C-, D + ose D, pas miratimit të këshilluesit akademik.
- Nëse nota mesatare (GPA) e semestrit është më pak se 1.80, studenti duhet të përsërisë së paku dy ose më shumë lëndë me nota C-, D + ose D, pas miratimit të këshilluesit akademik.
- Nëse nota mesatare (GPA) e semestrit është më pak se 1.67, studenti duhet të përsërisë të gjitha lëndët me nota C-, D + dhe D.

Rezultatet e provimit ju bëhen të njohura studentëve nga sistemi informatik “Gnomon”, ose/edhe me komunikim verbal dhe individual, në departament nga pedagogu i lëndës. Komisioni i provimit/pedagogu i lëndës, bën publike për studentët edhe datën kur mund të paraqiten për tu qartësuar rreth vlerësimit. Mbas përfundimit të procesit të vlerësimit teza depozitohet në departament. Gjate vitit pedagogët janë të lirë të alternojnë metodat kontrolluese dhe vlerësuese të cilat

	<p>përfshijnë kontroll të vazhdueshëm nëpërmjet provimeve, teste me pyetje alternative, kuize, prezantime në grup ose individuale, etj.</p> <p><i>1.12 Rregullore e Fakultetit</i> <i>1.13 Rregullore e programit - MSc në Shkenca Kompjuterike</i> <i>1.14 UNYT Rules and Regulation</i> <i>2.11 UNYT Protokolli i Provimit</i> <i>2.12 UNYT Procedurat e Provimeve 2020</i></p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e njësisë bazë, në veçanti neni 22: Kriteret e Pjesëmarrjes; neni 23: Provimet; neni 24: Provimi përfundimtar; neni 25: Provimi për Mungesë të Justifikuar; neni 26: Provimi për Make-up; neni 27: E drejta për të apeluar rezultatet e provimit; dhe neni 28: Kalimi i një lënde.</p> <p><i>1.12 Rregullore e Fakultetit</i> <i>1.13 Rregullore e programit - MSc në Shkenca Kompjuterike</i> <i>1.14 UNYT Rules and Regulation</i></p>			
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>				
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UNYT ka të përcaktuar në aktet rregullatore të gjithë procedurat që duhet të ndiqen si nga stafi akademik, ashtu edhe nga studentët në kuadër të transparencës të vlerësimit të dijeve.</i></p> <p><i>Studentët kanë të gjitha mekanizmat për tu informuar, ankimuar dhe marrë përgjigje të plotë rreth çdo paqartësie që mund të kenë në lidhje me vlerësimet, dijet e marra dhe jetën e tyre studentore në tërësi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.4

15.

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit te dokumentacionit përkatës konstaton se plani mësimor i programit të studimit përfshin lëndë karakterizuese me formim teorik dhe praktik në fushën e teknologjisë së informacionit. Njohuri që në përfundim, paraqiten në përgatitjen e punimit të diplomës.</p> <p>Syllabuset e lëndës/modulit paraqesin objektivat, aftësitë dhe kompetencat që fiton studenti në lëndën përkatëse. Departamenti ofron shërbime shtesë krahas procesit mësimor, të tilla si konsultime apo leksione te hapura. Stafi akademik përfshin studentët në veprimtari jashtë kurrikulare. Gjithashtu, shkëmbimet e studenteve ndihmojnë në përthithjen e aftësive ne fushën e IT, gjuhëve të programimit, softwar-eve të ndryshëm etj.</p> <p><i>1.3 Strategjia e Zhvillimit të Programit</i> <i>2.4 MSc në CS Syllabi</i> <i>2.13 MSc Cs Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB</i> <i>1.5 Market Study</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit, Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike”, është i gjithi i organizuar në fushën e teknologjisë së informacionit. Këtu bëjnë pjesë jo vetëm lëndët karakterizuese (B) por edhe ato ndërdisiplinore (C) të parashikuara në VKM 41 e modifikuar. Njohuri që studentët i marrin tërësisht në gjuhën angleze, duke i aftësuar jo vetëm teknikisht, por edhe të aftë të komunikojnë me efikasitet në një gjuhë ndërkombëtare si ajo angleze.</p> <p><i>1.3 Strategjia e Zhvillimit të Programit</i> <i>2.4 MSc në CS Syllabi</i> <i>2.13 MSc Cs Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e</p>	<p>Bazuar në dokumentet e dosjes së vetëvlerësimit dhe në veçanti rregullores së programit të studimit dhe atyre institucionale, konstatohet se në fund të çdo semestri, kompetencat dhe aftësitë e studentëve, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e secilës lëndë, analizohen dhe rishikohen. Kujdes i veçantë u kushtohet lëndëve që janë në vijimësi të lëndëve të tjera në semestrat pasardhës dhe mbahet komunikim midis lektorëve të lëndëve që janë të ndërlidhura.</p> <p><i>1.3 Strategjia e Zhvillimit të Programit</i></p>

tyre, si dhe për detyrimet përmblyëse.	2.4 MSc në CS Syllabi
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundur dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Institucioni garanton qasje në laboratorët e informatikës dhe teknologjisë së informacionit në tërësi, për studentët e këtij programi studimi. Edhe pse në plan-programet e lëndëve nuk është e ndarë qartë aktiviteti i seminareve/ushtrimeve, gjatë takimit në institucion dhe në veçanti me studentët e këtij programi studimi u konfirmua zhvillimi i ushtrimeve si seminare të zbatuar në ambiente laboratorike për të gjitha lëndët e teknologjisë së informacionit.</p> <p>Edhe nga stafi akademik, u vu në dukje, se zhvillimi i seancave laboratorike janë të gërshetuara me ato teorike (seminare/ushtrime) të cilat studenti motivohet ti zbatojë praktikisht në aktivitet laboratorik.</p> <p>GVJ, gjatë takimit me stafin akademik konstaton se studentët inkurajohen për të punuar në grup në zgjidhjen e detyrave apo projekteve të kursit, gjatë procesit mësimor, në praktika, laboratorë etj. Kjo punë realizohet nën drejtimin e pedagogut udhëheqës apo të lëndës. GVJ konstaton se në njësinë bazë përgjegjëse për këtë program studimi, ka klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative dhe kërkimore, në bashkëpunim studentët-pedagog.</p> <p><i>1.3 Strategjia e Zhvillimit të Programit</i> 2.4 MSc në CS Syllabi</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik i njësisë bazë angazhohet në aktivitete shkencore, në konferenca, simpoziume dhe workshope, si dhe mundëson zhvillimin e orëve të hapura nga pedagog të ftuar pranë këtij institucioni.</p> <p>Stafi i njësisë bazë, i angazhuar në këtë program studimi, organizon diskutime me studentet për temat e diplomës, për mundësitë e punësimit të tyre, u prezanton pjesëmarrjen e departamentit në konferenca dhe simpoziume, merr pjesë dhe organizon grupe pune studimore me pjesëmarrjen e studentëve.</p> <p><i>2.5 Academic Staff CV</i> 6.2 UNYT Raporti Vjetor NjSBC 2020-2021 6.2.1 UNYT Raporti Vjetor NjSBC 2021-2022 6.19 UNYT Përfshirja e studentëve në Sigurimin e Cilësisë</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara</p>	<p>Stafi akademik i njësisë bazë mbështet studentët për zhvillimin e ideve të tyre në ambientet e institucionit duke vënë në dispozicion të gjithë bazën laboratorike. Gjatë</p>

17.

<p>kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>takimit me studentët e këtij programi studimi u vu në dukje mbështetja dhe ndihma e stafit akademik për studentët në zhvillimin e projekteve dhe paraqitjen e tyre në aktivitete shkencore.</p> <p><i>3.8 Papers Published from MSc CS Students</i> <i>3.9 MSc CS Students Awards</i> <i>3.10 Aktivitete në Departament</i> <i>3.10.1 UNYT MKT Aktivitete + Seminare</i> <i>3.11 Konferenca</i> <i>3.11.1 2nd Conference in Business Research & Management</i> <i>3.11.2 1st International Student e-Congress 2020 - Agenda</i> <i>3.11.3 International Conference on Social and Applied Sciences 2021 – Agenda</i> <i>4.31 UNYT Plan Buxhet</i> <i>4.32 Mbështetje për aktivitete shkencore</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit aftëson studentë në fushën e teknologjisë së informacionit në tërësi si nga ana profesionale ashtu edhe kërkimore shkencore.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Institucioni parashikon procesin e diplomimit të studentëve në tërësi në aktet e brendshme rregullatore duke e detajuar atë në rregulloren e Projektit të Diplomimit. Rregullorja e njësisë bazë dhe ajo e programit të studimit, paraqesin qartë procesin, procedurat dhe kriteret që studentët duhet të ndjekin deri në procesin e diplomimit në këtë program studimi. Procedura më specifike realizimin e punimit të diplomës e më pas në mbrojtjen e saj, gjenden në rregulloren e projektit të Diplomimit, Manualin e Projektit të diplomimit së bashku me detyrat e pedagogëve udhëheqës.</p> <p><i>1.13 Rregullore e programit - MSc në Shkenca Kompjuterike</i> <i>3.1 UNYT Manuali i Instruktoveve</i> <i>2.7 UNYT Final Project and Dissertation Guidelines (2019-onwards)</i></p>




<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët u evidentua se ata asistoheshin nga këshilluesi akademik në takime informuese apo edhe me komunikime elektronike, rreth procedurave të zhvillimit të praktikave profesionale si dhe ato që duhen ndjekur për hartimin e punimit të diplomës.</p> <p>Takimet me këshilluesin akademik në veçanti, i ndihmojnë studentët të kuptojnë edhe më mirë mënyrën e zhvillimit të punimit si dhe mbrojtjes së diplomës.</p> <p>Përgjegjës për mbarëvajtjen e të gjithë procesit akademik, përfshirë edhe diplomimin e studentëve, është njësia bazë, Departamenti i Shkencave Kompjuterike. Kjo njësi cakton pedagogët udhëheqës të diplomave, të cilët udhëzojnë studentët gjatë këtij procesi.</p> <p><i>3.1 UNYT Manuali i Instruktoveve</i> <i>2.7 UNYT Final Project and Dissertation Guidelines (2019-onwards)</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Studentët e këtij programi studimi përmbyllin këtë cikël studimesh duke realizuar mbrojtjen e një punimi diplome, punim i cili është ndjekur me një nga pedagogët e caktuar nga njësia bazë.</p> <p>Pjesë e punimit të diplomës është edhe zhvillimi praktik i tij, në kuadër edhe të praktikës profesionale e cila nuk është parashikuar e pa varur për këtë program studimi.</p> <p>Nuk realizohet diplomim me provim, prandaj edhe njohuritë në tërësi të fituara gjatë këtij programi studimi testohen në projekt diplome që studenti realizon nën udhëheqjen e pedagogut.</p> <p><i>1.13 Rregullore e programit - MSc në Shkenca Kompjuterike</i> <i>2.7 UNYT Final Project and Dissertation Guidelines (2019-onwards)</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas</p>	<p>Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit personeli akademik i departamentit dëshmon se udhëzon dhe ndihmon studentët në përgatitjen e tezës së diplomës. Në këtë proces angazhohet jo vetëm udhëheqësi i punimit të temës së diplomës por edhe pedagogë të tjerë, specialistë të fushave përkatëse për të kontribuar më mirë në përgatitjen e një punimi cilësor, në të përfshihet edhe stafi ndihmës akademik.</p> <p>GVJ konstaton se udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve dhe konkluzioneve, përpunimin e tyre, si dhe paraqitjen dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve</p>

<p>udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve, originalitetin e tyre dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p> <p><i>3.1 UNYT Manuali i Instruktoveve</i> <i>2.6 Final Project and Dissertation MSc-UNYT-UoG (deri në 2019)</i> <i>2.7 UNYT Final Project and Dissertation Guidelines (2019-onwards)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Diplomimi i studentëve të këtij programi studimi realizohet me mbrojtjen e një projekt diplome dhe vlerësohet me notë nga komisioni i mbrojtjes së diplomës.</p> <p>Vlerësimi përfundimtar është një mesatare e vlerësimeve të pavarura të anëtarëve të komisionit pas prezantimit të temës nga kandidati dhe pas përgjigjeve të pyetjeve të ngritura nga komisioni. Nota i komunikohet studentit në prani të komisionit nga kryetari i tij.</p> <p><i>1.13 Rregullore e programit - MSc në Shkenca Kompjuterike</i> <i>2.7 UNYT Final Project and Dissertation Guidelines (2019-onwards)</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, pasi studenti plotëson të gjitha kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë 120 kredite ECTS, zyrat administrative përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentin. Sekretaria mësimore pajis studentët e diplomuar me diplomën dhe suplementin e saj sipas formateve të aprovuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p>Diploma lëshohet vetëm një herë, dhe regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. Në sekretarinë mësimore dhe në atë të njësisë kryesore, ruhet i gjithë dokumentacioni për çdo vit akademik, dhe studenti, edhe mbasi është diplomuar, mund të kërkojë dhe të marrë, kopje të dokumentacioneve që kanë qenë në fuqi në periudhën kur ka qenë student pranë këtij institucioni.</p> <p><i>3.7 UNYT Procedurat e Lëshimit të Diplomës 2020.</i></p>

	4 UNYT Rregullore e brendshme për veprimtarinë e sekretarisë mësimore 5.5 UNYT Rregullore e Arkivës			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion konstatohet se të gjitha dokumentet e studentëve gjatë studimeve të tyre arkivohen sipas akteve ligjore në fuqi. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, vihet re një organizimi i arkivës dhe i materialeve për çdo student lehtësisht të aksesueshme nga personeli i sekretarisë në çdo moment. Kjo procedurë lehtëson punën e sekretarisë mësimore për hartimin e vërtetimeve të ndryshme që mund të kërkohen nga studentët apo ish student në çdo kohë. 5.4 UNYT Rregullore e brendshme për veprimtarinë e sekretarisë mësimore 5.5 UNYT Rregullore e Arkivës			
Konkluzione	UNYT ka të përcaktuar qartë procedurat e mbylljes së studimeve, mbrojtjen e diplomës apo të provimit të formimit. UNYT pajis studentët me diplomën sipas standardit të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, së bashku me suplementin e saj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Nuk aplikohet
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e	Nuk aplikohet

TF.

praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	
Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Nuk aplikohet
Konkluzione	Nuk aplikohet
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet
	Përmbushet pjesërisht
	Përmbushet kryesisht
	Përmbushet plotësisht
	X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet
	Përmbushet pjesërisht
	Përmbushet kryesisht
	Përmbushet plotësisht
	X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT


Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat	Sipas përcaktimeve ligjore, personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Stafi akademik për programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" sipas titujve dhe gradave paraqitet si vijon:

17.

ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Kualifikimi i stafit akademik të PS	2020-2021		2021-2022		2022-2023																			
		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																		
	Prof. Dr	-	-	1	-	1	1																		
	Prof. Asoc.	1	-	-	-	1	-																		
	Dr/Phd	4	3	4	4	3	3																		
	Msc.	1	-	1	-	1	-																		
	Gjithsej	6	3	6	4	6	4																		
<p>GVJ konstaton se përgjithësisht plotësohen kriteret ligjore, me përjashtim të një rasti, për të cilin, nga shqyrtimi i CV rezultojnë se ka kualifikimin dhe eksperiencën e duhur për mësimdhënie në këtë cikël (eksperiencë rreth 15-vjeçare dhe një numër botimesh). Gjithashtu, fusha kërkimore e stafit të angazhuar në mësimdhënie është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve.</p> <p><i>2.13 MSc Cs Tabelat permbledhese per Aneks_RVB, Tabela 7</i></p> <p><i>2.5 Academic Staff CV 2022-2023</i></p>																									
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	<p>Përballimi i ngarkesës mësimore nga personeli akademik, në 5 vitet e fundit, paraqitet si vijon:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>PAE (%)</th> <th>PAK(%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2018-2019</td> <td>79.5 %</td> <td>20.5 %</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>63.8 %</td> <td>36.2 %</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>75.4 %</td> <td>24.6 %</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>75.2 %</td> <td>24.8 %</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>67.8 %</td> <td>32.8 %</td> </tr> </tbody> </table> <p>GVJ konstatoi se ka variacione përsa i përket mbulimit të ngarkesës mësimore nga personeli akademik efektiv duke patur raste kur zbritet nën kufirin minimal të përcaktuar nga korniza ligjore në fuqi.</p> <p><i>GVJ rekomandon angazhimin e institucionit për respektimin në mënyrë të vazhdueshme të kornizës ligjore në fuqi përsa i përket mbulimit të ngarkesës mësimore për programin e studimit.</i></p>							Viti akademik	PAE (%)	PAK(%)	2018-2019	79.5 %	20.5 %	2019-2020	63.8 %	36.2 %	2020-2021	75.4 %	24.6 %	2021-2022	75.2 %	24.8 %	2022-2023	67.8 %	32.8 %
Viti akademik	PAE (%)	PAK(%)																							
2018-2019	79.5 %	20.5 %																							
2019-2020	63.8 %	36.2 %																							
2020-2021	75.4 %	24.6 %																							
2021-2022	75.2 %	24.8 %																							
2022-2023	67.8 %	32.8 %																							

	<p><i>Dokumenta shtesë nga vizita në institucion: 3. Tab MSc ne CS</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Nga analiza e DVV dhe vizita në institucion GVJ konstatoi se personeli akademik efektiv i angazhuar në programin e studimit në vitet akademike nga 2020-2021 e deri në 2022-2023 është luhatur në kufijtë 60% deri 67%. Nga takimet me përfaqësues të sektorit të Burimeve Njerëzore GVJ u informua se personeli akademik me kohë të plotë i angazhuar në programin e studimit ka lidhur kontratë pune me afat të caktuar për kategorinë Asistent lektor (1 vjeçare) dhe me afat të pacaktuar për kategoritë Lektor dhe Profesor sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. UNYT garanton dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore të personelit akademik të punësuar. Personeli akademik me kontratë angazhohet mbi bazën e kontratave vjetore duke patur avantazh në sistemin e pikëzimit PAK i angazhuar edhe më parë (ky i fundit nuk thirret për intervistë).</p> <p><i>2.13 MSc Cs Tabelat permbledhese per Aneks_RVB</i> <i>4.28 UNYT Kontratë Pune me kohë të plotë me afat të pacaktuar;</i> <i>4.28.1 UNYT Kontratë Pune me kohë të pjesshme;</i> <i>4.28.2 UNYT Kontratë Pune me kohë të plotë me afat të përcaktuar.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Rekrutimi i personelit akademik kryhet nëpërmjet procedurave të përcaktuara në Statutin e UNYT dhe në aktet e tjera rregullatore të institucionit. Në Statut përcaktohet se njësia bazë, bazuar në analizën e nevojave, identifikon dhe propozon nevojën për një vend pune. Kriteret e punësimit dhe kualifikimet e kërkuara për personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit, dhe miratohen nga Rektori dhe vendi vakant publikohet për një thirrje pas miratimit paraprak nga Administratori i Universitetit. Të gjitha aplikimet rishikohen nga Komisioni Ad Hoc i ngritur në nivel fakulteti, ndërsa propozimi i Komisionit Ad Hoc në lidhje me kandidatët e përzgjedhur duhet të miratohet nga Rektori dhe nga Administratori i Universitetit. Në procesin e përzgjedhjes i jepet prioritet gradave shkencore dhe titujve akademikë, përvojës në mësimdhënie dhe kërkim shkencor si dhe kapacitetit për mësimdhënie në gjuhën angleze. Gjatë takimit në zyrën e Burimeve Njerëzore, GVJ u njoh me procedurën e rekrutimit të personelit akademik duke ju referuar edhe 4 dosjeve të zgjedhura në mënyrë të</p>

	<p>rastësishme (2 PAK dhe 2 PAE). GVJ e gjeti procedurën e aplikuar në përputhje me aktet rregullatore të institucionit.</p> <p>Referuar personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi GVJ konstatoi se ky personel ka kualifikimin e duhur. Në mënyrë të detajuar përbërja për vitin akademik 2022-2023 paraqitet si vijon:</p> <table border="1" data-bbox="608 495 1366 842"> <thead> <tr> <th>Kualifikimi</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr.</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>1</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Dr./PhD</td> <td>3</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Dr. në proces</td> <td>1</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td>6</td> <td>4</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>1.1 UNYT Statuti 2020;</i> <i>4.24 UNYT Politikat dhe Procedurat e Departamentit të Burimeve Njerëzore;</i> <i>4.25.1 UNYT Formati standard i procedurës së rekrutimit;</i> <i>2.13 MSc Cs Tabelat permbljedhese per Aneks_RVB;</i> <i>Vizita në institucion.</i></p>	Kualifikimi	PAE	PAK	Prof. Dr.	1	1	Prof. Asoc.	1	0	Dr./PhD	3	3	Dr. në proces	1	0	Total	6	4
Kualifikimi	PAE	PAK																	
Prof. Dr.	1	1																	
Prof. Asoc.	1	0																	
Dr./PhD	3	3																	
Dr. në proces	1	0																	
Total	6	4																	
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Mirëmbajtja e laboratorëve mbulohet nga zyra e TI-së e cila përbëhet nga dy specialistë të cilët ndjekin çdo problematike të shfaqur në sallat kompjuterike dhe japin suportin e tyre për çdo student, staf administrativ dhe akademik. Nga analiza e DVV dhe gjatë vizitës në institucion GVJ u informua për kontributin nga ana e këtij personeli në instalimin e programeve informatike (referuar politikave përkatëse të miratuara), mirëmbajtjen e laboratorëve etj.</p> <p><i>4.15 UNYT Politika e Instalimit të Softwar;</i> <i>Vizita në institucion;</i> <i>RVB.</i></p>																		
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të</p>	<p>UNYT ka në strukturën e tij zyrën e Burimeve Njerëzore, e cila është përgjegjëse për administrimin e dosjeve të personelit akademik (me kohë të plotë dhe të pjesshme) dhe administrativ. Baza e të dhënave e disponuar përditësohet vazhdimisht në përputhje me numrin total të anëtarëve të personelit të angazhuar në program dhe mbulimit të ngarkesës së programit. GVJ u informua se të dhënat menaxhohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Gjithashtu Zyra Ligjore e UNYT ka hartuar një dokument specifik i cili rregullon</p>																		



<p>studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>mbrojtjen e të dhënave personale, dokument i cili nënshkruhet nga stafi i kontraktuar. Një numër elementësh që lidhen me CV e personelit akademik janë botuar dhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit.</p> <p><i>4.24 UNYT Politikat dhe Procedurat e Departamentit të Burimeve Njerëzore;</i> <i>4.23 UNYT Deklarate Pelqimi;</i> https://unyt.edu.al/index.php/faculty/</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV rezulton se UNYT ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e institucione të sektorit publik. Megjithatë, praktika profesionale nuk është element i veçantë i planit mësimor të programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike", por elementë të saj janë të integruar edhe në përgatitjen e tezës së diplomës për të cilën janë parashikuar 30 ECTS.</p> <p><i>GVJ është i mendimit se programimi i praktikës mësimore si një element i veçantë dhe realizimi i saj pranë institucioneve me të cilët UNYT ka marrëveshje bashkëpunimi do të kontribonte më mirë në realizimin e formimit në këtë diplomë.</i></p> <p><i>5.1 UNYT Lista e MoU;</i> <i>1.7 Curricula;</i> <i>2.13 MSc Cs Tabelat permbledhese per Aneks RVB (Tabela 10);</i> <i>2.4 MSc ne CS Syllabi;</i> <i>Takime në institucion.</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>GVJ konstaton se praktika profesionale është e integruar me temën e diplomës dhe si e tillë kryhet mbi baza individuale dhe varet shumë nga tema e zgjedhur. Në këtë aspekt nuk ka një vlerësim për të si një element i veçantë as nga personeli akademik i UNYT dhe as nga institucionet pritëse.</p> <p><i>2.13 MSc Cs Tabelat permbledhese per Aneks RVB (Tabela 10);</i> <i>Takime me studentët e programit</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>– <i>GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit dhe realizimin e procesit mësimor si dhe fusha</i></p>



	<p>kërkimore është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve ;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ngarkesa mësimore realizohet kryesisht nga personeli akademik efektiv duke respektuar detyrimet ligjore e nënligjore në fuqi; - Rekrutimi i personelit akademik kryhet nëpërmjet procedurave të mirë përcaktuara dhe të pasqyruara në aktet rregullatore të UNYT; - Praktika profesionale paraqitet e integruar me realizimin e temës së diplomës. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe nga vizita në institucion GVJ pati mundësinë të konstatojë një zhvillim të konsiderueshëm të infrastrukturës në UNYT nëpërmjet një investimi të ri i cili ka çuar aktualisht në disponimin e një hapësirë shfrytëzimi prej 2850 m² dhe 3000 m² duke ofruar ambiente bashkëkohore, me pajisje dhe teknologji moderne. Nga vizita në mjediset e vëna në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimor, GVJ konstatoi se ato janë të mjaftueshme, me kushte shumë të mira, ndërsa laboratorët janë të kompletuar me pajisje të viteve të fundit, të mirëmbajtur dhe në kompjuterat përkatës janë instaluar software e duhur për zhvillimin cilësor të procesit mësimor.</p> <p>2.13 MSc Cs Tabelat permbledhese per Aneks RVB (Tabela 16); 4.11 UNYT Relacion Arkitektonik; 4.12 UNYT Siperfaqja në funksion të mesimdhënies; Vizita në institucion</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në ambientet e UNYT konstatoi se disponohen klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, të cilat janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e</p>

<p>teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Gjithashtu referuar DVV dhe nga vizita në institucion GVJ konstatoi se personeli akademik disponon hapësira të mjaftueshme dhe të mirëpaisura për zhvillimin e aktivitetit të tij në shërbim të programit të studimit.</p> <p><i>Vizita në institucion;</i> <i>4.17 UNYT IT Sherbimet</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Për programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" realizimi i seancave të ushtrimeve, seminareve, detyrave të kursit dhe projekteve kërkon mbështetjen e një baze të fuqishme informatike. GVJ konstatoi se nga ana e institucionit në përgjithësi dhe Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës në veçanti i është kushtuar një vëmendje e veçantë pajisjes me infrastrukturën e duhur informatike në mbështetje të programit. Gjithashtu programet informatike të instaluar mbështesin plotësisht zhvillimin e lëndëve të programit mësimor. GVJ, gjatë vizitës së ambienteve, pati rastin të njihet me këtë infrastrukturë laboratorike dhe është i mendimit se i plotëson më së miri kërkesat e moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> <p><i>4.17 UNYT IT Sherbimet;</i> <i>4.15 UNYT Politika e Instalimit të Softwar;</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Për vetë natyrën e programit të studimit, mbështetja për realizimin e tij janë laboratorët e informatikës, të cilët janë të paisur me programe profesionale dhe mbështesin realizimin cilësor të procesit mësimor me gjithë elementë e tij përbërës. Mirëmbajtja e laboratorëve mbulohet nga zyra e TI-së e cila përbëhet përbëhet nga dy specialistë të cilët ndjekin çdo problematike të shfaqur në sallat kompjuterike dhe japin suportin e tyre për çdo student, staf administrativ dhe akademik.</p> <p><i>4.15 UNYT Politika e Instalimit të Softwar;</i> <i>4.17 UNYT IT Sherbimet</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV rezulton se UNYT ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e institucione të sektorit publik. Mbi këtë bazë zhvillohet projekti i diplomës, në</p>

<p>institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>kuadër të të cilit kryhet edhe praktika profesionale. Përzgjedhja e institucionit për realizimin e praktikës në kuadrin e diplomës bëhet individualisht nga studenti dhe zyrtarizohet nëpërmjet komunikimit me institucionin pritës nga Zyra e Karrierës.</p> <p>5.1 UNYT Lista e MoU; 1.7 Curricula; 2.13 MSc Cs Tabelat permbledhese per Aneks RVB (Tabela 10).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Mjediset e vëna në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimor janë të mjaftueshme, me kushte shumë të mira, ndërsa laboratorët janë të kompletuar me pajisje të viteve të fundit, të mirëmbajtur dhe në kompjuterat përkatës janë instaluar software e duhur për zhvillimin cilësor të procesit mësimor. – Infrastruktura informatike plotëson më së miri kërkesat e moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. – Mirëmbajtja e laboratorëve mbulohet nga zyra e TI-së, personeli i të cilës ndjek çdo problematikë të shfaqur në sallat kompjuterike duke dhënë suportin e tyre për çdo student, staf administrativ dhe akademik. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi IV.3</p>	
<p>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>




<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Gjuha në të cilën zhvillohet procesi mësimor për programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" është gjuha angleze. Nga takimet me personelin akademik dhe studentët, GVJ u informua se literatura bazë është e përditësuar, e përshtatshme dhe e përdorur në nivel ndërkombëtar në programe të ngjashme. Gjithashtu studentëve u vihen në dispozicion nëpërmjet platformave të ndryshme nga ana e pedagogëve edhe leksionet (të shkruara ose prezantime Powerpoint), të cilat përmbajnë një informacion më të përditësuar (përdoren Google Sites).</p> <p><i>Takime në institucion; 2.4 MSc ne CS Syllabi; 4.1 UNYT Raport per Blerjen e Literatures.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Përditësimi i literaturës mbështetet nga një buxhet i dedikuar bibliotekës dhe pasqyrohet në syllabuset e lëndëve. Zhvillimi i mësimdhënies në gjuhën angleze lehtëson procesin e sigurimit të literaturës që i korrespondon viteve të fundit. Gjithashtu për vetë specifikat e programit, ka një numër të konsiderueshëm botimesh që mbulojnë këtë fushë përfshirë dhe tekste apo materiale të tjera didaktike që mund të përftoheshin online në format elektronik. Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve vënë në dispozicion nëpërmjet DVV, GVJ konstatoi në to janë pasqyruar përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p> <p><i>Takime në institucion; 2.4 MSc ne CS Syllabi; 4.1 UNYT Raport per Blerjen e Literatures.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ u informua se Biblioteka e UNYT disponon një sipërfaqe prej 215 m² si dhe është e ndarë në dy ambiente kryesore, njëri prej të cilëve ka vende studimi për 48 persona dhe posedon koleksionin fizik kryesor, dhe Zonën e Kompjuterave, e cila ka 12 vende me kompjutera për qasjen e materialeve elektronike si dhe 2 tavolina për punë në grup, secila me nga 5 studentë. Faqja web e dedikuar kërkimit të literaturës në bibliotekë mundëson përfitim në kohë reale edhe në distancë të informacionit mbi disponibilitetin në bibliotekë të literaturës duke ju referuar kërkimit mbi bazën e titujve apo autorëve.</p> <p>GVJ u informua se studentët e programit të studimit kanë mundësinë të shfrytëzojnë bibliotekën fizike, nga e hëna në të premte, në orarin 9:00 - 21:30, ditën e shtunë në orarin 9:00 – 17:00, ndërsa ditën e diel në orarin 9:00-18:00. Gjithashtu</p>

	<p>studentët kanë mundësinë të shfrytëzojnë edhe një numër bibliotekash on-line.</p> <p><i>Vizita në institucion;</i> https://unyt.edu.al/index.php/facilities/ (rubrika Library); https://library.unyt.edu.al/.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se biblioteka UNYT është e pajisur me fond fizik të pasur që mbulon literaturën bazë të programit të studimit. Kjo lehtësohet dhe nga fakti që mësimdhënia zhvillohet në gjuhën angleze. Në total biblioteka ka një numër materialesh të kataloguara prej 8100 tituj akademik dhe 8480 volume.</p> <p><i>Vizita në institucion;</i> https://unyt.edu.al/index.php/facilities/ (rubrika Library); RVB; https://library.unyt.edu.al/</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e UNYT ofron dhe shërbimin e bibliotekës elektronike nëpërmjet abonimit dy baza të dhënash elektronike JSTOR dhe EMERALD Insight duke ofruar kështu mundësinë e një kërkimi të plotë të tekstit përmes koleksioneve të tyre. Gjithashtu përmes një bashkëpunimi me Empire State College, studentët e UNYT dhe stafi akademik kanë qasje në bazat e të dhënave si: EBSCOHost, PROQUEST, APA, GALE, Sage etj.</p> <p><i>Vizita në institucion;</i> https://unyt.edu.al/index.php/facilities/ (rubrika Library); RVB; https://library.unyt.edu.al/</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Zona e Kompjuterave ndodhet brenda ambienteve të bibliotekës dhe ka 12 kompjutera të lidhura në rrjet në dispozicion për studentët si dhe ofron një shërbim printimi falas. E gjithë zona e bibliotekës është e mbuluar me lidhje wireless.</p> <p><i>Vizita në institucion;</i> https://unyt.edu.al/index.php/facilities/ (rubrika Library); RVB</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare</p>	<p>GVJ u informua se studentët e programit të studimit kanë mundësinë të shfrytëzojnë bibliotekën fizike, nga e hëna në të premte, në orarin 9:00 - 21:30, ditën e shtunë në orarin 9:00 –</p>

<p>shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>17:00, ndërsa ditën e diel në orarin 9:00-18:00. Këto orare janë më se të mjaftueshëm për një shfrytëzim optimal të mundësive që ofron biblioteka dhe mbulojnë plotësisht oraret e zhvillimit të procesit mësimor.</p> <p><i>Vizita në institucion;</i> https://unyt.edu.al/index.php/facilities/ (rubrika Library)</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>GVJ konstaton përpjekje të institucionit në përgjithësi dhe Departamentit të Shkencave Kompjuterike në veçanti për pasurimin e bibliotekës dhe plotësimin e kërkesave të stafit akademik me tekste. Në raportin për blerjen e librave paraqitet informacion i detajuar mbi blerjet e 31 titujve të fushës së shkencave kompjuterike nga të cilët 17 tituj të kërkuar nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike. Referuar informacionit të DVV, biblioteka e UNYT frekuentohet çdo ditë mesatarisht nga 80 - 100 përdorues dhe sasia e materialeve libra dhe atyre online që qarkullojnë dhe aksesohen çdo ditë numëron rreth 240 tituj.</p> <p><i>RVB;</i> 4.1 UNYT Raport per Blerjen e Literatures; 4.9 UNYT Politika dhe Procedura e Bibliotekes</p>
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Literatura bazë e disponueshme është e përditësuar, e përshtatshme dhe e njëjtë me atë të përdorur në nivel ndërkombëtar në programe të ngjashme;</i> - <i>Biblioteka, e cila ofron kushte shumë të mira, vihet në dispozicion të studentëve të programit të studimit gjatë gjithë javës (e hënë – e diel) me orar të zgjatur që mbulon plotësisht oraret e zhvillimit të procesit mësimor;</i> - <i>Literatura bazë është e disponueshme në fondin fizik dhe pasurohet në mënyrë të vazhdueshme me botime të reja;</i> - <i>Institucioni mundëson një qasje të gjerë në bibliotekat online duke zgjeruar në këtë mënyrë qasjen e studentëve dhe personelit akademik në një literaturë të përditësuar.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim mbahet nga Sekretaria Mësimore. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se dokumentacioni që disponohet është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. UNYT ka në përdorim një sistem të menaxhimit të informacionit (GNOMON) në lidhje me studentët, të dhënat e tyre personale, të dhënat akademike si dhe plan programet në të cilët studentët janë të regjistruar. Në këtë sistem studentët, personeli akademik, sekretaria mësimore dhe zyra e financës kanë akses të personalizuar (username/password) dhe mundësinë për të aksesura shërbime të ndryshme sipas të drejtave të akorduara.</p> <p><i>http://egnomon.unyt.edu.al/;</i> 4.20.1 UNYT E-Gnomon aksesi i studenteve; 4.20.5 UNYT Lidhja e studenteve me plan-programin; 4.20.6 UNYT Regjistrimi i Studentit në kurset e Semestrit; Vizita në institucion.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të informacionit GNOMON, mundëson menaxhimin e aktivitetit që ka të bëjë me studentin (nota e studentëve, mungesat, regjistrimin në kurset e semestrit, të dhënat financiare etj). Për sa i përket menaxhimit të informacionit dhe dokumentacionit të personelit akademik, personelit ndihmës akademik dhe personelit administrativ të angazhuar në realizimin e programit, në zyrën e Burimeve Njerëzore, ky informacion është i organizuar sipas dosjeve të posaçme të stafit, në mënyrë fizike, por edhe elektronike. Megjithatë, GVJ është i mendimit se akoma nuk kemi të bëjmë me një sistem informacioni tërësor (të integruar) për të menaxhuar plotësisht informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>

	<p>http://egnomon.unyt.edu.al/; 4.20.1 UNYT E-Gnomon aksesi i studenteve; 4.20.5 UNYT Lidhja e studenteve me plan-programin; 4.20.6 UNYT Regjistrimi i Studentit në kurset e Semestrit.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se aksesi në sistemin GNOMON mundësohet nëpërmjet faqes web, ku propozohet hyrja dedikuar studentëve dhe stafit nëpërmjet adresës email dhe fjalëkalimit të personalizuar. Nëpërmjet këtij sistemi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Studentët kanë akses në të dhënat e tyre akademike, notat, mungesat si dhe të dhënat financiare; - Stafit akademik ka akses për të parë rezultatet akademike të studentëve me qëllim që të ndjekë ecurinë e tyre dhe për të bërë këshillimin e duhur në lidhje me lëndët që studenti duhet të ndjekë në semestrin pasardhës; - Sekretaria mësimore ka akses për të dhënat e studentëve dhe vlerësimet e tyre (ruajtjen dhe aksesimin e arritjeve akademike në formatin elektronik), të dhënat për personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie etj. - Zyra e Financës ka akses në të dhënat e studentëve për sa i përket elementëve që lidhen me të dhënat financiare. <p>Veç sa më sipër në sistem kanë akses edhe Zyra e Çështjeve të Studentëve dhe Departamenti Front-Desk.</p> <p>http://egnomon.unyt.edu.al/; 4.20.1 UNYT E-Gnomon aksesi i studenteve; 4.20.5 UNYT Lidhja e studenteve me plan-programin; 4.20.6 UNYT Regjistrimi i Studentit në kurset e Semestrit; 5.4 UNYT Rregullore e brendshme për veprimtarinë e sekretarise mesimore.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>GVJ është i mendimit se sistemi i menaxhimit GNOMON nuk i korrespondon një sistemi informacioni tërësor (të integruar) për të menaxhuar plotësisht informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Për të mundësuar këtë përdoren gjerësisht forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve si nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë me email, përdorimit të Google Sites, McGraw Connect, Canvas, etj.</p> <p><i>Takime në institucion;</i></p>

	http://egnomon.unyt.edu.al/
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	<p>Sistemi i menaxhimit GNOMON mundëson monitorimin e aktivitetit akademik dhe pjesërisht administrativ të institucionit. Sistemi mundëson nxjerrjen e listave të notave të studentëve, listat e notave në bazë lënde, listë-prezencat për lëndët respektive, etj. Të dhënat e tjera që nxirren nga sistemi i menaxhimit kanë të bëjnë me raportime të ndryshme që Sekretaria mësimore bën si pjesë e punës së saj. Të dhënat janë kryesisht lista emërore të studentëve apo raportime statistikore. Gjithashtu GVJ u informua për një përdorim të gjerë dhe të komunikimit nëpërmjet email-it, përdorimit të Google Sites, McGraw Connect, Canvas, etj. si dhe të faqes zyrtare të UNYT.</p> <p><i>Takime në institucion;</i> http://egnomon.unyt.edu.al/; https://unyt.edu.al/</p>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	<p>Të dhënat për programin Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" publikohen në faqen zyrtare të UNYT. Në këtë faqe gjendet informacion i përditësuar edhe për personelin akademik, zyrat e shërbimeve studentore, kërkimin shkencor dhe projektet, aktivitete të ndryshme të organizuara në UNYT, dokumentacionin e funksionimit të institucionit, vendimet e brendshme etj. Informacioni në faqen e internetit, për momentin ofrohet vetëm në gjuhën angleze, por GVJ u informua se po punohet për zhvillimin e një faqeje të re, me informacion më të plotë dhe të mirë-strukturuar, i cili do të ofrohet në gjuhët anglisht dhe shqip.</p> <p>https://unyt.edu.al/; https://unyt.edu.al/index.php/master-programs/master-of-science-in-computer-science/</p>
Konkluzione	<ul style="list-style-type: none"> – <i>Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore dhe menaxhohet elektronikisht nëpërmjet sistemit GNOMON;</i> – <i>Studentëve, stafit akademik dhe sekretarisë mësimore u mundësohet hyrje e dedikuar nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit të personalizuar;</i> – <i>GVJ është i mendimit se sistemi i menaxhimit GNOMON nuk i korresponon një sistemi informacioni tërësor (të integruar) për të menaxhuar plotësisht gjithë informacionin e UNYT;</i>

	– Informacionet për programin Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" aktualisht publikohen vetëm në gjuhën angleze në faqen zyrtare të UNYT në seksionin e dedikuar për këtë program studimi;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	<p>GVJ u informua se në nivel institucioni, hartohen raporte financiare në të cilat paraqiten të ardhurat sipas burimeve dhe shpenzimet për vitin financiar. Në to pasqyrohen kostot e mësimdhënies dhe shpenzimet e tjera të drejtpërdrejta që lidhen me mësimdhënien, pagat e stafit mbështetës administrativ si dhe shpenzimet e tjera operationale siç janë qiraja, energjia elektrike/telefonja/interneti etj. Gjithashtu paraqiten shpenzimet kapitale si ato për kompjutera dhe pajisjet e TI, mobilet dhe asetet e tjera, kosto e aktiveve të paprekshme siç janë blerja e licencave për programet kompjuterike, tarifat e akreditimit, bibliotekat elektronike etj. Analiza financiare bëhet duke ju referuar dhe të ardhurave, të cilat kryesisht janë ato të krijuara nga tarifat e studentëve.</p> <p>4.33 UNYT Pasqyrat Financiare 2020; 4.33.1 UNYT Pasqyrat Financiare 2021; 4.35 UNYT Kosto-efektivitet; 2.13 MSc Cs Tabelat permbledhese per Aneks RVB (Tabela 18).</p>								
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive	<p>Në Statutin e UNYT përcaktohet se financimi i institucionit dhe për pasojë dhe e këtij programi studimi mbulohet nga të ardhurat e përfituara nga tarifat e studimit dhe/ose nga burime të tjera financiare. Ndërsa veprimtaria kërkimore - shkencore e UNYT financohet nga vetë universiteti ose/dhe nëpërmjet projektsh, donacionesh të ndryshme të sektorit privat apo publik. Në mënyrë të detajuar kontributi i burimeve të financimit për vitet e fundit paraqitet si vijon:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Të ardhurat</th> <th>2019</th> <th>2020</th> <th>2021</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Të ardhurat	2019	2020	2021				
Të ardhurat	2019	2020	2021						

mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.		%	%	%
	Pushteti qëndror/ vendor	0	0	0
	Grantet për kërkim dhe kontratat	4.1	3.1	0
	Tarifat për dhe gjatë shkollimit	95.9	96.9	100
	Sponsorizimet	0	0	0
	Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)	0	0	0
	Shuma	100	100	100
	<p>Nga një analizë e DVV rezulton se ka detajime të buxhetit deri në nivel Departamenti, ku jepen detaje për financimin e aktiviteteve. GVJ konstaton se pjesa dërmuese e financimit vjen nga tarifat për dhe gjatë shkollimit, ndaj duhen bërë përpjekje në veçanti për rritjen e peshës së të ardhurave të krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta dhe nga grantet për kërkim dhe kontratat.</p> <p><i>1.1 UNYT Statuti 2020</i> <i>2.13 MSc Cs Tabelat permbledhese per Aneks RVB (Tabela 18).</i> <i>4.31 UNYT Plan Buxhet</i></p>			
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	<p>GVJ u informua se Zyra e Financave e UNYT është subjekt i auditimit vjetor periodik, i cili monitoron arritjen e objektivave në efektivitetin dhe efikasitetin e operacioneve, besueshmërinë e raportimit financiar dhe menaxherial, pajtueshmërinë me politikat dhe rregulloret në fuqi Raporti i auditimit, i kryer nga një kompani e pavarur e auditimit, paraqet ekzaminimin e përputhshmërisë së shpenzimeve të realizuara me të hyrat e fituara përmes monitorimit të buxhetit dhe vlerësimit të transaksioneve dhe shpenzimeve. Sipas raportit të audituesit të pavarur, pasqyrat financiare paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të UNYT më datën 31 Dhjetor 2021, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara në Shqipëri.</p> <p><i>1.1 UNYT Statuti 2020 (Neni 77);</i> <i>4.30 UNYT Raporti i Auditit te Jashtem;</i> <i>6.8 UNYT Internal Audit Procedure;</i> <i>6.20 UNYT Vendim Rektorati per Auditin e Brendeshem</i></p>			

<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Procedura e buxhetimit në UNYT bazohet në Rregulloren përkatëse duke dalluar buxhetin e vitit akademik, buxhetin e vitit fiskal dhe buxhetin e ndërmjetëm. Drafti i buxhetit përgatitet nga administratori i UNYT në bazë të propozimeve të njësive kryesore dhe njësive bazë dhe në bazë të planit strategjik të zhvillimit. Administratori, në bashkëpunim me departamentin e financës dhe administratorët e njësive kryesore, është përgjegjës për përgatitjen e planit buxhetor vjetor. Departamenti i Financës dhe administratorët e njësive kryesore koordinojnë procesin për të mbështetur teknikisht njësitë administrative dhe akademike që marrin pjesë në procesin e buxhetit. GVJ konstaton se ka detajime të buxhetit deri në nivel Departamenti, ku jepen detaje për financimin e aktiviteteve. Raporti i vlerësimit të buxhetit përgatitet për të vlerësuar performancën e buxhetit dhe për të ekzaminuar përputhshmërinë e shpenzimeve me buxhetin. Raportet financiare lejojnë të kontrollohet administrimi i buxhetit në përputhje me objektivat dhe të matet performanca. Administratori i paraqet Rektorit raporte financiare për vlerësimin e performancës së Universitetit. GVJ u njoh me raportet financiare të viteve 2020 dhe 2021.</p> <p><i>4.34 UNYT Procedura e Buxhetimit;</i> <i>4.31 UNYT Plan Buxhet;</i> <i>4.33 UNYT Pasqyrat Financiare 2020;</i> <i>4.33.1 UNYT Pasqyrat Financiare 2021.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësive bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Nga analiza e raporteve financiare 2020 dhe 2021, GVJ konstaton se qëndrueshmëria financiare e UNYT bazuar në të ardhurat nga tarifat e shkollimit është e pa stabilizuar. Megjithatë, GVJ është i mendimit se fakti që prej vitit 2018, UNYT është pjesë e një prej grupeve më të mëdha arsimore në botë në pronësi të Fondacionit Shtetëror Turk Maarif, nën emrin e grupit të edukimit “<i>International Maarif Schools</i>” i cili operon në 67 vende në botë dhe investimi i këtij grupi në drejtim të mbështetjes së institucionit përbëjnë një garanci për vazhdimësinë e programit të studimit dhe përmirësimin e situatës financiare në vijim.</p> <p><i>4.33 UNYT Pasqyrat Financiare 2020;</i> <i>4.33.1 UNYT Pasqyrat Financiare 2021.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>– Në nivel institucioni, hartohen raporte financiare në të cilat paraqiten të ardhurat sipas burimeve dhe shpenzimet për vitin financiar;</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - Ka detajime të buxhetit deri në nivel Departamenti, ku jepen detaje për financimin e aktiviteteve; - Zyra e Financave e UNYT është subjekt i auditimit vjetor periodik; - Duhet bërë përpjekje për rritjen e peshës së të ardhurave të krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta dhe nga grantet për kërkim dhe kontratat; - Duke marrë në konsideratë situatën financiare të përgjithshme të UNYT dhe mbështetjen e Fondacionit Maarif, GVJ është i mendimit se është e garantuar mbarëvajtja e programit të studimit për të më tepër se një cikël të plotë studimi; 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Nga takimet në institucion dhe shqyrtimi i DVV, GVJ konstatoi se për programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" pranimi i studentëve, përparimi i tyre përgjatë kursit të studimit, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi mbështeten në Statutin e UNYT, Rregulloren e UNYT, Rregulloren e Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës dhe Rregulloren e Departamentit të Shkencave Kompjuterike. Këto procedura për studentët që pranohen në këtë program konsistojnë në përcaktimi i kriterëve dhe kuotave nga Senati Akademik i UNYT dhe miratimi nga MAS, aplikimin dhe regjistrimin e studentëve, pajisjen e studentëve të regjistruar me numër matriculimi nga QSHA,

	<p>pajisen, në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, me kartën e studentit.</p> <p>Si kriter pranimi në këtë program studimi është diploma Bachelor në Shkenca Kompjuterike. Për kandidatët nga drejtime të tjera të përafërta si Matematikë e Aplikuar, Elektronikë etj. kërkohet një plotësim paraprak me elementët bazë të programit (15 kredite ECTS). Studentët e këtij programi duhet të plotësojnë 120 kredite ECTS ku përfshihen 30 kredite ECTS për punimin përfundimtar. Në 90 kreditet e lëndëve që duhet të shlyejnë studentët 67.5 kredite ECTS u korrespondojnë lëndëve të detyrueshme dhe 22.5 kredite ECTS u korrespondojnë 3 lëndëve opsionale (të cilat zgjidhen nga një total prej 12 lëndësh opsionale të propozuara). Diplomimi realizohet nëpërmjet projektit final dhe disertacionit, aktivitetet për të cilin janë parashikuar 30 kredite ECTS. Në këtë kuadër realizohen edhe elementë të praktikës, por që janë të lidhur me punimin përfundimtar. GVJ konstatoi se elementët që lidhen me programin e studimit janë të aksesueshëm në faqen web të UNYT si dhe i vihen në dispozicion studentit nëpërmjet manualit të studentit. Në manualin e studentit jepen edhe elementë të rregullave të cilat duhet të pranojë dhe të zbatojë studenti gjatë ndjekjes së studimeve në këtë program studimi.</p> <p><i>1.1 UNYT Statuti 2020;</i> <i>2.10 UNYT Student Handbook ;</i> <i>1.11 Rregullore e Departamentit të Shkencave Kompjuterike;</i> <i>1.12 Rregullore e Fakultetit;</i> <i>1.13 Rregullore e programit - MSc në Shkenca Kompjuterike;</i> https://unyt.edu.al/index.php/master-programs/master-of-science-in-computer-science/#Course-Descriptions</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat e ndjekura nga Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës janë të mirë përcaktuara duke garantuar barazinë tek çdo student në këtë program studimi. GVJ konstatoi se garancia sigurohet nëpërmjet përcaktimit në rregulloret e ndryshme të të gjithë elementëve që lidhen që me pranimin në këtë program studimi, ndjekjen e procesit mësimor, vlerësimin e studentit e deri në diplomim. Procedurat e ndjekura janë në përputhje dhe përshtaten në mënyrë të vazhdueshme me udhëzimet, vendimet dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Veprimtaria mësimore organizohet dhe realizohet nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike dhe drejtohet dhe kontrollohet nga autoritetet</p>

	<p>dhe organet drejtuese përkatëse me kompetenca të përcaktuara në rregulloret përkatëse. Gjithashtu duhet theksuar se UNYT ka infrastrukturën e duhur për të mbështetur studentët me nevoja të ndryshme fizike siç janë ashensorët dhe rampat. Përveç kësaj, Qendra e Këshillimit dhe Mbështetjes Akadematike, merr parasysh mjedisin e larmishëm kulturor dhe karakteristikat socio-ekonomike të studentëve dhe përvojat e tyre të mëparshme të të mësuarit.</p> <p><i>1.14 UNYT Rules and Regulation;</i> <i>1.12 Rregullore e Fakultetit;</i> <i>1.11 Rregullore e Departamentit të Shkencave Kompjuterike</i> <i>1.13 Rregullore e programit - MSc ne Shkenca Kompjuterike;</i> <i>RVB;</i> <i>3.4 UNYT Qendra e Mbeshtetjes Akadematike & Qendra e Keshillimit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Pranimi në programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" bazohet në ligjin nr.80/2015 për "Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 76, "<i>Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të institucionit të arsimit të lartë ku ata aplikojnë</i>". Referuar kritereve të pranimit publikuar nga UNYT në këtë program studimi pranohen kandidatë me diplomë Bachelor në fushën e Shkencave Kompjuterike. Eventualisht mund të pranohen edhe kandidatë nga fusha të përafërta si Matematikë e Aplikuar, Elektronikë etj. me një plotësim me elementët bazë të programit (15 kredite ECTS). Veç kësaj kërkohet që nota mesatare e ponderuar të jetë jo më pak se 6.5. GVJ u informua se në lidhje me përcaktimin e kritereve shtesë të pranimit, duke qenë se UNYT ofron programe studimi në gjuhën angleze, zbatohet kriteri i pranimit me testim institucional ose çertifikimin përkatës të njohjes së gjuhës angleze. Për sa i përket regjistrimit të studentëve të huaj, si dhe kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, që aplikojnë për t'u pranuar në këtë program studimi kanë detyrimin të plotësojnë të njëjtat kërkesa. Veç kësaj, në rastin e studentëve me një diplomë të huaj, është i nevojshëm ekuivalentimi i diplomës Bachelor sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Për katër vitet e fundit</p>

	<p>akademike regjistrimet për programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" kanë qenë si vijon:</p> <table border="1" data-bbox="603 311 1362 680"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë</th> <th>Studentë të transferuar sipas viteve</th> <th>Totali</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2022-2023</td> <td>5</td> <td>-</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>7</td> <td>-</td> <td>7</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>4</td> <td>-</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>4</td> <td>-</td> <td>4</td> </tr> </tbody> </table> <p>Vihet re se numri i studentëve të regjistruar në këtë program vazhdon të mbetet i ulët (shumë më i ulët se kuotat e miratuara).</p> <p><i>1.13 Rregullore e programit - MSc ne Shkenca Kompjuterike;</i> <i>2.13 MSc Cs Tabelat permbledhese per Aneks RVB (Tabela 21)</i> https://unyt.edu.al/index.php/master-programs/master-of-science-in-computer-science/#Course-Descriptions http://unyt.edu.al/wp-content/uploads/2018/11/2017-Decision-32-Kriteret-e-pranimit-2017-2018-12.01.2017.pdf</p>	Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Studentë të transferuar sipas viteve	Totali	2022-2023	5	-	5	2021-2022	7	-	7	2020-2021	4	-	4	2019-2020	4	-	4
Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Studentë të transferuar sipas viteve	Totali																		
2022-2023	5	-	5																		
2021-2022	7	-	7																		
2020-2021	4	-	4																		
2019-2020	4	-	4																		
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e regjistrimit bazohen në legjislacionin në fuqi dhe shpallen pas miratimit të tyre në Senatin Akademik dhe aprovimit prej Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. GVJ konstatoi se një ndihmesë të rëndësishme në procesin e informimit të kandidatëve për studentë dhe njohjes së kriterëve dhe procedurave japin faqja web e institucionit (kryesisht për pranimet, ofertën akademike, një tablo të përgjithshme të UNYT etj.) si dhe për një numër elementësh që lidhen me programet e shkëmbimit, transferimin e studimeve etj. GVJ është i mendimit se kriteret dhe procedurat janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p> <p>https://unyt.edu.al/index.php/transfer/ ; https://unyt.edu.al/index.php/master-programs/master-of-science-in-computer-science/#The-Programme ; https://unyt.edu.al/index.php/master-programs/master-of-science-in-computer-science/#Programme-Structure ; https://unyt.edu.al/index.php/master-programs/master-of-science-in-computer-science/#Brochure .</p>																				
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik,</p>	<p>Kërkesat e kriteret për këtë program studimi publikohen në faqen web përpara fillimit të vitit akademik. Referuar</p>																				

<p>institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>takimeve në institucion, GVJ konstatoi se pjesë e informimit dhe udhëzimit të publikut janë dhe takime prezantuese të programit të studimit. Në këto takime prezantuese jepen elementë për programin e studimit, pranimin në të, mundësitë që krijohen nga diplomimi në këtë program studimi, mënyrën e realizimit të programit dhe kohëzgjatjen e tij, personat e kontaktit në UNYT, një përshkrim të Departamentit të Shkencave Kompjuterike përgjegjës për këtë program studimi, objektivat e programit, strukturën e programit, punimin përfundimtar (disertacionin) dhe udhëzuesin përkatës, bibliotekën (përfshirë bibliotekat online), sistemin Turnitin të kontrollit të plagjiaturës, sistemin e informacionit të studentit, problemet administrative, sistemin e këshillimit të studentëve, kalendarin akademik, mënyrën e komunikimit me pedagogët si dhe një numër elementësh mbi sistemin e notave, kontrolli, rivlerësimin, apelimin, përgjegjësitë e studentit etj.</p> <p>https://unyt.edu.al/index.php/master-programs/master-of-science-in-computer-science/ ;</p> <p>2.9.1 - Prezantim ne ditën e parë të studentit - Cohort 14 (2022)</p> <p>https://unyt.edu.al/index.php/master-programs/application-process/#MCS</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>GVJ u informua institucioni ka të parashikuar ndjekjen e politikave lehtësuese për studentët që vijnë nga disa kategori të veçanta sociale. Për sa i përket procedurës dhe kriterëve për këto kategori UNYT i referohet Udhëzimit Nr. 17, datë 30.07.2019 të MAS. Megjithatë, referuar kuotave të propozuara për tre vitet e fundit (2020-2021, 2021-2022 dhe 2022-2023), shihet se në totalin e 15 kuotave për vitin 2020-2021, 17 kuotave për vitin 2021-2022 dhe 15 kuotave për vitin 2022-2023, nuk janë parashikuar kuota për kategori me aftësi të veçanta. GVJ është i mendimit që UNYT duhet të jetë i hapur ndaj pranimeve nga kategoria e personave me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara duke parashikuar në vazhdim kuota pranimesh edhe për këto kategori.</p> <p><i>5.3 UNYT Kuotat për vitin akademik 2020-2021;</i> <i>5.3.1 UNYT Kuotat për vitin akademik 2021 -2022;</i> <i>5.3.2 UNYT Kuotat për vitin akademik 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret</p>	<p>GVJ u informua se UNYT propozon kuotat për kategoritë e studentëve me shtetësi të huaj. Për sa u përket kriterëve ato mbeten të njëjta si për kandidatët shqiptarë. Veç kësaj këta</p>

<p>për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>kandidatë duhet të paraqesin kopjen e diplomës dhe listës së notave të njehsuar nga QSHA. Nga ana tjetër, duke qenë se programi i studimeve zhvillohet në gjuhën angleze këta kandidatë zbatohet kriteri i pranimit me testim institucional ose çertifikimin përkatës të njohjes së gjuhës angleze.</p> <p><i>5.3 UNYT Kuotat për vitin akademik 2020-2021;</i> <i>5.3.1 UNYT Kuotat për vitin akademik 2021 -2022;</i> <i>5.3.2 UNYT Kuotat për vitin akademik 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Referuar takimeve në institucion dhe DVV, GVJ konstatoi se UNYT aplikon politika të bursave studentore kryesisht për studentët me rezultate të larta akademike. Sipas politikave të bursave të UNYT, studentët fitojnë bursa studimi deri në 100% në bazë të kriterëve si arritjet e tyre kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe provimit të bursës. Referuar provimit të bursës studentët me mesatare 9-9.49 përfitojnë 25% bursë, me mesatare 9.5-9.79 përfitojnë 50% bursë, me mesatare 9.8-9.99 përfitojnë 75% bursë dhe me mesatare 10 përfitojnë 100% bursë. Gjithashtu bursa mund të fitohen në vijim të studimeve edhe në se plotësohen kushte të tjera si për studentët e transferuar, për arritje të veçanta, etj.</p> <p><i>5.23.2 UNYT Politika e Bursave 2022-2023;</i> <i>Takime në institucion.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Politikat dhe procedurat e ndjekura nga Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës janë të mirë përcaktuara duke garantuar barazinë dhe të drejta të njëjta tek çdo student në këtë program studimi;</i> - <i>Ka një bashkëpunim të mirë ndërmjet hallkave të ndryshme të institucionit në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me pranimin e studentëve;</i> - <i>Kriteret dhe procedurat e regjistrimit bazohen në legjislacionin në fuqi dhe shpallen pas miratimit të tyre në Senatin Akademik dhe aprovimit prej MAS, duke qenë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku;</i> - <i>Institucioni ka të parashikuar ndjekjen e politikave lehtësuese për studentët që vijnë nga disa kategori të veçanta sociale. Megjithatë, përgjithësisht, nuk janë parashikuar kuota për kategori të me aftësi veçanta, ndaj rekomandohet një hapje ndaj pranimeve nga kategoria e personave me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara;</i> - <i>UNYT aplikon politika të bursave studentore kryesisht për studentët me rezultate të larta akademike.</i>

17.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Studentëve që fillojnë studimet në programin Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" u vihet në dispozicion një informacion i gjerë në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit, elementët detyrues të tij si dhe kriteret e procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. GVJ evidentoi që burimet bazë të informimit janë Rregullorja e UNYT, Rregullorja e Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës, Rregullorja e Departamentit të Shkencave Kompjuterike dhe Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike. Në këto rregullore jepen elementë të tillë si pranimi në programin e studimit, transferimi e studimeve, pezullimi i studimeve, kriteret e pjesëmarrjes, provimet e ndërmjetme dhe provimin përfundimtar, kriteret e vlerësimit, apelimi i rezultateve të provimit, kriteret për kalimin e një lënde, marrjen e një lënde nga universitete të tjera (Erasmus+ apo marrëveshje bilaterale), projekti final dhe disertacioni, etj.</p> <p><i>1.14 UNYT Rules and Regulation;</i> <i>1.12 Rregullore e Fakultetit;</i> <i>1.11 Rregullore e Departamentit të Shkencave Kompjuterike;</i> <i>2.9.1 - Prezantim ne ditën e parë të studentit - Cohort 14 (2022)</i> <i>1.13 Rregullore e programit - MSc ne Shkenca Kompjuterike</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Në aktet e tij rregullatore UNYT ka të parashikuara dhe garanton procedurat për njohjen dhe ekuivalentimin e kualifikimeve. Referuar rregulloreve dhe nga takimet në institucion, GVJ u informua se për studentët të cilët përfitojnë mobilitete jashtë vendit, në se ata fitojnë kredite në institucionet pritëse, këto kredite mund t'ju njihen edhe në UNYT, sipas një procedure të mirë përcaktuar. Në rregullore përcaktohet se të gjitha lëndët që studenti ka marrë në një</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

	<p>institucion tjetër të arsimit të lartë në përputhje me programet e shkëmbimit të studentëve (marrëveshje Erasmus +, Mevlana ose Bilaterale) dhe të përfunduara me sukses sipas kriterëve të institucionit jashtë vendit, tregohen me emrat e tyre origjinalë dhe kreditet ECTS të UNYT në vlerësim, pas raportit të Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, miratimit të këshilluesit akademik dhe vendimit të Këshillit të Fakultetit.</p> <p>Për sa u përket studentëve të transferuar GVJ u informua se kërkesa e studentëve për transferimin e krediteve rishikohet nga një komision <i>ad hoc</i> në nivel departamenti të aprovuar nga Dekani. Vendimi i Komisionit <i>ad hoc</i> të Departamentit, i dërgohet për miratim Komisionit të Transferimit, të përbërë nga Zëvendës Rektorët dhe Dekanët e fakulteteve përkatëse, në bashkëpunim me Zyrën e Çështjeve Studentore dhe Zyrën e Regjistrimeve. Specifikë e institucionit është se për t'u diplomuar, studentet e transferuar duhet të fitojnë të paktën 50% të totalit të kredive në UNYT.</p> <p><i>1.14 UNYT Rules and Regulation;</i> <i>1.12 Rregullore e Fakultetit;</i> <i>1.11 Rregullore e Departamentit të Shkencave Kompjuterike;</i> <i>5.21 UNYT Dokument për transferim.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ u informua se një numër elementësh në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit janë të specifikuar në rregulloret e institucionit. Elementë më të detajuar për lëndët që bëjnë pjesë në programin e studimit, jepen nga pedagogët përkatës në seancën e parë, duke u bërë të njohur dhe vënë në dispozicion të studentëve të syllabusit të lëndës dhe duke detajuar tipologjinë e lëndës, rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, temat përkatëse, metodologjinë e të nxënit (leksione, seminare, konsultime, punë në grup, punë individuale etj), mënyrën e vlerësimit (provim ndërmjetës, provim përfundimtar dhe komponentë të tjerë), kriteret e vlerësimit si dhe literaturën përkatëse.</p> <p><i>1.11 Rregullore e Departamentit të Shkencave Kompjuterike;</i> <i>2.2 Syllabuset e Lëndëve CS;</i> <i>1.13 Rregullore e programit - MSc në Shkenca Kompjuterike ;</i> <i>Takime në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon</p>	<p>Rregulloret e institucionit (UNYT, Fakultet, Departament, Program Studimi) japin një informacion të qartë mbi</p>

<p>studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>procedurën e diplomimit. Për të filluar projektin/diplomën, një student duhet të ketë jo më shumë se tre lëndë të pavlerësuara. Nëse një student ka më shumë se 3 lëndë të pavlerësuara, ai/ajo duhet të paraqesë një kërkesë e cili do ta trajtojë këtë rast pas rasti. Nëse një student nuk e përfundon projektin/disertacionin në kohën e caktuar ose dështon në disertacion, studenti do të duhet të përsërisë projektin/disertacionin dhe ai/ajo do të ngarkohet me 50% të tarifës së shkollimit që i korrespondon kësaj faze. Elementë të detajuar në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit jepen në udhëzuesin përkatës (<i>Udhëzimet përfundimtare të projektit dhe disertacionit për studentët dhe udhëheqësit e disertacionit për MSc në Shkenca Kompjuterike</i>).</p> <p>1.13 Rregullore e programit - MSc ne Shkenca Kompjuterike ; 2.10 UNYT Student Handbook (2019-onwards) 2.7 UNYT Final Project and Dissertation Guideliness (2019-onwards)</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>GVJ u informua se UNYT, nëpërmjet Zyrës së Çështjeve Studentore organizon dhe merr pjesë në aktivitete me qëllim ofrimin studenteve të ardhshëm të informacionit të nevojshëm për programin e studimit. Veprimtari të tilla janë ato të organizuara në trajtën e takimeve informuese. Gjithashtu, kjo zyrë, merr pjesë në takime të organizuara me studentë dhe kandidatë të tjerë në panaire të ndryshme të organizuar nga dhoma e tregtisë duke ofruar informacion mbi programet e studimit të UNYT. Një rol të rëndësishëm në informimin e studentëve të ardhshëm luan dhe faqja zyrtare e internetit si dhe rrjetet sociale.</p> <p>https://unyt.edu.al/index.php/student-affairs-office/; 5.18 UNYT SAO Plani vjetor; 2.9.1 - Prezantim ne ditën e parë të studentit - Cohort 14 (2022); https://unyt.edu.al/</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>– Studentëve u vihet në dispozicion një informacion i gjerë në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit, elementët detyrues të tij si dhe kriteret e procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Burimet bazë të evidentuara të informimit janë rregulloret e institucionit, Zyra e Çështjeve Studentore; faqja e internetit, dhe kontaktet me pedagogët e lëndëve;</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - Në aktet e tij rregullatore UNYT ka të parashikuara dhe garanton procedurat për njohjen dhe ekuivalentimin e kualifikimeve; - Procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit janë të specifikuar në rregulloret e institucionit dhe syllabuset e lëndëve; - Elementë të detajuar në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit jepen në udhëzuesin përkatës; - Informimi i interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit realizohet nëpërmjet takimeve informuese, faqes zyrtare të internetit si dhe rrjeteve sociale; 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Gjatë takimit me studentët e programit të studimit, GVJ konstatoi se ata janë të mirë informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Informimi i tyre realizohet nëpërmjet Zyrës së Çështjeve Studentore (në forma të ndryshme komunikimi) dhe në prezantimin e realizuar në fillim të studimeve. Gjithashtu një informacion i detajuar dhe i aksesueshëm në mënyrë të vazhdueshme është dhe ai nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të UNYT. Rrugë të tjera të përfuturit të informacionit janë Sekretaria Mësimore dhe këshilluesi akademik.</p> <p>https://unyt.edu.al/index.php/master-programs/master-of-science-in-computer-science/ ;</p> <p>2.9.1 - Prezantim ne ditën e parë të studentit - Cohort 14 (2022);</p> <p>https://unyt.edu.al/index.php/course-schedule/</p> <p>https://unyt.edu.al/index.php/academic-calendar/;</p>

	https://www.facebook.com/unyt.edu.al/
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>GVJ u informua se institucioni shpërndan informacion nëpërmjet faqes së internetit, Zyrës së Çështjeve Studentore, Këshillucsit akademik si dhe nëpërmjet pedagogëve të lëndëve. Në faqen e internetit gjendet i publikuar edhe orari i programit të studimit, kurrikula si dhe kalendari akademik. Syllabuset, që çdo pedagog prezanton në fillim të lëndës, japin një informacion të detajuar e të qartë për përmbajtjen e lëndës, veprimtaritë formuese dhe kërkesat që studenti duhet të plotësojë për përparimin e tij akademik.</p> <p>https://unyt.edu.al/index.php/master-programs/master-of-science-in-computer-science/ ;</p> <p>https://unyt.edu.al/index.php/course-schedule/;</p> <p>https://unyt.edu.al/index.php/academic-calendar/;</p> <p>2.4 MSc ne CS Syllabi.</p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	<p>GVJ konstatoi se një rol të veçantë në drejtim të informimit të studentëve mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës luan Zyra e Karrierës e cila ka si mision zhvillimin personal të studentëve nëpërmjet leksioneve dhe trajnimeve rreth karrierës, nxjerrjen në pah të mundësitë të zhvillimit të karrierës, ndërthurjen e aftësive dhe vlerave, dhe lehtësimin e kalimit nga akademia në tregun e punës me anë të bashkëpunimeve/partneriteteve me organizata të ndryshme. Qëllimi i kësaj zyre është të ndihmojë studentët në përgatitjen dhe ndjekjen e karrierës së tyre për internshipe, punësim, evente dhe panairë karriere, trajnime dhe Workshop-e me synim zhvillimin personal dhe profesional të karrierës etj. Në këtë frymë, GVJ u informua se Zyra e Karrierës ka organizuar një sërë aktivitetesh nga të cilët më i rëndësishmi është Panairi i Punës (me pjesëmarrje të partnerëve të biznesit). Aktivitetet të tjera kanë të bëjnë me prezantime të kompanive të ndryshme me të cilat UNYT ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p><i>5.11 UNYT Rregullore Zyra e Karrierës;</i> <i>5.12 UNYT Aktivitete Zyra e Karrierës;</i> <i>5.16 UNYT Pani Vjetor - Zyra e Karrierës;</i> <i>5.14 UNYT Agjenda për Panairin e Karrierës;</i> <i>5.14.2 UNYT Lista e kompanive pjesemarrrese në Panairin e Karrierës</i></p>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion	GVJ u informua se kandidatëve për studentë informacioni për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën,

<p>informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij u vihet në dispozicion gjatë ditëve të hapura të organizuara në fillim të çdo viti akademik, ku çdo zyrë e UNYT në shërbim të studentit merr pjesë dhe studentet informohen se si këto zyra mund ti ndihmojnë gjatë studimeve të tyre. Në vijim studentë e regjistruar njihen me këta elementë më në detaj nga pedagogët përkatës gjatë njohjes me syllabusin e lëndëve dhe elementët mbështetës për zhvillimin e lëndëve. GVJ konstatoi se pjesë e informimit janë dhe takimet prezantuese të programit të studimit të organizuara me studentët para fillimit të studimeve në këtë program studimi ku jepen elementë për programin e studimit, pranimin në të, mundësitë që krijohen nga diplomimi në këtë program studimi, mënyrën e realizimit të programit dhe kohëzgjatjen e tij, personat e kontaktit në UNYT, një përshkrim të Departamentit të Shkencave Kompjuterike përgjegjës për këtë program studimi, objektivat e programit, strukturën e programit, punimin përfundimtar (disertacionin) dhe udhëzuesin përkatës, bibliotekën (përfshirë bibliotekat online), sistemin Turnitin të kontrollit të plagjiaturës, sistemin e informacionit të studentit, problemet administrative, sistemin e këshillimit të studentëve, kalendarin akademik, mënyrën e komunikimit me pedagogët si dhe një numër elementësh mbi sistemin e notave, kontrolli, rivlerësimin, apelimin, përgjegjësitë e studentit etj.</p> <p><i>5.17 UNYT Ditët e hapura dhe Vizitat e Studenteve; 2.9.1 - Prezantim në ditën e parë të studentit - Cohort 14 (2022).</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>GVJ u informua se studentët mund të aksesojnë të gjithë informacionin që dëshirojnë rreth programit të studimit, vlerësimit, detyrave, orarit etj. nëpërmjet faqes web të UNYT dhe nëpërmjet sistemit GNOMON. GVJ konstatoi se aksesimi në sistemin GNOMON mundësohet nëpërmjet faqes web, ku u propozohet hyrja dedikuar studentëve dhe stafit nëpërmjet adresës email dhe fjalëkalimit të personalizuar. Ky sistem është lehtësisht i arritshëm edhe në distancë.</p> <p>http://egnomon.unyt.edu.al/;</p> <p><i>4.20.1 UNYT E-Gnomon aksesimi i studenteve;</i></p> <p>https://unyt.edu.al/index.php/course-schedule/;</p> <p>https://unyt.edu.al/index.php/academic-calendar/</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>– <i>Studentët informohen në mënyrë të detajuar në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të</i></p>




	<p>tij nëpërmjet Zyrës së Çështjeve Studentore, Këshilluesit akademik si dhe nëpërmjet pedagogëve të lëndëve;</p> <ul style="list-style-type: none"> - GVJ konstatoi se një rol të veçantë në drejtim të informimit të studentëve mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës luan Zyra e Karrierës e cila ka organizuar një sërë aktivitete nga të cilët më i rëndësishmi është Panairi i Punës; - Studentët mund të aksesojnë të gjithë informacionin e nevojshëm rreth programit të studimit, vlerësimit, detyrave, orarit etj. nëpërmjet faqes web të UNYT dhe/ose nëpërmjet sistemit GNOMON; 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Sekretaria mësimore e UNYT është një nga strukturat më të rëndësishme për mbajtjen e statistikave për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. Të dhënat përpunohen prej saj dhe ruhen si në format fizik (regjistrat themeltar, regjistrat e lëshimit të diplomave) ashtu dhe në format elektronik. Gjithashtu të dhënat dhe statistikat mund të përpunohen edhe nga sistemi GNOMON. Duhet theksuar se për këtë program studimi nuk është diplomuar akoma brezi i parë i studentëve. GVJ zhvilloi edhe një vizitë në Sekretarinë Mësimore dhe konstatoi se plotësimi i regjistratit themeltar dhe regjistratit të lëshimit të diplomave janë në përputhje me standardet dhe udhëzimet e MAS.</p> <p><i>Vizitë në sekretarinë mësimore;</i> 2.13 MSc Cs Tabelat permbledhese per Aneks RVB</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në</p>	<p>GVJ u informua se të dhënat në format elektronik për studentët, që nga regjistrimi e deri në diplomimin e tyre, menaxhohen nga sistemi GNOMON. Në këtë sistem Sekretaria mësimore ka akses për të dhënat e studentëve dhe vlerësimet e tyre (ruajtjen dhe aksesimin e arritjeve</p>

<p>diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>akademike në formatin elektronik), të dhënat për personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie etj. Të dhënat në sistem përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke mundësuar edhe gjenerimin e të dhënave që shërbejnë për raportime të ndryshme.</p> <p>http://egnomon.unyt.edu.al/;</p> <p>4.20.2 UNYT Gnomon akses; Vizitë në sekretarinë mësimore</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ konstatoi se aksesimi në sistemin GNOMON mundësohet nëpërmjet faqes web, ku propozohet hyrja dedikuar nëpërmjet adresës email dhe fjalëkalimit të personalizuar. Në këtë sistem aksesimi është sipas një hierarkie të caktuar si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Studentët kanë akses në të dhënat e tyre akademike, notat, mungesat si dhe të dhënat financiare; - Staf i akademik ka akses për të parë rezultatet akademike të studentëve me qëllim që të ndjekë ecurinë e tyre dhe për të bërë këshillimin e duhur në lidhje me lëndët që studenti duhet të ndjekë në semestrin pasardhës; - Sekretaria mësimore ka akses për të dhënat e studentëve dhe vlerësimet e tyre (ruajtjen dhe aksesimin e arritjeve akademike në formatin elektronik), të dhënat për personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie etj. <p>Zyra e Financës ka akses në të dhënat e studentëve Për sa i përket elementëve që lidhen me të dhënat financiare. Veç sa më sipër në sistem kanë akses edhe Zyra e Çështjeve të Studentëve dhe Departamenti Front-Desk. Kjo mundëson një menaxhim të sigurt të sistemit.</p> <p>http://egnomon.unyt.edu.al/;</p> <p>4.20.2 UNYT Gnomon akses; Vizita në institucion</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.),</p>	<p>Veprimtaria e Sekretarisë mësimore të UNYT mbështetet në rregulloren përkatëse. Në këtë rregullore është përcaktuar se Sekretaria Mësimore ka varësi direkt nga Zv/Rektori dhe Dekani dhe kontrollohet me urdhër me shkrim nga një komision i caktuar nga Dekani në fund të çdo semestri, për saktësinë e të dhënave të marra e të përpunuara. Auditimi i njësive administrative kryhet nëpërmjet një komisioni <i>ad-hoc</i> i cili, i pjesë integrale e kontrollit të brendshëm dhe njësi e specializuar e saj, ka për mision kontrollin e proceduarve dhe</p>

<p>vlërëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>rregullave të vendosura në rregulloren e funksionimit të zyrave administrative.</p> <p><i>5.4 UNYT Rregullore e brendshme për veprimtarinë e sekretarisë mësimore;</i> <i>6.20 UNYT Vendim Rektorati për Auditin e Brendshem;</i> <i>6.8 UNYT Internal Audit Procedure</i></p>												
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Sekretaria mësimore e UNYT dhe Departamenti i Shkencave Kompjuterike disponojnë informacionin mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, ndërsa Zyra e Karrierës dhe Alumnit analizon gjendjen e punësimit të studentëve. Në përputhje me udhëzimet e MAS, të dhënat përpunohen në nivel institucional dhe një raport vjetor dorëzohet pranë MAS në fund të çdo viti akademik. Të dhënat për cilësinë në hyrje paraqiten si vijon:</p> <table border="1" data-bbox="603 857 1362 1205"> <thead> <tr> <th colspan="2">Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike"</th> </tr> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Nota mesatare në hyrje</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2022-2023</td> <td>7.74</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>7.94</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>7.77</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>7.22</td> </tr> </tbody> </table> <p>Vihet re se ka një kontigjent relativisht cilësor që pranohet në këtë program studimi. E rëndësishme është të theksohet se gjithë të diplomuarit e këtij programi studimi janë të punësuar dhe punësimi i tyre është në përputhje me diplomën.</p> <p><i>5.4 UNYT Rregullore e brendshme për veprimtarinë e sekretarisë mësimore;</i> <i>5.11 UNYT Rregullore Zyra e Karrierës;</i> <i>5.20 Statistika mbi punësimin e Studenteve</i></p>	Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike"		Viti akademik	Nota mesatare në hyrje	2022-2023	7.74	2021-2022	7.94	2020-2021	7.77	2019-2020	7.22
Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike"													
Viti akademik	Nota mesatare në hyrje												
2022-2023	7.74												
2021-2022	7.94												
2020-2021	7.77												
2019-2020	7.22												
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Sekretaria mësimore e UNYT është një nga strukturat më të rëndësishme për mbajtjen e statistikave në lidhje me studentin. Të dhënat përpunohen dhe ruhen si në format fizik (regjistrat themeltar, regjistrat e lëshimit të diplomave) ashtu dhe në format elektronik nëpërmjet sistemit GNOMON; – Të dhënat në sistem përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke mundësuar edhe gjenerimin e të dhënave që shërbejnë për raportime të ndryshme; 												

	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Akresi në sistemin GNOMON mundësohet nëpërmjet faqes web, ku propozohet hyrja dedikuar nëpërmjet adresës email dhe fjalëkalimit të personalizuar duke garantuar një menaxhim të sigurt të sistemit;</i> - <i>Veprimtaria e Sekretarisë mësimore dhe njërive të tjera administrative kontrollohet në mënyrë periodike nga strukturat e ngarkuara nga institucioni;</i> - <i>Gjithë të diplomuarit e këtij programi studimi janë të punësuar dhe punësimi i tyre është në përputhje me diplomën.</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Neni 71 i Statutit të UNYT, përcakton funksionimin në institucion të Këshillit të Studentëve si organ që merret me zhvillimin e veprimtarive dhe aktiviteteve që asiston studentët të krijojnë klube dhe shoqëri, dhe u jep atyre mundësinë të anëtarësohen përmes angazhimeve vullnetare. Ky Këshill promovon gjithashtu dhe pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të Universitetit duke bërë që studentët të kenë zërin e tyre në formulimin e politikave të institucionit. Veç kësaj në anëtarët e Senatit Akademik përfshihet dhe një përfaqësues i studentëve i zgjedhur nga Këshilli i Studentëve, duke mundësuar në këtë mënyrë transmetimin e zërit të tyre në këtë organ drejtues si dhe pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje. Gjithashtu GVJ u informua se studentët përfaqësohen edhe në Këshillin e Etikës me një anëtar, Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, etj. Gjithashtu një student ka qenë pjesë e grupit të hartimit të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm dhe GVJ u njoh me angazhimin e tij në këtë proces vlerësimi. Nga takimi me studentët GVJ u informua për organizimin e Këshillit të Studentëve dhe për

17.

	<p>funksionimin e disa klubeve studentore të cilët organizojnë aktivitete.</p> <p><i>1.1 UNYT Statuti 2020 (Nenet 30, 71);</i> https://unyt.edu.al/index.php/student-union/; <i>Takime në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>UNYT garanton përfshirjen e studentëve në menaxhim dhe në vendimmarrje duke mundësuar përfaqësimin e tyre në Senat, Këshillin e Etikës, Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe në grupin e vlerësimit të brendshëm e përgatitjen e RVB. Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me kontributin e studentit pjesë e GVB në përgatitjen e RVB për elementët që kishin të bënin me studentët dhe mbështetjen e tyre. Gjithashtu, studentët marrin pjesë dhe në vlerësimin e procesit akademik dhe aspekteve të tjera nëpërmjet pyetësorëve të zhvilluar çdo semestër.</p> <p><i>1.1 UNYT Statuti 2020 (Nenet 30, 71);</i> <i>6.3 UNYT Rregullore për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë;</i> <i>RVB;</i> <i>Takime në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Tërheqja e mendimit të studentëve për programin e studimit realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në organet vendimmarrëse të UNYT. Gjithashtu, nëpërmjet pyetësorëve të vlerësimit të elementëve lëndës nga studentët tërhiqet, ndërmjet të tjerash, mendimi për elementë që kanë të bëjnë me përmirësimin e programit të studimit. GVJ u informua se problematikat e ngritura nga përpunimi i rezultateve të pyetësorëve janë pasqyruar në raporte të niveleve të ndryshme duke dhënë edhe elementë apo lënë detyra për përmirësim në lidhje me problematikat e hasura.</p> <p><i>6.9 UNYT Formular Vleresimi nga Studentet ;</i> <i>6.9.1 Student Evaluation Report;</i> <i>6.6 UNYT Formular për Raportin Vjetor të Monitorimit;</i> <i>6.2.1 UNYT Raporti Vjetor NjSBC 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit,</p>	<p>Procesi i vlerësimit dhe kontrollit të dijeve bazohet në aktet rregullatore të institucionit të cilat përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për të pasqyruar ndryshimet në aktet ligjore dhe nënligjore. Këto procedura synojnë të garantohet barazia dhe ndershmëria e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Studentëve u njihet e drejta e apelimit të rezultateve të provimit. Nëse studenti nuk është i kënaqur me vlerësimin përfundimtar, atëherë studenti ka të drejtë të paraqesë me</p>

<p>rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>shkrim kundërshtimin e rezultatit të provimit dhe ndiqet proceduar nga Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Përgjegjësi i Departamentit eventualisht duke i kërkohet instruktorit të lëndës përkatëse të rivlerësojë provimin. Nëse studenti nuk është i kënaqur me rezultatin e rivlerësimit të provimit, ka të drejtë të kërkojë një komision <i>ad-hoc</i> për një rivlerësim tjetër. Vendimi i këtij komisioni është definitiv. Në rregullore përcaktohen edhe afatet kohore për këtë proces. Nga takimi me studentët GVJ nuk konstatoi ndonjë problematikë në këtë drejtim.</p> <p><i>1.11 Rregullore e Departamentit të Shkencave Kompjuterike;</i></p> <p>https://unyt.edu.al/index.php/student-academic-petition/;</p> <p><i>Takim me studentët</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - UNYT garanton përfshirjen e studentëve në menaxhim dhe në vendimmarrje duke mundësuar përfaqësimin e tyre në Senat, Këshillin e Etikës, Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe në grupin e vlerësimit të brendshëm e përgatitjen e RVB; - Studentët e UNYT janë të organizuar në Këshillin e Studentëve, duke mundësuar shprehjen e mendimeve dhe paraqitjen e propozimeve për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të universitetit; - Tërheqja e mendimit të studentëve për programin e studimit realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në organet vendimmarrëse të UNYT si dhe nëpërmjet përpunimit të pyetësorëve të vlerësimit të lëndës dhe pedagogut nga studentët; - Problematikat e ngritura nga përpunimi i rezultateve të pyetësorëve janë pasqyruar në raporte të niveleve të ndryshme duke dhënë edhe elementë apo lënë detyra për përmirësim në lidhje me problematikat e hasura; - Procedurat që lidhen me vlerësimin dhe kontrollin e dijeve bazohen në aktet rregullatore të institucionit dhe synojnë të garantohet barazia dhe ndershmëria e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, duke garantuar dhe të drejtën e ankimit. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p>Në UNYT në shërbim të informimit dhe shërbimit të studentëve funksionon Zyrës së Çështjeve Studentore e cila shërben si një udhëzues për Studentin gjatë gjithë udhëtimit të tij akademik duke ofruar shërbime që synojnë të përmirësojnë përvojën e studentëve në jetën në kampus, të mbështesin krijimtarinë dhe ambiciet e tyre, si dhe të ofrojnë zgjidhje për problemet e ndryshme me të cilat mund të përballen studentët. Kjo zyrë funksionon sipas një rregulloreje të veçantë. Nga takimet në këtë zyrë GVJ arriti në konkluzionin se ajo përbën një hallkë të rëndësishme në mbështetjen e studentëve.</p> <p>Në shërbim të informimit dhe shërbimit ndaj studentëve është dhe Sekretaria mësimore e UNYT si dhe Këshilluesi akademik.</p> <p><i>5.8 UNYT SAO Rregullore e Brendshme Takime në institucion</i></p>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<p>GVJ u informua se Zyra e Çështjeve Studentore në UNYT luan një rol të rëndësishëm në informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Gjatë takimit në institucion, dhe në veçanti me studentët, nga ana e GVJ, u vu re se kjo njësi përbën pikën kryesore të kontaktit të studentëve për gjithë problematikat që lidhen me jetën e tyre universitare. Në rregulloren e kësaj zyre përcaktohen detyrat e kësaj zyre si Rekrutimi i Pranimeve, Ndihma financiare, Orientimi dhe Përvoja e Vitit të Parë, Shërbime multikulturore, Studimi i tregut, Shërbimet e Çertifikimit së gjuhës Angleze, Aktivitetet Studentore, Shërbimet e Rekrutimit Dixhital dhe Këshillimi i Studentëve. Për të lehtësuar komunikimin përdoret plotësisht online i Formularit të Peticionit Akademik Studentor.</p> <p><i>5.8 UNYT SAO Rregullore e Brendshme</i></p>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin	<p>Shërbimi i këshillimit të karrierës në UNYT mbulohet nga Zyra e Karrierës. Kjo zyrë ka si qëllim të mbështesë integrimin e studentëve të UNYT në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës duke i ndihmuar ata në përgatitjen dhe</p>

<p>e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>ndjekjen e Karrierës së tyre për internshipe, punë, evente dhe panairë karriere, trajnime dhe Workshop-e me synim zhvillimin personal dhe profesional të karrierës. GVJ u informua për një numër aktivitete të kësaj zyre në shërbim të fitimit të kompetenca ve për t'u orientuar në tregun e punës. Kjo zyrë punon në bazë të një plani vjetor. GVJ është i mendimit se kjo zyrë, mbështetur në marrëveshjet e bashkëpunimit që ka nënshkruar institucioni, kontribuon fuqishëm në krijimin e mundësive të zhvillimit të praktikës profesionale në kompani prestigjioze dhe në orientimin në tregun e punës. Nga takimi në këtë zyrë GVJ u informua se kontributi i saj ka qenë i rëndësishëm duke qenë se të gjithë studentët e këtij programi janë të punësuar.</p> <p><i>5.11 UNYT Rregullore Zyra e Karrierës;</i> <i>5.16 UNYT Pani Vjetor - Zyra e Karrierës;</i> <i>5.12 UNYT Aktivitete Zyra e Karrierës;</i> <i>5.14.3 UNYT Keynote Speaker Panairi i Karrierës</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Një nga detyrat e Zyrës së Karrierës është dhe ndjekja e studentëve pas diplomimit. Për këtë është konceptuar dhe është funksionale një databazë e të gjithë studentëve të cikleve të studimit të diplomuar, përfshirë pozicionin e tyre të punës apo nëse ata janë akoma në kërkim të punës. Këto të dhëna shërbejnë për të identifikuar nivelin e punësimit të të diplomuarve në nivel programi. Këto të dhëna pasqyrohen në fund të çdo viti akademik në Dokumentin e Performancës. GVJ konstatoi se për sa u përket të dhënave të punësimit, studentët e këtij programi studimi janë të gjithë të punësuar dhe punësimi i tyre është në përputhje me diplomën. Gjithashtu duhet theksuar se programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" për vetë natyrën e tij si dhe për nivelin e përgatitjes (përfshirë zhvillimin e tij në gjuhën angleze), lehtëson shumë integrimin e studentëve në tregun e punës (edhe pa përfunduar plotësisht studimet).</p> <p><i>5.20 Statistika mbi punësimin e Studenteve</i> <i>5.32 UNYT Dokumenti i Performancës</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Në UNYT në shërbim të informimit dhe shërbimit të studentëve funksionon Zyrës së Çështjeve Studentore, Sekretaria Mësimore dhe Këshilluesi akademik, struktura të cilat janë shumë aktive dhe janë ndërtuar e funksionojnë në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit; - Zyra e Çështjeve Studentore në UNYT luan një rol të rëndësishëm në informimin, këshillimin, ndjekjen e

	<p><i>përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> – <i>Shërbimi i këshillimit të karrierës mbulohet nga Zyra e Karrierës, e cila ka si qëllim të mbështesë integrimin e studentëve të UNYT në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës;</i> – <i>Për ndjekjen e studentëve pas diplomimit është konceptuar dhe është funksionale një databazë e të gjithë studentëve të cikleve të studimit të diplomuar, përfshirë pozicionin e tyre të punës apo nëse ata janë akoma në kërkim të punës;</i> – <i>Studentët e këtij programi studimi janë të gjithë të punësuar dhe punësimi i tyre është në përputhje me diplomën.</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	GVJ konstatoi se programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" zhvillohet në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe kërkesave specifike shprehur në aktet rregullatore të UNYT dhe në objektivat strategjike të tij, në veçanti për këtë program studimi. Strategjia e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të vlerësimit ka në fokusin e saj përkushtimin ndaj metodologjive të reja të mësimdhënies dhe risive me ndikim mësimor dhe kërkimor. Nga takimet me pedagogë të angazhuar në realizimin e programit të studimit GVJ u

	<p>informua se personeli akademik, mbështetur dhe nga një infrastrukturë dhe mjete didaktike të kohës, ka në fokusin e tij përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Kontribut të veçantë në këtë drejtim kanë dhe shkëmbimet me institucione partnere jashtë vendit, në mënyrë të veçantë mobilitetet e personelit akademik në këto institucione. Nga ana tjetër, mësimdhënia në gjuhën angleze lehtëson shkëmbimet dhe angazhimin edhe të personelit akademik të huaj. GVJ u informua se në nivel Departamenti i kushtohet rëndësi e veçantë trajnimit personelit akademik të angazhuar për herë të parë në mësimdhënie duke u përcjellë praktikat më të mira dhe eksperiencat e personelit akademik me eksperiencë. Si bazë për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies shërbejnë "Strategjia e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të vlerësimit" dhe "Strategjia e zhvillimit të programit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike 2019-2024" dhe "Manuali i Sigurimit të Cilësisë".</p> <p><i>1.2 Strategic Plan;</i> <i>6.18 UNYT Strategjia e mesimdhënies, mesimnxënies dhe metodave të Vlerësimit;</i> <i>1.3 Strategjia e Zhvillimit të Programit;</i> <i>Takime në institucion;</i> <i>6.1 UNYT Manual i Sigurimit të Cilësisë.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Nga analiza e DVV dhe takimet në institucion GVJ u informua se monitorimi i cilësisë së mësimdhënies realizohet në dy nivele:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Në nivel Departamenti ku krahas ndjekjes së politikave të vlerësimit periodik të stafit akademik dhe ndihmës-akademik për monitorimin dhe përmirësimin e aftësive në procesin e mësimdhënies, aplikohen edhe mekanizma të tjerë monitorues si vlerësimi i kolegëve nga kolegët apo dhe vetëvlerësimi (në raport me objektivat e vendosura në fillim të vitit akademik); – Në nivelin e NjSBC, e cila realizon (2 herë në vit) pyetësorë për studentët të cilët vlerësojnë pedagogun dhe lëndën të cilën po ndjekin. Për personelin akademik që jep mësim për herë të parë, vlerësimi nga studentët aplikohet dy herë në semestër. <p><i>6.1 UNYT Manual i Sigurimit të Cilësisë;</i> <i>6.2.1 UNYT Raporti Vjetor NjSBC 2021-2022;</i> <i>6.9 UNYT Formular Vlerësimi nga Studentet;</i></p>

	<i>6.4 UNYT UNYT Formular Vleresimi nga Koleget</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	<p>Vlerësimi i formave dhe metodave të mësimdhënies mundësohet nëpërmjet përfshirjes së studentëve në plotësimin e pyetorit të vlerësimit të lektorëve të lëndëve të programit të studimit, i cili plotësohet në fund të çdo semestri. Ky pyetor është anonim dhe gjithë procesi drejtohet dhe monitorohet nga NjSBC. Garantimi i ankimimit të rezultatit të provimit bazohet në procedurën e përcaktuar në rregullore dhe ndiqet nga Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Departamenti. Nga takimi me studentët GVJ konstatoi një angazhim të vazhdueshëm të institucionit në këtë drejtim.</p> <p><i>1.11 Rregullore e Departamentit të Shkencave Kompjuterike; 6.9 UNYT Formular Vleresimi nga Studentet; https://unyt.edu.al/index.php/student-academic-petition/; 6.1 UNYT Manual i Sigurimit të Cilësisë; Takim me studentët</i></p>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe takimet në institucion GVJ u informua se Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit si dhe NjSBC, bën të mundur publikimin e raporteve përfundimtare të akreditimit të programeve të studimit në faqen zyrtare të UNYT. Gjithashtu anëtarët e personelit akademik informohen individualisht në lidhje me rezultatet respektive të përftuara nga pyetsorët e studentëve.</p> <p><i>6.9.3 E-mail Student Evaluation to each Professor; 6.9.1 Student Evaluation Report; 6.9.2 E-mail Student Evaluation to Rectorate, Dean, Head of Dep.; Takime në institucion</i></p>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<p>GVJ konstatoi se një rol të madh në promovimin e shembujve të praktikave të mira, nxitjen dhe inkurajimin e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies luan NjSBC dhe Departamenti i Shkencave Kompjuterike. Rezultatet përfundimtare të vlerësimeve janë objekt i diskutimeve në Departament. Veç kësaj, stafi akademik i Departamentit ballafaqon objektivat e përcaktuara në fillim të vitit me përmbushjen tyre. Raporti i vlerësimit të performancës individuale me komentet dhe sugjerimet që i përcillen Rektoratit, shërbejnë si indikatorë për promovimin e stafit akademik.</p> <p><i>4.29 UNYT Vendim Senati No 67 2020 Promovim Staf; 1.11 Rregullore e Departamentit të Shkencave Kompjuterike; 6.10 UNYT Individual Performance Assessment Form;</i></p>


	https://unyt.edu.al/wp-content/uploads/2023/06/Quality-Assurance-Annual-Report.pdf			
Konkluzione	<ul style="list-style-type: none"> - Programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" zhvillohet në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe kërkesave specifike shprehur në aktet rregullatore të UNYT dhe në objektivat strategjike të tij; - Personeli akademik, mbështetur dhe nga një infrastrukturë dhe mjete didaktike të kohës, ka në fokusin e tij përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies; - Vlerësimi i formave dhe metodave të mësimdhënies mundësohet nëpërmjet përfshirjes së studentëve në plotësimin e pyetsorit të vlerësimit të lektorëve të lëndëve të programit të studimit; - Në nivel institucioni puna për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik drejtohet nga NjSBC; - Promovimi i stafit akademik bazohet në raportin e vlerësimit të performancës individuale të stafit. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Në UNYT në strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Senati Akademik; - Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë; - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC); - Departamenti; <p>Në vlerësimin e cilësisë këto struktura, në mënyrë të veçantë NjSBC, bazohen në Manualin e Sigurimit të Cilësisë, i cili përshkruan parimet dhe procedurat e sigurimit të cilësisë për miratimin dhe vlerësimin e kurseve, programeve, njësive dhe</p>

	<p>partneriteteve në UNYT. NJSBC harton në mënyrë periodike raportet e vlerësimeve. GVJ vëren se këto struktura janë ndërtuar dhe funksionojnë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p> <p><i>1.1 UNYT Statuti 2020;</i> <i>1.11 Rregullore e Departamentit të Shkencave Kompjuterike;</i> <i>6.7 Rregullore për Njesine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</i> <i>6.3 UNYT Rregullore për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë;</i> <i>6.1 UNYT Manual i Sigurimit të Cilësisë</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>NjsBC e ngritur në nivel institucional me vendim të Senatit Akademik përbëhet nga tre anëtarë, ku një prej të cilëve është ekspert i jashtëm dhe dy anëtarë i përkasin stafit administrativ. Kjo njësi ka si mision të planifikojë, të drejtojë, të organizojë dhe të publikojë veprimtarinë e kryer në kuadrin e sigurimit të cilësisë në nivel institucioni dhe programesh studimi. Këtë e realizon nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Monitorimit e zbatimit të planit strategjik të Universitetit; - Monitorimit dhe sigurimin e proceseve të performancës në të gjitha aspektet e funksioneve të Universitetit; - Evidentimin e pikave të dobëta dhe njohin pikave të forta të mësimdhënies; - Vlerësimin periodik të sistemit të sigurimit të cilësisë; - Koordinimin e vlerësimit të stafit dhe programeve nga studentët; - Nxitjen e vetëvlerësimit të stafit akademik; - Koordinimin e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të programeve dhe institucionit në tërësi. <p>Gjithashtu në UNYT operon dhe Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, fusha e veprimtarisë së të cilit lidhet me sigurimin dhe vlerësimin e brendshëm të cilësisë dhe garantimin e standardeve të cilësisë së programeve të studimit, efikasitetin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore të institucionit; efikasitetin e shërbimeve ndihmës-akademike si dhe përfshirjen e studentëve në procesin e vlerësimit të brendshëm. Në këtë komision, një anëtar është përfaqësues i studentëve. GVJ konstatoi se këto struktura janë ndërtuar dhe funksionojnë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale dhe, duke qenë</p>




	<p>aktive e të koordinuara, kontribuojnë në rritjen e vëmendjes ndaj cilësisë në realizimin e programit të studimit.</p> <p><i>6.7 Rregullore per Njesine e Sigurimit te Brendshem te Cilesise;</i> <i>6.3 UNYT Rregullore per Komisionin e Perhershëm te Sigurimit dhe Standardeve te Cilesise;</i> <i>6.2.1 UNYT Raporti Vjetor NjSBC 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>UNYT i nënshtrohet akreditimit të jashtëm periodik. Me vendim të Bordit të Akreditimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, përmes Vendimit nr. 61 datë 18.12.2020, UNYT i është dhënë një vlerësim pozitiv për cilësinë akademike me një kohëzgjatje prej 6 vitesh (deri 17.12.2026). Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” është hapur me VKM nr. 939, datë 03.09.2009. Akreditimi i parë është kryer për një periudhë 6 vjeçare nga MASH me Urdhër Nr.170, datë 20.04.2012, bazuar në VKA Nr. 323, datë 16.03.2012. Akreditimi i dytë, është kryer me Vendim të BA nr.87, datë 07.12.2018 për një periudhë 5 vjeçare (deri 30.09.2023). Në këtë mënyrë kemi të bëjmë me vlerësimin e jashtëm nga ASCAL të këtij programi studimi për herë të tretë me qëllim riakreditimin e tij.</p> <p>Gjithashtu, GVJ u informua që UNYT, si pjesë e Fondacioni Turk MAARIF, është në proces akreditimi me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në arsimin e lartë në Turqi “YOKAK”, ku ndërkohë ekspertët e YOKAK kanë zhvilluar sesione trajnimi për stafin akademik dhe administrativ për të bërë të mundur njohjen e procedurave të procesit të Akreditimit në Republikën e Turqisë. GVJ është i mendimit që akreditimi i dyfishtë do t'i shërbejë ballafaqimit të elementëve që lidhen me cilësinë e programeve të studimit duke sugjeruar përmirësime eventuale.</p> <p>http://ams.ascal.al/ams/components/dokumentat/arkivaview.php?id=48 https://www.ascal.al/sq/bordi-i-akreditimit/vendimet/vendimet-e-mbledhjes-7-dhjetor-2018 <i>Takime në institucion;</i> <i>RVB</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të</p>	<p>NjSBC në mënyrë periodike zhvillon pyetësorë me studentët dhe stafin akademik me qëllim vlerësimin e procesit të mësimdhënies:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimin të stafit akademik dhe të lëndës nga studentët;

<p>parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>– Vlerësimin të stafit akademik nga kolegët.</p> <p>GVJ u informua se raporti përfundimtar i cili pasqyron rezultatet e përpunuara të vlerësimin, i transmetohet Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC), Rektoratit, Dekanit të Fakultetit, Përgjegjësit e Departamentit si dhe rezultati i dërgohet individualisht secilit profesor në rrugë elektronike. KPSSC në bashkëpunim me NjSBC në bazë të raporteve jep rekomandime/sugjerime për përmirësimin e pikave të dobëta. GVJ konstatoi një prezencë të ndjeshme të rolit të NjSBC në të gjitha aktivitetet e UNYT si nxitëse dhe garantuese e standardeve të cilësisë mes gjithë aktorëve të tij.</p> <p>6.9 UNYT Formular Vlerësimi nga Studentet; 6.4 UNYT UNYT Formular Vlerësimi nga Kolegjet; 6.2 UNYT Raporti Vjetor NjSBC 2020-2021; 6.2.1 UNYT Raporti Vjetor NjSBC 2021-2022; 6.9.1 Student Evaluation Report; 6.9.2 E-mail Student Evaluation to Rectorate, Dean, Head of Dep.; 6.9.3 E-mail Student Evaluation to each Professor 6.6 UNYT Formular per Raportin Vjetor te Monitorimit. 6.10 UNYT Individual Performance Assessment Form</p>			
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Organizimi i Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë në UNYT garantohet nëpërmjet strukturave të ngritura në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale; – Në UNYT funksionon në nivel institucioni Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë dhe NjSBC; – NjSBC monitoron cilësinë e zhvillimit të procesit mësimor, mbikëqyr proceset e vlerësimin të brendshëm, raportimin në rastet e vlerësimin të jashtëm të cilësisë etj. – UNYT i nënshtrohet akreditimit të jashtëm periodik nga ASCAL dhe së fundmi dhe nga Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në arsimin e lartë në Turqi "YOKAK"; – GVJ konstatoi se NjSBC është pjesë aktive në të gjitha aktivitetet e UNYT duke qenë nxitëse dhe garantuese e respektimit të standardeve të cilësisë. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Kompjuterike është përgjegjës për realizimin e programit të studimeve Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike". Në këtë aspekt, Departamenti shqyrton veprimtarinë mësimore duke kryer analiza vjetore të realizimit të procesit mësimor, punës administrative dhe asaj kërkimore shkencore në të cilat shqyrtohen problematikat e hasura dhe hapat konkrete në drejtim të përmirësimit. Në mënyrë të veçantë, në Raportet vjetore të Departamentit, u jepet përgjigje problematikave të ngritura nga Raporti i mëparshëm dhe propozohet Plani i Veprimit për vitin e ardhshëm. Raportet vjetore u transmetohen instancave përkatëse (Fakultet, Rektorat) bashkë me Raportin e vlerësimit të performancës individuale (shoqëruar me komentet dhe sugjerimet që shërbejnë si indikatorë për promovimin e stafit akademik). Në nivel institucioni përpilohen raporte të cilat i transmetohen MAS. GVJ konstaton se në këtë aspekt operohet në përputhje me udhëzimet dhe standardet e përcaktuara në aktet përkatëse ligjore e nënligjore.</p> <p><i>2.18 Annual Monitoring Report MSc CS 2021-2022</i> <i>6.10 UNYT Individual Performance Assessment Form;</i> <i>4. Raporti Vjetor 2021- 2022 MAS (dok.shitesë);</i> <i>Takime në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim</p>	<p>Raportet vjetore të Departamentit përmbajnë elementët në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none">- Përmbledhje e problematikave të hasura gjatë vitit;- Përgjigje të planit të veprimit të vitit të mëparshëm;- Vështrim kritik i programeve të studimit të ofruara nga Departamenti (duke paraqitur pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë dhe kërcënimet);- Raporte eventuale të vlerësuesve të jashtëm;- Mendimet dhe vlerësimet e studentëve;- Përmirësimi i kurrikulës;- Vlerësimi i performancës së stafit të Departamentit;- Planifikimi i vlerësimit të vitit të ardhshëm;- Plani i veprimit për vitin e ardhshëm.

nga personeli akademik dhe studentët.	<p>Nga analiza e Raporteve të Departamentit, pjesë e DVV, GVJ konstatoi se në to ka një analizë të thelluar të problematikave dhe adresim të tyre me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe promovimin e arritjeve më të mira.</p> <p><i>6.6 UNYT Formular per Raportin Vjetor te Monitorimit 2.18 Annual Monitoring Report MSc CS 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>UNYT përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit. Në këtë aspekt trajtohet përmirësimi i kurrikulës edhe në Raportin vjetor të Departamentit. GVJ konstatoi se elementët e pasqyruar në këtë pikë të Raportit inicohen nga rezultatet e përpunuara të pyetësorëve të vlerësimit nga studentët si dhe raporteve të vetëvlerësimit. Këta të fundit i mundësojnë stafit akademik të reflektojnë mbi strategjinë e tyre të mësimdhënies dhe të ndërmarrin hapa për përmirësim.</p> <p>Për sa i përket përmirësimit të kurrikulës, GVJ u informua se në stadin aktual, operohet me përmirësimin e syllabuseve të lëndëve për t'i përshtatur me zhvillimet bashkëkohore. Rishikimi i thellë i kurrikulës ndodhi në momenti e kalimit nga sistemi me 60 kredite ECTS në sistemin 2 vjeçar me 120 kredite ECTS për t'u përshtatur me kërkesat përkatëse ligjore.</p> <p><i>6.9 UNYT Formular Vleresimi nga Studentet; 6.4 UNYT UNYT Formular Vleresimi nga Koleget; 6.6 UNYT Formular per Raportin Vjetor te Monitorimit; 2.18 Annual Monitoring Report MSc CS 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në</p>	<p>Studentëve u mundësohet të jenë pjesëmarrës aktivë në vlerësimin e cilësisë së programit të studimit edhe duke ofruar mendimet e tyre nëpërmjet përfshirjes në procesin e vlerësimit të programit të studimit (pjesë e GVB), Këshillit Studentor, përfaqësuesit të tyre në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, pjesëmarrjes në Senatin Akademik dhe pjesëmarrjes në Këshillin e Etikës.</p> <p>Veç kësaj, raportet e vetëvlerësimit të personelit akademik si dhe analizat vjetore të Departamentit japin një kontribut të vlefshëm për mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Nga studimi i DVV dhe takimet në institucion, GVJ konstatoi se zgjerimi i diapazonit të kontribuesve në vlerësimin e programit të studimit dhe të përputhshmërisë së tij me tregun e punës bëhet nëpërmjet angazhimit në këtë proces të Alumni-t dhe të përfaqësuesve të tregut të punës. Zyra e Karrierës</p>

<p>realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>mban kontakte të vazhdueshme me Alumni-t e UNYT si dhe i angazhon vazhdimisht në evente të ndryshme që organizohen, në mënyrë të veçantë në panairin e punës që organizohet rregullisht.</p> <p>2.18 Annual Monitoring Report MSc CS 2021-2022; 6.10 UNYT Individual Performance Assessment Form; 6.9 UNYT Formular Vleresimi nga Studentet ; 5.14 UNYT Agjenda per Panairin e Karrieres; 5.14.2 UNYT Lista e kompanive pjesemarrrese ne Panairin e Karrieres; RVB</p>		
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Konstatohet se ndiqen dhe zbatohen të gjithë udhëzimet dhe standartet e përcaktuara në aktet përkatëse ligjore e nënligjore për mbikëqyrjen periodike të programit të studimit; - Raportet e analizës në Departament përmbajnë një trajtim të thelluar të problematikave dhe adresim të tyre me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe promovimin e arritjeve më të mira; - Në stadin aktual, operohet me përmirësimin e syllabuseve të lëndëve për t'i përshtatur me zhvillimet bashkëkohore; - Studentëve u mundësohet të jenë pjesëmarrës aktivë në vlerësimin e cilësisë së programit të studimit duke ofruar mendimet e tyre si nëpërmjet përfaqësimit të tyre në instanca të ndryshme ashtu edhe nëpërmjet pyetësorëve të ndryshëm; - Kontribues i rëndësishëm në vlerësimin e programit të studimit dhe të përputhshmërisë së tij me tregun e punës është dhe Alumni si dhe përfaqësuesit e tregut të punës. 		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe</p>	<p>NjSBC është struktura në UNYT e cila është përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Kjo strukturë kryen misionin e saj në bashkëpunim me Komisionin e Përhershëm</p>

<p>procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë i cili kontribuon në mbikëqyrjen dhe zhvillimin e rregulloreve, politikave, programeve, proceseve akademike dhe jo akademike dhe siguron përputhjen me kuadrin ligjor. Operimi i këtyre strukturave mbështetet në Manualin e Sigurimit të Cilësisë në të cilin janë detajuar procedurat që duhen ndjekur dhe standardet që duhen plotësuar gjatë procesit të vlerësimit të cilësisë. Në këtë proces përfshihen aktorë të brendshëm dhe të jashtëm. GVJ u informua për përfshirjen në këtë proces të studentëve, stafit akademik, por edhe të një eksperti të jashtëm. Në kuadër të çertifikimit të cilësisë UNYT ka aplikuar edhe për akreditimin nëpërmjet Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë në Turqi “YOKAK”, ku ndërkohë ekspertët e YOKAK kanë zhvilluar sesione trajnimit për stafin akademik dhe administrativ për të bërë të mundur njohjen e procedurave të procesit të Akreditimit në Republikën e Turqisë. Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit GVJ konstatoi se me rëndësi konsiderohet edhe informacioni dhe eksperiencat e përftuara në kuadër të mobiliteteve në universitete jashtë vendit dhe të leksioneve të zhvilluara nga pedagogë të huaj.</p> <p><i>1.1 UNYT Statuti 2020;</i> <i>6.1 UNYT Manual i Sigurimit të Cilësisë;</i> <i>5.2 UNYT Erasmus and Mevlana Mobility Quota;</i> <i>5.2.1 UNYT Lista e MoU, Mevlana and Erasmus+Inter-Institutional Agreements;</i> <i>Takime në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Rregullorja për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë dhe Rregullorja për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përcaktojnë mënyrën e funksionimit të sistemit të sigurimit të cilësisë si dhe përcaktojnë përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Referuar DVV, konfirmuar dhe nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se NjSBC harton çdo fillim viti një plan veprimi i cili bazohet në rregulloren e brendshme të njësisë ku parashtrohen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë vjetore si monitorimi i zbatimit të planit strategjik të UNYT, monitorimi dhe siguri i proceseve të performancës në të gjitha aspektet e funksioneve të UNYT, evidentimi i pikave të dobëta dhe njohja e pikave të forta të mësimdhënies, vlerësimi periodik të sistemit të sigurimit të cilësisë, koordinimin i vlerësimit të stafit dhe programit nga studentët, nxitja e vetëvlerësimit të</p>

	<p>stafit akademik, koordinimi i vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm i programeve dhe institucionit në tërësi. GVJ është i mendimit se sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë në UNYT është funksional dhe në shërbim të përmirësimit të cilësisë së formimit në programin e studimit.</p> <p><i>6.3 UNYT Rregullore për Komisionin e Përherëshëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë;</i> <i>6.7 Rregullore për Njesinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</i> <i>6.1 UNYT Manual i Sigurimit të Cilësisë;</i> <i>6.16 UNYT Plan Vjetor NjSBC;</i> <i>6.2.1 UNYT Raporti Vjetor NjSBC 2021-2022.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Vlerësimi dhe siguri i cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" garantohet përmes një procesi gjithëpërfshirës. GVJ konstatoi një angazhim të gjithë strukturave përgjegjëse për garantimin e cilësisë në UNYT. Përveç strukturave drejtuese ky angazhim përfshin dhe studentët dhe stafin akademik. Në këtë drejtim një rol të rëndësishëm luajnë dhe pyetsorët e studentëve si dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të studentëve në instanca të ndryshme të UNYT. Efektiv ka qenë dhe angazhimi i studentit në përgatitjen e RVB dhe plotësimin e DVV, duke shërbyer edhe si urë lidhëse me studentët e programit.</p> <p><i>6.3 UNYT Rregullore për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë;</i> <i>6.7 Rregullore për Njesinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</i> <i>6.1 UNYT Manual i Sigurimit të Cilësisë;</i> <i>6.16 UNYT Plan Vjetor NjSBC;</i> <i>RVB;</i> <i>Takime në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Plotësimi i pyetsorëve nga ana e studentëve bëhet duke ruajtur anonimitetin. Gjithashtu anëtarët e personelit akademik informohen individualisht në lidhje me rezultatet respektive të përfuara nga pyetsorët e studentëve. Në punën e saj NjSBC zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie. Për këtë njësia bazohet dhe i referohet Kodit të Etikës të UNYT. GVJ nuk gjeti praktika të prekjes së integritetit apo ankimit në lidhje me procesin në përgjithësi si dhe anketimet e kryera në veçanti.</p> <p><i>6.7 Rregullore për Njesinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</i> <i>6.1 UNYT Manual i Sigurimit të Cilësisë;</i></p>

<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>4.7 UNYT Kodi i Etikes</p> <p>Nga shqyrtimi i DVV, rezulton që në aspektin e aktivizimit si pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë të aktorëve të jashtëm, kryhet "Panairi i Punës" i organizuar nga UNYT ku marrin pjesë partnerë të biznesit. Në panairin e zhvilluar në vitin 2022 morën pjesë rreth 38 kompani të rëndësishme. Gjithashtu mobilitetet Erasmus+ kanë ndihmuar në procesin e përmirësimit të cilësisë së programit të studimit. Gjithashtu, organizohen edhe leksione të hapura me të ftuar nga jashtë institucionit.</p> <p>5.14 UNYT Agjenda për Panairin e Karrierës; 5.14 UNYT e-Career Fair 2020 5.14.2 UNYT Lista e kompanive pjesëmarrëse në Panairin e Karrierës; 5.2 UNYT Erasmus and Mevlana Mobility Quota; https://unyt.edu.al/index.php/2023/04/24/infosoft-group-visits-unitytec/</p>			
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - NjSBC është struktura në UNYT e cila është përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë e cila kryen misionin e saj në bashkëpunim me Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë; - Me rëndësi në procesin e sigurimit dhe përmirësimit të vazhduar të cilësisë së programit të studimit konsiderohet edhe informacioni dhe eksperiencat e përfuara në kuadër të mobiliteteve në universitete jashtë vendit; - NjSBC harton çdo fillim viti një plan veprimi i cili bazohet në rregulloren e brendshme të njësisë ku parashtrihen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë vjetore; - GVJ është i mendimit se sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë në UNYT është funksional dhe në shërbim të përmirësimit të cilësisë së formimit në programin e studimit; - NjSBC zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie; - Aktivizimi i aktorëve të jashtëm në procesin e vlerësimit të cilësisë realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në panairë, ftesave për të realizuar leksione të hapura etj. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>GVJ konstatoi se transparenca e veprimtarive në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit sigurohet nëpërmjet publikimit në faqen web të institucionit elementë që kanë të bëjnë me këtë proces (Statut, Rregullore e UNYT, Kod i Etikës, Manual i Sigurimit të Cilësisë, Rregullore për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, etj) si dhe raporte të vlerësimit të jashtëm, vendime të Bordit të Akreditimit etj. Raporte që kanë të bëjnë me veprimtari të tjera janë të disponueshme nëpërmjet NjSBC.</p> <p>https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#1686153429018-fe17a337-53fb ; https://unyt.edu.al/wp-content/uploads/2023/06/2020-External-Evaluation-Report -UNYT-02.12.2020.pdf ; https://unyt.edu.al/wp-content/uploads/2023/06/2020-Akreditimi-Institucional-i-UNYT VBA-nr.-61-date-18.12.2020.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjisllacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Anëtarët e personelit akademik informohen individualisht në lidhje me rezultatet respektive të përfuara nga pyetsorët e studentëve të cilat lidhen drejtëpërdrejt me performancën e tyre. Departamenti informohet për rezultatet e të gjithë stafit të angazhuar pranë tij. GVJ konstaton se informacionet e publikuara në faqen web të institucionit respektojnë lirinë akademike si edhe ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, ndryshuar me ligjin nr.48/2012 dhe ligjin nr.120/2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, duke garantuar ruajtjen e konfidencialitetit.</p> <p><i>Takime në institucion;</i> <i>6.9.3 E-mail Student Evaluation to each Professor;</i> <i>4.7 UNYT Kodi i Etikës</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Problematikat që rezultojnë nga vlerësimet e kryera bëhen objekt i trajtimit nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike në kuadër të analizës vjetore të realizimit të procesit mësimor, punës administrative dhe asaj kërkimore shkencore. Kjo konsiston në shqyrtimin e problematikave të hasura dhe propozimin e hapave konkretë në drejtim të përmirësimin. Në mënyrë të veçantë, në Raportet vjetore të Departamentit, u</p>

	<p>jepet përgjigje problematikave të ngritura nga Raporti i mëparshëm dhe propozohet Plani i Veprimit për vitin e ardhshëm. Raportet vjetore u transmetohen instancave përkatëse (Fakultet, Rektorat) bashkë me Raportin e vlerësimit të performancës individuale (shoqëruar me komentet dhe sugjerimet që shërbejnë si indikatorë për promovimin e stafit akademik). Në nivel institucioni përpilohen raporte të cilat i transmetohen MAS. Adresimi i problemeve të ngritura shpesh kërkon edhe mbështetje buxhetore, gjë e cila parashikohet në projekt buxhetin përkatës. GVJ konstaton se në këtë aspekt operohet në përputhje me udhëzimet dhe standardet e përcaktuara në aktet përkatëse ligjore e nënligjore.</p> <p><i>2.18 Annual Monitoring Report MSc CS 2021-2022</i> <i>6.6 UNYT Formular per Raportin Vjetor te Monitorimit;</i> <i>4. Raporti Vjetor 2021- 2022 MAS (dok.shtesë);</i> <i>4.31 UNYT Plan Buxhet;</i> <i>Takime në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton përpjekje nga ana e UNYT në lidhje me efektivitetin e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në programin e studimit. Angazhimi i të gjithë hallkave në këtë proces është shprehje e qartë e vëmendjes që ky institucion i jep këtij procesi. Përfshirja e rezultateve të vlerësimit në analizat si në nivel Departamenti ashtu edhe në nivel Fakulteti apo në nivel institucioni dëshmojnë për një proces me kontribut thelbësor në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>Takime në institucion;</i> <i>6.2 UNYT Raporti Vjetor NjSBC 2020-2021;</i> <i>6.2.1 UNYT Raporti Vjetor NjSBC 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga studimi i DVV dhe vizita në institucion, GVJ nuk pati mundësinë të njihet me shembuj të veprimtarive plotësisht të dedikuara informimit dhe ndërgjegjësimit të studentëve për problemet e cilësisë. Megjithatë, realizimi i anketimeve me studentët ndihmon në informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Nga ana tjetër, angazhimi i studentëve me përfaqësues të tyre në Senat, Këshillin e Etikës, Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe në grupin e vlerësimit të brendshëm e përgatitjen e RVB, për vetë faktin që në takimet përkatëse në të cilët ata marrin pjesë diskutohen problematika që kanë lidhje me përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, kontribuon në informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për këtë proces. Gjithashtu, mund të konsiderohet si kontribut i</p>

	<p>tërthortë edhe ai i realizuar nëpërmjet leksioneve të hapur të organizuar me studentët apo dhe ai që rezulton nga mobilitetet e studentëve në universitete të huaj. Për sa i përket personelit, GVJ konstatoi se ka patur angazhime të drejtim të trajnimeve të realizuara në aktivitete ndërkombëtare.</p> <p>Takime në institucion; 6.17 UNYT Trajnim NjSBC; 5.2 UNYT Erasmus and Mevlana Mobility Quota; https://unyt.edu.al/index.php/2022/12/09/students-integrity-in-research-and-academic-writing-week-of-integrity-conference/</p>			
Konkluzione	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Transparenca e veprimtarive në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit sigurohet nëpërmjet publikimit në faqen web të institucionit të elementëve që kanë të bëjnë me këtë proces;</i> - <i>Anëtarët e personelit akademik informohen individualisht në lidhje me rezultatet respektive të përfuara nga pyetsorët e studentëve të cilat lidhen drejtëpërdrejt me performancën e tyre ndërsa Departamenti informohet për rezultatet e të gjithë stafit të angazhuar pranë tij. Informacioni me rezultatet e vlerësimeve respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale;</i> - <i>Problematikat që rezultojnë nga vlerësimet e kryera bëhen objekt i trajtimit nga Departamenti, duke i shqyrtuar ato dhe duke propozuar hapa konkretë në drejtim të përmirësimit;</i> - <i>Anketimet e realizuar me studentët, pjesëmarrja e përfaqësuesve të tyre në instanca të ndryshme vendimmarrëse e konsultative të UNYT, hartimi i RVB dhe grumbullimi i informacionit për DVV kontribuojnë në informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike"

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Mjedise dhe infrastrukturë moderne në funksion të procesit mësimor dhe shërbimeve të tjera për studentët;
2. Menaxhim efektiv i bazës laboratorike nga Zyra e TI duke garantuar funksionimin e paisjeve kompjuterike dhe të softuerëve përkatës në shërbim të procesit mësimor dhe kërkimit;
3. Zhvillimi i të gjithë procesit akademik për këtë program studimi në gjuhën angleze;
4. Personel akademik me kualifikimin e duhur në përputhje me kurrikulën e këtij programi studimi;
5. Bibliotekë e mirë-pajisur me literaturë fizike të rëndësishme për programin e studimit, qasje në një bibliotekë dixhitale dhe anëtarësim në revista shkencore;
6. Punësim 100% i studentëve të diplomuar si dhe punësim në përputhje me diplomën dhe kualifikimin e përftuar nga programi i studimit;
7. Marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të rëndësishëm të tregut të punës;
8. Proces i mirëorganizuar i sigurimit të brendshëm të cilësisë;

b. Pika të dobta:

1. Ngarkesë jo e balancuar në kredite për vite akademike (*Standardi II.1, Kriteri 1; Standardi II.4, Kriteri 2*);
2. Numër i ulët i orëve në auditor për këtë program studimi (*Standardi II.1, Kriteri 1; Standardi II.1, Kriteri 7*);
3. Praktika profesionale jo e mirë strukturuar në planin mësimor dhe jepet e integruar me punimin e diplomës (*Standardi I.3, Kriteri 3; Standardi II.1, Kriteri 1, Kriteri 3; Standardi II.3, Kriteri 2*);

Rekomandime:

1. Të realizohet plani mësimor me jo më shumë se 60 kredite ECTS për vit akademik;
2. Të rritet numri i orëve mësimore në auditor;
3. Në planin mësimor të ndahet praktika profesionale nga punimi i diplomës duke përcaktuar edhe mënyrat e vlerësimit të saj;
4. Të garantohet mbulimi i ngarkesës mësimore së paku në masën 70% nga personel efektiv;
5. Rekomandohet një hapje ndaj pranimeve nga kategoria e personave me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara duke parashikuar kuota për këto kategori;
6. Të rritet mbështetja për kërkimin shkencor;
7. Faqja web e institucionit të plotësohet edhe me versionin në gjuhën shqipe.

**Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences
"Computer Science"**

a. Strengths and affirmations:

1. Modern infrastructure and facilities in function of the learning process and services delivered to students;
2. Effective management of the laboratory base by the IT Office, guaranteeing the operation of computer equipment and relevant software in the service of the teaching and research process;
3. Entire academic process for this study program is conducted in English;
4. Academic staff with the appropriate qualification in accordance with the curriculum of this study program;
5. Well-equipped library with physical literature relevant to the study program, access to a digital library and membership in scientific journals;
6. 100% employment of graduated students as well as employment in accordance with the degree and qualification obtained from the study program;
7. Cooperation agreement with important actors of the labor market;
8. Well-organized internal quality assurance process;

b. Weaknesses:

1. Unbalanced load in credits for academic years (*Standard II.1, criterion 1; Standard II.4, criterion 2*);
2. Low auditorium working hours for this study program (*Standard II.1, criterion 1; Standard II.1, criterion 7*);
3. The professional practice is not well structured in the curriculum and is given integrated with the diploma thesis (*Standard I.3, criterion 3; Standard II.1, criterion 1, criterion 3; Standard II.3, criterion 2*);

Recommendation

1. To complete the curriculum with no more than 60 ECTS credits per academic year;
2. To increase classroom teaching hours for this study program;
3. In the curriculum, professional practice should be separated from the diploma thesis, also defining the ways of its evaluation;
4. To guarantee the coverage of the teaching load to the extent of at least 70% by effective personnel;
5. An opening to admissions from the category of persons with special abilities, minorities and marginalized groups is recommended by providing quotas for these categories;
6. To increase support for research activities;
7. The website of the institution should be supplemented with the version in the Albanian language;

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X